160.	Lexojmë	Djaloshi i çuditshëm
161.	Lexojmë	Djaloshi i çuditshëm
162.	Njohuri gjuhësore	Zgjedhimet e foljes
163.	Njohuri gjuhësore	Zgjedhimet e foljes
164.	Njohuri gjuhësore	Shprehjet frazeologjike
165.	Njohuri gjuhësore	Shprehjet frazeologjike
166.	Njohuri gjuhësore	Kohët e foljes në mënyrën dëftore
PRILL – MAJ – QERSHOR (59 orë)		
167.	Njohuri gjuhësore	Kohët e foljes në mënyrën dëftore
168.	Njohuri gjuhësore	Foljet: marr, dal, shoh, jap në kohën e tashme
169.	Njohuri gjuhësore	Foljet: marr, dal, shoh, jap në kohën e tashme
170.	Lexojmë	Sytë e shkollës
171.	Lexojmë	Sytë e shkollës
172.	Njohuri gjuhësore	Kohët e foljes në mënyrën dëftore
173.	Njohuri gjuhësore	Kohët e foljes në mënyrën dëftore
174.	Lexojmë	Shoku ynë muzikant
175.	Lexojmë	Shoku ynë muzikant
176.	Njohuri gjuhësore	Koha e pakryer

177.	Lexojmë - shkruajmë	Eksploruesit
178.	Lexojmë – shkruajmë	Eksploruesit
179.	Njohuri gjuhësore	Ndajfoljet
180.	Njohuri gjuhësore	Ndajfoljet
181.	Lexojmë	Parajsa e rrezikuar
182.	Lexojmë	Parajsa e rrezikuar
183.	Lexojmë	Muzika ndër vite (Nexhmie Pagarusha)
184.	Lexojmë	Muzika ndër vite (Nexhmie Pagarusha)
185.	Njohuri gjuhësore	Lidhëzat
186.	Njohuri gjuhësore	Lidhëzat
187.	Lexojmë	Gollofi dhe qypi me mjaltë
188.	Lexojmë	Gollofi dhe qypi me mjaltë
189.	Lexojmë	Gollofi dhe qypi me mjaltë
190.	Njohuri gjuhësore	Fjalja e thjeshtë dhe gjymtyrët e saj
191.	Njohuri gjuhësore	Fjalja e thjeshtë dhe gjymtyrët e saj
192.	Lexojmë	Mësuesi i sëmurë
193.	Lexojmë	Mësuesi i sëmurë
194.	Njohuri gjuhësore	Grupi i kryefjalës dhe grupi i kallëzuesit (grupi emëror dhe grupi foljor)
195.	Njohuri gjuhësore	Grupi i kryefjalës dhe grupi i kallëzuesit
196.	Njohuri gjuhësore	Kryefjala
197.	Njohuri gjuhësore	Kryefjala
198.	Lexojmë - shkruajmë	Biografia dhe autobiografia
199.	Lexojmë - shkruajmë	Biografia dhe autobiografia
200.	Njohuri gjuhësore	Me se shprehet kallëzuesi
201.	Njohuri gjuhësore	Me se shprehet kallëzuesi
202.	Lexojmë - dëgjojmë	Pse jemi vallë kështu?
203.	Lexojmë - dëgjojmë	Pse jemi vallë kështu?
204.	Njohuri gjuhësore	Përcaktori
205.	Njohuri gjuhësore	Përcaktori
206.	Lexojmë	Nektar nga hojet krijuese
207.	Lexojmë	Nektar nga hojet krijuese
208.	Njohuri gjuhësore	Kundrinori i drejtë
209.	Njohuri gjuhësore	Kundrinori i drejtë
210.	Lexojmë	Largimi nga një turmë e inatosur
211.	Lexojmë	Largimi nga një turmë e inatosur
212.	Njohuri gjuhësore	Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë
213.	Njohuri gjuhësore	Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë
214.	Njohuri gjuhësore	Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë
215.	Njohuri gjuhësore	Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë
216.	Lexojmë - dëgjojmë	Ne fëmijëve
217.	Lexojmë - dëgjojmë	Ne fëmijëve
218.	Njohuri gjuhësore	Bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme
219.	Njohuri gjuhësore	Bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme
220.	Lexojmë	Planet e fëmijërisë
221.	Lexojmë	Planet e fëmijërisë
222.	Njohuri gjuhësore	Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit
223.	Njohuri gjuhësore	Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit
224.	Njohuri gjuhësore	Rrethanorët
225.	Njohuri gjuhësore	Rrethanorët

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.4; I.6; II.1 ; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kthimi në shkollë (ora e parë)

Fjalët kyçe: shkolla, shtatori, pushime verore

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Lexon rrjedhshëm pjesën e leximit;
- Respekton shenjat e interpunksionit;
- Thonë me fjalët e veta përmbajtjen e tekstit.

Kriteret e suksesit:

- Lexo rrjedhshëm dhe pa gabime;
- Respekto shenjat e pikësimit në tekst;
- Thuaj me fjalët tuaja përmbajtjen e tekstit.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI –Parashtrimi me fjalë paraprake

Pjesa hyrëse e orës mësimore do të zhvillohet përmes teknikës: **Stuhi mendimesh.**

Së pari, kontrollohen detyrat e shtëpisë. Identifikohen nxënësit që kanë punuar mirë, por edhe ata që nuk i kanë bërë detyrat e shtëpisë. Pastaj nxënësit udhëzohen që t'i shkruajnë katër fjalë në tabelë: *shtatori, pushimet, shkolla, përshtypjet e tyre*. Pas kësaj, nxënësit krejtësisht të pavarur do të

shkruajnë një tregim fare të shkurtër, duke i përdorur fjalët e mësipërme. Pastaj ata do të prezantojnë këtë tregim të shkurtër. Kështu përmes këtij aktiviteti synohet të arrihet te qëllimi i orës mësimore. Titulli shënohet në tabelë.

REALIZIMI – DRTA

Pas kësaj udhëzohen nxënësit që t'i hapin librat e gjuhës shqipe në faqen 4. Pjesa e leximit në fjalë ndahet në dy paragrafë. Nxënësit udhëzohen që ta lexojnë pjesën e parë deri te fjalia: - *Era*, - *dëgjova zërin gazmor të Lonit!* Pastaj vazhdohet me pyetje:

Kush është personi që tregon (rrëfen) ngjarjen dhe përjetimin e ditës së parë në shtator?

Pse i gëzohet kthimit në shkollë?

Ku i takon shoqet e shoqet?

Pas pyetjeve të parashtruara, përgjigjet merren nga nxënësit. Duhet të angazhohen sa më shumë nxënës në diskutim. Më pas fillohet të lexohet edhe paragrafi i dytë dhe i fundit. Pas këtij leximi, kalohet në pyetje:

- *Ku i takon shokët e shoqet?*
- *Kush e vëren i pari Erën?*
- *Për çfarë flasin në orën e parë?*
- *Si i kishin kaluar pushimet nxënësit?*
- *Çfarë kërkon mësuesja në fund?*

Pasi të merren përgjigjet nga nxënësit, kalohet në leximin e pjesës. Angazhohen sa më shumë nxënës në lexim. Kërkohet lexim i rrjedhshëm, duke i respektuar shenjat e interpunksionit. Pastaj nxënësit udhëzohen që së bashku me mësuesen të analizojnë pjesën e leximit. Së pari, punohet *ushtrimi 1* në faqen 5 të librit, ku kërkohet të rrethohet përgjigjja e saktë. Njëjtë veprohet edhe me ushtrimet e tjera, ku nxënësit përmes këtyre ushtrimeve arrijnë ta përvetësojnë pjesën e leximit në fjalë.

REFLEKTIMI - Pesëvargëshi

Në këtë etapë të orës mësimore kërkohet nga nxënësit që të përpilohet një pesëvargësh me temën: **Shtatori:**

Shtatori
i dashur i bukur
lehtëson shkëlqen përjeton
Ngrohtësia e mësueses diçka madhështore.
Stinë e vitit

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje në bisedë, në leximin e rrjedhshëm, si dhe në analizimin e pjesës së leximit në fjalë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Nxënësit duhet të shkruajnë një faqe të fletores për përshtypjet e tyre që i patën gjatë pushimeve të verës.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.4; I.6; II.1 ; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kthimi në shkollë (ora e dytë)

Fjalët kyçe: shkolla, shtatori, pushime verore

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përmbledh shkurt kuptimin e tekstit;
- Plotëson detyrat sipas asaj që kërkohet;
- Përshkruan për personazhin e kërkuar.

Kriteret e suksesit:

- Thuaje shkurtimisht kuptimin e tekstit;
- Plotëso detyrat që kërkohen;
- Përshkruaj me saktësi për personazhin e kërkuar.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI –Shqyrtimi i përbashkët

Së bashku me nxënës diskutohet rreth pjesës së leximit, të cilën e mësuar në orën e kaluar.

Nxënësve u parashtrihen pyetjet si në vijim:

- *Kjo ngjarje zhvillohet në cilën vetë?*
- *Cilat lloje të pushimeve i përmendin shoqet e shokët e Erës?*
- *A e ka mendimin e njëjtë me tuajin Era sa i përket shkollës?*

Të gjitha përgjigjet merren nga nxënësit dhe në këtë formë përmbyllim bisedën rreth shqyrtimit të përbashkët.

REALIZIMI – Lexim në dyshe

Në këtë të orës mësimore, nxënësit lexojnë në dyshe. Nxënësi i parë, të cilin e cakton mësuesi, lexon një pjesë të tekstit, më pas me disa fjali e përmbledh atë. Nxënësi i dytë parashtron pyetje rreth asaj që u lexua. Pastaj ndërrohen rolet. Krejt në fund, disa nxënës që janë dyshe e thonë me fjalët e veta kuptimin e pjesës së leximit. Gjithashtu, jepen vlerësime për secilin personazh.

REFLEKTIMI – Shkrimi i lirë

Në këtë pjesë të orës mësimore, nga nxënësit kërkohet që me disa fjali të shkurtra të shkruhet për njërin nga personazhet. Punimet e nxënësve lexohen para të tjerëve, si dhe bëhen komente rreth kësaj

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje në bisedë, për lexim, si dhe për shkrimin e bërë rreth një personazhi.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Nxënësit, me fjalë e veta ta shkruajnë kuptimin e pjesës së leximit në fjalë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë - dëgjojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.5

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 2.2; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Klasa e pestë

Fjalët kyçe: klasa e pestë, teksti imagjinar, teksti real

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Lexon bukur poezinë;
- Reciton në mënyrë artistike;
- E përjeton shpirtërisht poezinë.

Kriteret e suksesit:

- Shqipto në mënyrë të saktë vargjet e poezisë;
- Recito bukur dhe në mënyrë artistike;
- Përpiqu të jesh vetvetja në recitim (jo kopjim prej dikujt).

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Pema e mendimeve

Në këtë etapë të orës mësimore kontrollohen detyrat e shtëpisë. Pastaj kërkohet nga nxënësit që të punohet një pemë e mendimeve, ku theksi do të jetë: ***Klasa e pestë***. Pasi nxënësit e punojnë këtë pemë të mendimeve, atëherë kërkohet nga dy-tre nxënës, që punimet e tyre t'i prezantojnë para nxënësve të tjerë.

REALIZIMI – Ruaje fjalën e fundit për mua

Te kjo pjesë e orës mësimore, fillimisht, hapen librat e gjuhës shqipe në 6. Gjatë të lexuarit të poezisë, kërkohet nga nxënësit, që pasi ta lexojnë poezinë ta zgjedhin pjesën, që ju ka pëlqyer më shumë e ta shkruajnë në fletoret e tyre. Në tjetrën anë të fletores do të shkruajnë komentin për atë që zgjodhën. Kështu nxënësit japin mendimet e tyre, si dhe aktivizohen sa më shumë nxënës për të paraqitur atë që kanë punuar. Pas kësaj, nxënësit udhëzohen që të ushtrimet që janë në libër të plotësohen. Ushtrimi i radhës është: ***Të shkruajmë***, ku nxënësit me disa fjali do të shkruajnë për temën: ***Jam në klasë të pestë***.

REFLEKTIMI – Pesëvargëshi – 10 minuta

Në këtë etapë të orës mësimore kërkohet nga nxënësit që të përpilohet një pesëvargësh me temën: ***Klasa e pestë***:

Klasa e pestë
e bukur joshëse
punoj shkruaj mësoj
Të ngritur në çdo fushë.
Gjeneratë e artë

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për leximin e rrjedhshëm, komentimin, si dhe pjesëmarrjen në ushtrimet në klasë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ushtrimin e mbetur në faqen 7 me temën: ***Pushimet verore*** ta plotësojnë në libër.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Shkruajmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.2; I.5; III.2

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.6; 2.7; 3.1

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Tekstet reale dhe ato imagjinare

Fjalët kyçe: reale, imagjinare,

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Shkruan diçka reale;
- Shkruan diçka imagjinare;
- Diskuton rreth tekstit real dhe atij imagjinar.

Kriteret e suksesit:

- Diskuto rreth tekstit real dhe imagjinar;
- Fol për realen;
- Fol për imagjinaren.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Pema e mendimeve

Në këtë etapë të orës mësimore kontrollohen detyrat e shtëpisë. Pastaj punohet një pemë e mendimeve, ku theksi do të jetë: **Teksti real dhe ai imagjinar**. Nxënësit, më pas do të prezantojnë idetë e tyre të paraqitura në pemën e mendimeve.

REALIZIMI – Rrjeti i diskutimit

Në këtë të orës mësimore së bashku me nxënës diskutohet rreth teksteve reale dhe atyre imagjinare. Përmes kësaj metode ndërthuren katër artet e gjuhës: *të lexuarit, të shkruarit, të folurit dhe të dëgjuarit*. Nga nxënësit kërkohet që të lexohet pjesa e zgjedhur, që është: **Teksti real**, ku nxënësit më pas pyeten: Çka është teksti real? Kështu veprohet edhe me: **Tekstin imagjinar**. Pastaj kërkohet nga nxënësit të nxirren anët kundërshtuese të një çështjeje. Gjatë kësaj faze, theksi vihet në dhënien e argumenteve më të forta për të dyja anët e rrjetit të diskutimit. Nxënësit shkëmbejnë pikëpamje, të cilat shkruhen në rrjetin e diskutimit. Përfundimet shkruhen në fund të rrjetit. Pastaj, së bashku me nxënës punohen edhe ushtrimet që janë në faqen 8 të librit të gjuhës shqipe.

REFLEKTIMI – Shkrimi i lirë

Përmes shkrimit të lirë, nxënësit shkruajnë me fjalët e tyre për shkrimin real dhe atë imagjinar. Pastaj shkrimet e tyre komentohen së bashku me nxënës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për shkrimin real dhe atë imagjinar.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të shkruajnë një tekst imagjinar rreth pushimeve, duke zgjedhur njërin nga udhëtimet: Udhëtimi në gjithësi, udhëtimi nën ujë, udhëtimi në xhungël apo edhe udhëtimi në lojë kompjuterike.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë – dëgjojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.2; II.5

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.3; 2.2; 2.5; 3.4

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: E nisëm një shtator (ora e parë)

Fjalët kyçe: Dita e parë e shkollës, ura, pemët

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Lexon poezinë me intonacion;
- Ritregon poezinë, duke u bazuar në ngjarjen e poezisë;
- Identifikon figurat letrare dhe llojin e rimës në poezi.

Kriteret e suksesit:

- Identifikoj figurat letrare në poezi;
- Trego për ngjarjen që ndodh në poezi;
- Identifikoj rimat në poezi.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Përmes kësaj etape të orës mësimore prezantohen disa ilustrime, që kanë të bëjnë me fillimin e vitit të ri shkollor. Me nxënës bisedohet për fillimin e vitit të ri shkollor – konkretisht për shtatorin.

Pyetjet e mundshme për nxënës mund të jenë:

- *Çfarë kuptoni me pyetjen: Erdh shtatori me erë molle?*
- *Përse përmenden pemët në këtë poezi?*

Përgjigjen merren nga nxënësit, natyrisht duke u plotësuar edhe nga mësuesja. Në këtë formë përmbyllet etapa e parë e orës mësimore.

REALIZIMI – Leximi i drejtuar

Në këtë etapë mësimore lexohet poezia dhe më pas analizohet secila strofë e poezisë.

- *Përse i thur vargjet poeti Vehbi Kikaj?*
- *Çfarë ndërlidhen romakët, ilirët dhe mbretëresha Teutë?*
- *Po ndërrimi i ditës me natën?*
- *Çfarë nënkupton poeti me urën?*

Nxënësit diskutojnë për secilën strofë. Pastaj tregohet nga ana e nxënësve fillimi i strofave të poezisë në fjalë.

REFLEKTIMI – Shkrimi i lirë

Nxënësit përmes shkrimit të lirë shkruajnë poezi për shtatorin, fillimin e vitit të ri shkollor. Përpiqen që poezitë e tyre të rimojnë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për punën e bërë, përgjigjet e sakta në pyetjet e parashtruara, si dhe pjesëmarrjen në diskutim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të plotësohen në libër ushtrimet që ndodhen në faqen 10 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë - dëgjojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.2; II.5

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.3; 2.2; 2.5; 3.4

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: E nisëm një shtator (ora e dytë)

Fjalët kyçe: Dita e parë e shkollës, ura, pemët

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Reciton poezinë në mënyrë artistike;
- Shqipton saktë vargjet e poezisë;
- Analizon mesazhin e poezisë.

Kriteret e suksesit:

- Recito artistikisht;
- Analizo mesazhin e poezisë;
- Gjej rimat në poezi.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Mësuesja kontrollon detyrat e shtëpisë. Pastaj mësuesja i fton të gjithë nxënësit me radhë për ta recituar poezinë në fjalë. Gjatë recitimit shikohet mënyra e recitimit. Jepen vërejtjet e nevojshme se si duhet të recitohet poezia: aspekti artistik dhe respektimi i shenjave të interpunksionit.

REALIZIMI – Copëzat e përziera

Në këtë pjesë të orës mësimore, përgatitet poezia me tiketa për secilin grup (tre grupe të mundshme). Pastaj pas dhënies së shenjës për grupet në fjalë, grupet fillojnë t'i rregullojnë copëzat e përziera. Synohet të rregullohet poezia. Kështu luhet deri në pesë xhiro dhe më pas shpallet grupi më i mirë dhe më ekspeditivë, që vërtet e ka përvetësuar poezinë:

**Erdh shtatori me erë
molle**

Romakët sulmojnë me shpata

Urë të gjatë duhet kaluar

REFLEKTIMI – Kllasteri

Nxënësit do të punojnë kllaster, me theks të veçantë për shtatorin:

Dita e parë e shkollës

Nxënësit e presin me padurim

Shtatori

Nxënësit janë më të rritur

Shtatori – muaji për fillimin e nxënies së diturisë

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për recitimet e bëra, si dhe për angazhimin e punës me tiketa.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: T'u përgjigjen pyetjeve në faqen 9 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; II.7; III.4; III.5;

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 1.10; 2.5; 2.7; 3.2; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Teksti dhe paragrafi

Fjalët kyçe: Teksti, paragrafi

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon paragrafin në tekstin e dhënë;
- Përcakton veçoritë e çdo paragrafi;
- Analizon tekstin.

Kriteret e suksesit:

- Dallo paragrafët në tekstin e paraqitur;
- Përcakto veçoritë e secilit paragraf;
- Analizo tekstin.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Lidhja e temës në fjalë me njohuritë paraprake

Në këtë etapë mësimore do të ketë pyetje e përgjigje. Do të punohet në çifte. Pastaj mësuesja parashtron pyetje:

- *Çka është teksti?*
- *Si i dallojmë paragrafët?*

Përgjigjet e pyetjeve, merren pasi nxënësit punojnë në çift me shokun apo shoqen e bankës.

Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë

REALIZIMI – Diskutim

Më pas kalohet tek etapa tjetër, ku nga nxënësit kërkohet që të hapen librat në faqen 11. Lexohet për tekstin dhe për paragrafin. Mësohet se çka është teksti e çka paragrafi. Pastaj kërkohet nga nxënësit që të shkruajnë një tekst me tre paragrafë.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Në këtë etapë, klasa ndahet në grupe . Për secilin grup jepen detyra të veçanta.

Grupi i parë: Çka është teksti?

Grupi i dytë: Si i dallojmë paragrafët?

Grupi i tretë: Çka tregon çdo paragraf?

Çdo përfaqësues i grupit përgjigjet për punën që e kanë bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre në veprimtaritë e orës mësimore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruajeni një tekst me katër paragrafë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; II.1; II.4; II.5; II.1; III.4; III.5; V.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 1.10; 2.2; 2.7; 3.2; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Fjalja

Fjalët kyçe: fjali, shenja pikësimi, intonacioni

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përkufizon në mënyrë të saktë fjalinë;
- Dallon fjalitë e thjeshta nga ato të përbëra;
- Lexon me kujdes tekstin e prezantuar.

Kriteret e suksesit:

- Dallo fjali të ndryshme nga intonacioni;
- Dallo fjalitë përmes shenjave të pikësimi;
- Kupto intonacionin e mbarimit.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Lidhja e temës në fjalë me njohuritë paraprake

Në këtë pjesë mësimore përmes pyetjeve e përgjigjeve e fillojmë këtë njësi mësimore. Nxënësit udhëzohen që ta lexojnë tekstin. Kërkohet nga nxënësit të tregojnë prej sa fjalish është i përbërë ky tekst. Nga ajo që u lexua, nxënësit dalluan gjithsej 11 fjali, që e përbëjnë tekstin në fjalë. Diskutohet me nxënës këto pyetje:

- Çka quajmë fjali?
- Dallojeni fjalinë nga fjala në tekst?
- Si i dalluat fjalitë në tekstin e mësipërm?

REALIZIMI – Lexim me kodim teksti

Pastaj fillohet me këtë etapë mësimore. Mësuesja kërkon nga nxënësit të lexojnë kujdesshëm pyetjet që i ka shkruar në tabelë dhe të kërkojnë në libër informacionin që jep përgjigjen e tyre, duke shënuar përkrah tij numrin që mban pyetja.

- Si dallohen fjalitë kur dikush lexon një tekst?
- Çka është intonacioni?
- Si e dallojmë në një mënyrë tjetër intonacionin?
- Si do të jetë toni i zërit?

Mësimi lexohet me kujdes. Për çdo informacion dhe të dhënë vihet numri i pyetjes që i përgjigjet asaj. Nga nxënësit kërkohet që tërë informacionin që e kanë zgjedhur ta shkruajnë në një tabelë të këtij lloji:

()	()	()	()	()	()

Nxënësve u thuhet që numrat që i kanë përdorur gjatë leximit, mund t'i vendosin në kllapat që janë në tabelë dhe në secilën kolonë të shënohet informacioni i përshtatet secilit numër.

REFLEKTIMI – Paraqitja e rezultateve të arritura

Pasi të përfundohet ushtrimi, nxënësit bisedojnë në mes tyre për përgjigjet që kanë gjetur për pyetjet e shtruara. Çdo gjë e paqartë shpjegohet nga mësuesja.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për punën e bërë, angazhimin e tyre dhe pjesëmarrja në diskutim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të shkruajnë një tekst dhe më pas të tregojnë se prej sa fjalish është i përbërë teksti.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 1; I. 4; I. 5; I. 6; II. 1; II. 4; II. 5; II. 7; III. 1; III. 2;

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1. 3; 1. 4; 1.7; 1.9; 2.2; 2.5; 2. 6; 3.7; 3.8; 3.9

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Porosia në aksion

Fjalët kyçe: ambienti i pastër, papastërtia, aksioni, porosia

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Komenton tekstin me fjalët e veta;
- Parashikon rrjedhën e ngjarjes pas çdo ndalese;
- Argumenton vetë titullin: Porosia në aksion.

Kriteret e suksesit:

- Mbaj pastër ambientin ku jeton;
- Sillu mirë në rrugë, në qytet dhe çdo kund tjetër;
- Argumento se papastërtia dëmton shëndetin.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Parashikimi me terma paraprakë

Kontrollohen detyrat e shtëpisë, si dhe bëjmë përsëritjen e njësisë së fundit mësimore. Pastaj mësuesja shënon në tabelë fjalët kyçe: **ambienti i pastër, papastërtia, aksioni, porosia**. Nxënësit do të shkruajnë individualisht nga një tregim të shkurtër, duke i marrë për bazë këto fjalë kyçe. Pastaj tregimet e punuara do t'i lexojnë para të tjerëve.

REALIZIMI – Rishikimi në dyshe, leximi i drejtuar

Pasi ndahen në grupe, nxënësit udhëzohen që të hapen librat e gjuhës shqipe në faqen 14, te teksti: **Porosia në aksion** dhe lexojnë deri te ndalesa e parë: - *Duhet të organizojmë një aksion, u përgjigjëm ne*. Dhe, sipas ndarjes do të punojnë në grupe për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

- *Nga kush morën mësim nxënësit për ta mbajtur pastër ambientin?*
- *Si duhet të sillemi në rrugë?*
- *Sa ndikon keq papastërtia në shëndetin tonë?*
- *Çfarë duhet të bëjmë sot?*

Nxënësit pos në grupe, diskutojnë edhe në dyshe për mendimet dhe idetë e tyre rreth pyetjeve dhe pastaj ato diskutohen me tërë klasën. Vlerësohen porositë më të bukura, ku ato shkruhen në një kënd të klasës. Pastaj angazhohen disa nxënës që ta lexojnë tekstin. Gjatë leximit nxënësit këshillohen që të respektohen shenjat e pikësimit. Në lexim angazhohen sa më shumë nxënës, në mënyrë që pjesa e leximit në fjalë të kuptohet sa më mirë.

REFLEKTIMI – Pesëvargëshi

Nxënësit udhëzohen të përpilojnë një pesëvargësh me temën: **Aksioni**.

Aksioni
i mirë i pëlqyer
këshilloj punoj angazhoj
Ambienti duhet mbajtur pastër.
Organizimi

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen e tyre në begatimin e kësaj pjese të leximit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të shkruajnë me fjalët e tyre shpjegimin e kësaj pjese të leximit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; II.1; II.4; II.5; II.1; III.4; III.5; V.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 1.10; 2.2; 2.7; 3.2; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Theksi i fjalës dhe i fjalisë (ora e parë)

Fjalët kyçe: theksi i fjalës, theksi i fjalisë, rrokja

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon theksin e fjalës dhe të fjalisë;
- Përkufizon theksin e fjalës dhe të fjalisë;
- Vendos saktë shenjat e pikësimit te këto fjali.

Kriteret e suksesit:

- Dallo theksin e fjalës dhe të fjalisë;
- Shqiptoj drejt theksin logjik;
- Shkruaj fjali me intonacion: këshillues, dëftues, urdhërues, pyetës

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme

Mësimi fillon me një diktim të shkurtër. Mësuesja i këshillon dhe i udhëzon nxënësit të shkruajnë fjalët dhe fjalitë që ajo i dikton. Gjithashtu, te fjalët do të nënvizojnë rrokjen që do të theksohet më shumë në shqiptimin e asaj fjale dhe te fjalitë fjalën që mësuesja do ta theksojë me një ton më të lartë. Gjatë këtij procesi librat e nxënësve janë të mbyllura. Për shembull: i fortë, i butë, i bukur; shkoj, lexoj, shkruaj, punoj, etj. Theks ka edhe fjalia, p.sh.: **Nxënësve** u pëlqen **futbolli**. Shembujt përzgjidhen nga mësuesja. në fund diskutohen përgjigjet e nxënësve.

REALIZIMI – Analizë rastesh

Pas kësaj, nxënësit njihen me dy koncepte të reja: **theksi i fjalës** dhe **theksi i fjalisë**. Nxënësve u thuhet se çdo fjalë e vetme ka theksin e vet, por edhe fjalia ka theksin e saj, e cila quhet **theks logjik**. Pas kësaj nxënësit i hapin librat në faqen 15 të librit të gjuhës shqipe. Lexohet mësimi në fjalë. Analizohen me kujdes shembujt e dhënë, të cilat më pas edhe sqarohen nga mësuesja.

REFLEKTIMI – Prezantimi i rezultateve të arritura

Së bashku me nxënës punohen ushtrimet 1 dhe 2 në faqen 15 të librit të gjuhës shqipe. Jepen sqarimet e nevojshme për nxënësit, në mënyrë që mësimi duhet të kuptohet sa më mirë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 3 në faqen 15 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; II.1; II.4; II.5; II.1; III.4; III.5; V.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 1.10; 2.2; 2.7; 3.2; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Theksi i fjalës dhe i fjalisë (ora e dytë)

Fjalët kyçe: theksi i fjalës, theksi i fjalisë, rrokja

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon theksin e fjalës dhe të fjalisë;
- Përkufizon theksin e fjalës dhe të fjalisë;
- Vendos saktë shenjat e pikësimit te këto fjali.

Kriteret e suksesit:

- Dallo theksin e fjalës dhe të fjalisë;
- Shqiptoj drejt theksin logjik;
- Shkruaj fjali me intonacion: këshillues, dëftues, urdhërues, pyetës

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Lexim i përbashkët

Fokusi në këtë etapë të orës mësimore janë detyrat e shtëpisë. Nxënësit lexojnë detyrat e shtëpisë. Gjatë leximit diskutohet rreth theksit të fjalës dhe theksit të fjalisë.

REALIZIMI – Tabela e koncepteve

Nxënësve u paraqitet tabela e koncepteve, të cilën ata do ta vizatojnë në fletoret e tyre. Pastaj shembujt do t'i paraqesin në atë tabelë – në kolonat përkatëse dhe plotësojnë tabelën në bazë të asaj që kërkohet.

Theksi	Theksi i fjalës	Theksi i fjalisë	Rrokja

REFLEKTIMI – Shkrim i lirë

Në këtë etapë të orës mësimore, nxënësit do të shkruajnë një tekst të shkurtër. Më pas gjejnë shembuj të fjalëve dhe të fjalive, ku bie theksi i tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e treguar në të tria etapat e orës mësimore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Do të shkruajnë një tekst, ku më pas do të gjejnë theksin e fjalëve dhe theksin e fjalive.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; II.7; III.4; III.5;

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 1.10; 2.5; 2.7; 3.2; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Tekstet joletrare

Fjalët kyçe: tekst joletrar, shkresa zyrtare, njoftime...

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përcakton llojin e tekstit;
- Përmban rregulla e norma të gjuhës standarde;
- Analizon llojin e teksteve, që mbështetet në informacionin që përcjell.

Kriteret e suksesit:

- Përcakto llojin e tekstit;
- Analizo llojin e teksteve;
- Përmbaju rregullave e normave të gjuhës standarde.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme


Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Kllaster

Nxënësit përmes kllasterit njoftohen se cilat janë llojet e teksteve joletrare.



Me anë të kllasterit tregohet për llojet e teksteve joletrare. Nxënësit japin mendimet e tyre.

REALIZIMI – Dëgjim i drejtuar

Hapen librat e gjuhës shqipe në faqen 16. Lexohet teksti, ku nxënësit duhet të përqendrohen në përmbajtjen e tekstit. Nxiten nxënësit të bisedojnë rreth përmbajtjes së tekstit në fjalë. Nxënësit njihen se tekstet joletrare janë tekste: *shkencore, shkollore, monografi të ndryshme*. Pastaj janë: *shkresa zyrtare, ftesa zyrtare e private, njoftime, lajmërimi, kërkesa, ankesa, falënderime, mirënjohje, urime*, etj. Pasi njihen nxënësit me llojet e teksteve joletrare bëjnë pyetje të ndryshme rreth teksteve joletrare. Krejt në fund njihen dhe janë në gjendje të dallojnë tekstet letrare nga ato joletrare.

REFLEKTIMI – Punë individuale

Në këtë etapë të orës mësimore, nxënësit do të mundohen të shkruajnë disa lloje të teksteve joletrare. Zgjidhja se çfarë teksti joletrar do të shkruajnë ju mbetet nxënësve. Më pas lexohen disa tekste joletrare nga ana e nxënësve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e llojeve të teksteve joletrare. Po ashtu, vlerësohen për shkrimin e këtyre teksteve brenda një periudhe të shkurtër kohore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Përgjigjuni pyetjeve në faqen 17 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; II.7; III.4; III.5;

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 1.10; 2.5; 2.7; 3.2; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pse anijet lundrojnë në ujë edhe pse peshojnë shumë, ndërsa nëndetëset zhyten? (ora e parë)

Fjalët kyçe: anija, nëndetësja...

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon anijen nga nëndetësja;
- Përkufizon mendimin se për çka shërbejnë nëndetëset;
- Analizon dhe vjen në përfundim se teksti në fjalë është tekst joletrar.

Kriteret e suksesit:

- Analizo llojin e tekstit të prezantuar;
- Dallo tekstin në fjalë për nga lloji;
- Lexo rrjedhshëm, duke i respektuar shenjat e pikësimit.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Pasi të kontrollohen detyrat e shtëpisë, mësuesja kërkon nga nxënësit të shkruajnë dy-tri fjali për anijet. Pastaj tre deri në katër nxënës lexojnë atë se çfarë kanë shkruar për anijet.

REALIZIMI – Di – Dua të di - Mësova

Në këtë etapë të orës mësimore kërkoj nga nxënësit që fleta të ndahet në tre kolona: D-D-M.

D - D - M

D (Di)	D (Dua të di)	M (Mësova)

Me anë të kësaj metode kuptojmë për njohuritë paraprake të nxënësve për anijet dhe për nëndetëset. Përmes kësaj nxënësit arrijnë të bëjnë dallimin në mes të nëndetëseve dhe anijeve. Pastaj së bashku me nxënës iu përgjigjemi pyetjeve që janë libër, në faqen 17 dhe 18.

REFLEKTIMI – Rrjeti i diskutimit

Në këtë etapë të orës mësimore, së bashku me nxënës shkëmbejmë pikëpamje të ndryshme lidhur me anijet dhe nëndetëset. *Çka i dallon ato?* Me anë të rrjetit të diskutimit arrijmë që sa më shumë nxënës të jenë pjesëmarrës në bisedë, si dhe të zhvillojnë shprehje të nxënës në bashkëpunim.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e anijeve dhe të nëndetëseve, si dhe angazhimet në diskutime.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Në faqen 19 të librit, ushtrimi i fundit. Pra, shënojnë për karakteristikat e detit dhe të lumit Nil. Krejt në fund, në fjalor do të shkruajnë për kuptimin e fjalës *valvul*.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; II.7; III.4; III.5;

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 1.10; 2.5; 2.7; 3.2; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pse anijet lundrojnë në ujë edhe pse peshojnë shumë, ndërsa nëndetëset zhyten? (ora e dytë)

Fjalët kyçe: anija, nëndetësja...

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon tekstet letrare nga ato joletrare;
- Përkufizon mendimin se të tekstet joletrare përdoret gjuha standarde;
- Analizon dhe vjen në përfundim se teksti në fjalë është tekst joletrar.

Kriteret e suksesit:

- Analizo llojin e tekstit të prezantuar;
- Dallo tekstin në fjalë për nga lloji;
- Lexo rrjedhshëm, duke i respektuar shenjat e pikësimit.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Pasi është ora e dytë për këtë njësi mësimore, nxënësve u parashtrihen pyetje të ndryshme lidhur me mësimin në fjalë:

- *Sa lloje të teksteve janë dhe cilat janë ato?*
- *Cilat janë tekstet letrare?*
- *Cilat janë tekstet joletrare?*
- *Te tekstet joletrare a përdoret gjuha standarde apo ajo dialektore?*

Të gjitha përgjigjet merren nga nxënësit.

REALIZIMI – Shkrim i lirë

Nxënësve u kërkohet që të shkruajnë një shkrim të lirë dhe të bëjnë dallimin në mes të anijes dhe të nëndetëses. Fokusi i këtij shkrimi ka të bëjë me tekstin joletrar. Pasi shkruhet teksti nga ana e nxënësve, ata i prezantojnë shkrimet e tyre. Jepen komente të ndryshme, kurse në fund puna e nxënësve vlerësohet nga mësuesja.

REFLEKTIMI – Pesëvargëshi

Do të përpilohet një pesëvargësh nga ana e nxënësve. Tema do të jetë: *Anija*.

Anija

e madhe e rëndë

zhvendos peshon shtyp

Fuqia e mban në lundrim.

Mjet i madh për lundrim

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet puna dhe angazhimi i nxënësve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të shkruajnë një tekst joletrar. Përzgjedhja mbetet te nxënësit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; II.1; II.4; II.5; II.1; III.4; III.5; V.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 1.10; 2.2; 2.7; 3.2; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Tipat e fjalisë sipas kumtimit (ora e parë)

Fjalët kyçe: tipat e fjalisë, kumtim, dëftore, pyetëse, dëshirore dhe nxitëse

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon fjalinë sipas kumtimit;
- Ndërton fjali që i përket secilit tip të fjalisë;
- Dallon llojin e intonacionit për secilin tip të fjalisë.

Kriteret e suksesit:

- Analizo se çfarë kumtojnë këto fjali;
- Përcakto nuancat kuptimore për secilin tip të fjalisë;
- Dallo këto tipa të fjalisë sipas shenjave të pikësimit.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Njësinë mësimore e fillojmë me metodën: *Stuhi mendimesh*, duke bërë pyetje rreth këtyre lloje të fjalive:

- *Çka është fjalia?*
- *Çka kumtojnë ato?*
- *Sa tipa të fjalisë dallojmë?*
- *Po shenjat e pikësimit çfarë janë?*

Përgjigjet merren nga nxënësit.

REALIZIMI – Tabela e koncepteve

Nxënësit i urdhërohen që t'i hapin librat në faqen 20. Nxënësit lexojnë me vëmendje ato fjali që janë marrë nga tregimi "*Bardhi*", për të treguar e përcaktuar se çka kumton secili lloj i fjalisë. Në bazë të asaj se çka kumtojnë fjalitë, nxënësit mund ta definojnë tipin e tyre. P.sh.: *Bardhi punoi në oborrin e shkollës* (kumton informacion). Te ky lloj i fjalisë në fund vendoset shenja e pikës. Pastaj, së bashku me nxënës plotësohet e tërë tabela e koncepteve.

Tipat e fjalisë	Dëftore	Pyetëse	Dëshirore	Nxitëse
Çfarë kumtojmë?	Tregojmë	Pyesim	Shprehim dëshira	Nxitim për diçka
Shenja e pikësimit	Pika (.)	Pikëpyetje (?)	Pikëçuditja (!)	Pika (.)

REFLEKTIMI – Punë e drejtuar

Nxënësit librat i kanë të hapura në faqen 20 dhe 21 të librit të gjuhës shqipe. Fillojnë ta punojnë ushtrimin në faqen 21 të librit, ku i lidhin me shigjetë tipin e fjalisë me atë që kumton. P.sh.:

U gëzofsh për jetë e mot! - fjali dëshirore.

A do të shkojmë me kohë në mësim? – fjali pyetëse.

Nxënësit erdhën në shkollë. – fjali dëftore.

Pastaj plotësohet edhe tabela në faqen 21 bashkë me nxënësit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet puna dhe angazhimi i nxënësve në bazë të përgjigjeve të tyre.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyre shtëpie: Të punohet në shtëpi ushtrimi 10 në faqen 21 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; II.1; II.4; II.5; II.1; III.4; III.5; V.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 1.10; 2.2; 2.7; 3.2; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Tipat e fjalisë sipas kumtimit (ora e dytë)

Fjalët kyçe: tipat e fjalisë, kumtim, dëftore, pyetëse, dëshirore dhe nxitëse

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon fjalinë sipas kumtimit;
- Ndërton fjali që i përket secilit tip të fjalisë;
- Dallon llojin e intonacionit për secilin tip të fjalisë.

Kriteret e suksesit:

- Analizo se çfarë kumtojnë këto fjali;
- Përcakto nuancat kuptimore për secilin tip të fjalisë;
- Dallo këto tipa të fjalisë sipas shenjave të pikësimit.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projeksi, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Diskutim


Me nxënës diskutohet për pyetjet:

- *Sipas informacionit që kumtojnë, fjalitë çfarë mund të jenë?*
- *Cilat janë shenjat e pikësimit për fjalitë sipas kumtimit?*

Përgjigjet që merren nga nxënësit shkruhen në tabelë.

REALIZIMI – Shokë leximi

Në këtë etapë të orës mësimore, mësuesja i këshillon nxënësit që t'i hapin librat në faqen 21 të librit të gjuhës dhe të fillohet puna në çifte me ushtrimin 9, ku njëri nxënës lexon ushtrimin tjetri bën lidhjen me shigjetë në mes të tipit të fjalisë dhe asaj që kumton. Mësuesja përcjell punën e çifteve dhe jep sqarimet e nevojshme.



Nxënësit, më pas, prezantojnë punën e bërë në çifte.

REFLEKTIMI – Turi i galerisë

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesja kërkon nga nxënësit që të formojnë grupet dhe më pas të shkruajnë tipa fjalish sipas kumtimit. Nxënësit do të shkruajnë fjali sipas informacionit që kumtojnë: *fjali dëftore, pyetëse, dëshirore dhe nxitëse*. Pas punës së bërë, përfaqësuesit e grupeve do të lexojnë punën që kanë bërë dhe pastaj punimet e tyre i vendosin në tabelë, kurse grupet e tjera do të vlerësojnë dhe do të japin komente rreth punimeve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet puna dhe angazhimi i nxënësve në klasë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të shkruajnë tipa fjalish sipas kumtimit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.

Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.6; II.2; II.3; III.1; III.3; III.4; III.8; V.8;

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 1.7; 1.8; 1.9;1.10 2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Gjethja magjike (ora e parë)

Fjalët kyçe: Xhani, mamaja, gruaja e gjigantit, plaku

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përshkruan ngjarjen në këtë përrallë;
- Nxjerr mesazhin e përrallës;
- Numëron elementet fantastike në përrallë.

Kriteret e suksesit:

- Përshkruaj ngjarjen e përrallës;
- Analizo elementet fantastike të përrallës;
- Analizo në detaje mesazhin që jepet në këtë përrallë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Parashikimi me terma paraprakë

Në këtë etapë, mësuesja shkruan në tabelë fjalinë: *Përrallat janë tregime me përmbajtje fantastike*. Pastaj mësuesja iu drejtohet nxënësve, duke iu thënë të japin ide dhe mendime se nga po ju shkon mendja, kur e dëgjojmë këtë fjali. Fëmijëve nuk iu përmendet se a kanë dhënë përgjigje të saktë apo të gabuar. Pastaj shkruhet edhe fjala: *magjike*. Nxënësve iu kërkohet të bëhet lidhja logjike në mes të këtyre termave. Nga nxënësit merren mendime të ndryshme, për të nxjerrë edhe qëllimin e orës mësimore. Në tabelë shkruhet edhe fjalia: *Diçka magjike*.

REALIZIMI – DRTA dhe fletëpalosje

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Luani dhe miu (ora e parë)

Fjalët kyçe: luani, miu

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Ritregon përrallëzën me fjalë të zgjedhura;
- Identifikon cilësitë e personazheve;
- Krahason kafshët e egra me kafshët shtëpiake.

Kriteret e suksesit:

- Përshkruaj personazhin kryesor;
- Vlerëso rëndësinë e veprimeve të personazheve;
- Analizo personazhet në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.


PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Parashikimi me terma paraprakë

Kontrollohen detyrat e shtëpisë, si dhe bëjmë përsëritjen e njësisë së fundit mësimore. Pastaj mësuesja shënon në tabelë fjalët kyçe: **luani**, **miu**, Nxënësit do të shkruajnë individualisht nga një tregim të shkurtër, duke i marrë për bazë këto fjalë kyçe. Pastaj tregimet e punuara do t'i lexojnë para të tjerëve.

REALIZIMI – Diagrami i Venit

Mësuesja krijon një Diagram të Venit në tabelë, ku kërkohet krahasimi i përrallëzave me përrallat. Kërkon nga nxënësit që të kujtojnë njohuritë për temën dhe diagrami plotësohet bashkërisht me nxënësit. Në diagram numërohen veçoritë e secilit lloj dhe të përbashkëtat në hapësirën në mes.



REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit ndahen në grupe, ku mësuesja për secilin grup ka përgatitur pyetje të veçanta:

Grupi i parë: Forma e shkrimit e përrallëzave: “Luani dhe gomari gjahtar” dhe “Luani dhe miu”.

Grupi i dytë: Tema e përrallëzave: “Luani dhe gomari gjahtar” dhe “Luani dhe miu”.

Grupi i tretë: Porosia apo morali i përrallëzave: “Luani dhe gomari gjahtar” dhe “Luani dhe miu”.

Grupi i katërt: Personazhi i luanit të përrallëzat: “Luani dhe gomari gjahtar” dhe “Luani dhe miu”.

Kryetarët e grupeve prezantojnë para klasës punën e zhvilluar në grup. Jepen komente e plotësime të nevojshme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për qartësinë e fjalive dhe përzgjedhjen e tyre me informatë kthyesë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: T'u përgjigjen pesë pyetjeve në faqen 43 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.5; 3.4; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Luani dhe miu (ora e dytë)

Fjalët kyçe: luani, miu

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Ritregon përrallëzën me fjalë të zgjedhura;
- Identifikon cilësitë e personazheve;
- Krahason kafshët e egra me kafshët shtëpiake.

Kriteret e suksesit:

- Përshkruaj personazhin kryesor;
- Vlerëso rëndësinë e veprimeve të personazheve;
- Analizo personazhet në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Mësuesja kontrollon detyrat e shtëpisë e më pas shtron pyetjet:

- *Cilët janë personazhet e përrallzës?*
- *Si është shkruar ajo?*
- *Pse i kemi kafshët si personazhe?*
- *Çfarë teme trajtohet në këtë përrallëz?*
- *Cila është porosia apo morali i kësaj përrallëze?*

Merren përgjigjet e nxënësve, të cilat shënohen në tabelë e më pas komentohen së bashku me nxënës.

REALIZIMI – Lexim në dyshe

Nxënësit lexojnë në dyshe.

Nxënësi i parë lexon një pjesë të përrallzës dhe e përmbledh atë me disa fjali të shkurtra. Ndërkaq, nxënësi i dytë parashtron pyetje që kanë të bëjnë me atë pjesë që u lexua nga nxënësi i parë. Kështu ndërrohen rolet. Krejt në fund, disa dyshe me disa fjali të shkurtra e përmbledhin tërë tekstin para klasës. Pastaj me nxënës diskutohet rreth personazheve të kësaj përrallëze – për cilësitë e personazheve në fjalë.

REFLEKTIMI – Pesëvargëshi

Në këtë etapë të orës mësimore, nxënësit do të përpilojnë një pesëvargësh me temën: ***Luani***.

Luani
i fortë bujar

çlirtohej bërtiti u kap

U tregua bujar me miun.

Kafshë e egër

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore në fjalë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ta shënojnë një përrallëz të ngjashme.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.8; II.5; III.1; III.3; III.4; III.8; V.5; V.8; VI.2; VI.3; VI.3

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. 1; 1. 2; 1.4; 1. 8; 2. 1; 2. 5; 2. 6; 2. 7; 3. 2; 3. 3; 3.4; 3.5; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Fjalja pohore dhe mohore (ora e parë)

Fjalët kyçe: fjali, dëftore, pohore, mohore

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon fjalitë pohore dhe mohore;
- Numëron pjesëzat mohuese;
- Shndërron fjalitë pohore në mohore dhe anasjelltas.

Kriteret e suksesit:

- Gjej se cila është fjali pohore e cila mohore;
- Trego se cilat pjesëza përdorim për të mohuar;
- Kthe fjalitë pohore në mohore.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Diskutimi për njohuritë paraprake

Në fillim, mësuesja pyet nxënësit:

- *Cilat janë llojet e fjalive?*
- *Po fjalitë dëftore si ndahen?*

Pastaj shkruan në tabelë fjalitë:

Fisniku shkoi me motrën në Pejë. (pohore)

Fisniku nuk shkoi me motrën në Pejë. (mohore)

Pastaj nga nxënësit kërkohet që të bëhet identifikimi i këtyre dy llojeve të fjalive. Pastaj para nxënësve paraqitet njësia mësimore e re. Mësuesja zgjeron fondin e njohurive, duke i prezentuar edhe informatat shtesë për fjalitë.

REALIZIMI – INSERT

Pastaj nxënësit udhëzohen që në fletoret e tyre të punojnë tabelën INSERT.

V	+	-	?

Hapin librat në faqen 46 dhe identifikojnë informatat që kanë ditur më parë, informatat e reja, informatat e ndryshme nga ato që dinin dhe pyetje për mësuesen. Pastaj plotësohet tabela në fletore. Meqë, nuk ka shumë informacion dhe rrjedhimisht mbetet kohë, nxënësit ndahen në grupe dhe grupi i parë ka për detyrë të mbarojë detyrën e parë, grupi i dytë detyrën e dytë, grupi i tretë detyrën e tretë dhe grupi i katër detyrën e katërt të ushtrimeve në faqen 46 të librit të gjuhës shqipe.

REFLEKTIMI – Rrjeti i merimangës

Nxënësit bëhen rreth dhe mësimdhënësi e mban në dorë një tub peri. Ai ia hedh tubën njërit nxënës, kurse në njërin gisht e mban të mbështjellë perin. Mësuesja i parashtron pyetjen nxënësit që ia hedh perin:

Më thuaj një fjali mohore për vetën.

Nxënësi përgjigjet, lidh gishtin për peri dhe tubën e perit ia hedh shokut tjetër, të cilit ia bën një pyetje për fjalitë pohore dhe mohore. Loja vazhdon kështu deri sa të gjithë fëmijët të kenë marrë fjalën dhe derisa të gjithë të kemi krijuar rrjetën e merimangës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore në fjalë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruaj pesë fjali pohore, të cilat pastaj shndërroji në fjali mohore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.

Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.8; II.5; III.1; III.3; III.4; III.8; V.5; V.8; VI.2; VI.3; VI.3

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. 1; 1. 2; 1.4; 1. 8; 2. 1; 2. 5; 2. 6; 2. 7; 3. 2; 3. 3; 3.4; 3.5; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Fjalta pohore dhe mohore (ora e dytë)

Fjalët kyçe: fjali, dëftore, pohore, mohore

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon fjalitë pohore dhe mohore;
- Numëron pjesëzat mohuese;
- Shndërron fjalitë pohore në mohore dhe anasjelltas.

Kriteret e suksesit:

- Gjej se cila është fjali pohore e cila mohore;
- Trego se cilat pjesëza përdorim për të mohuar;
- Kthe fjalitë pohore në mohore.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme


Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Kllaster

Nxënësve iu paraqitet një kllaster rreth fjalive pohore dhe mohore.



REALIZIMI – Rrjeti i diskutimit

Me anë të kësaj teknike diskutohet për fjalitë pohore dhe mohore. Merren disa shembuj në libër, konkretisht shembullin 3, ku fjalitë pohore të kthehen në fjali mohore. Gjithsej janë 7 fjali pohore, me ç'rast nxënësit i kthejnë në fjali mohore. P.sh.: *Shpendi lëvizi ngadalë.* (pohore) *Shpendi nuk lëvizi ngadalë.* (mohore)

REFLEKTIMI – Punë e pavarur

Kërkohet nga nxënësit, që mënyrë krejtësisht të pavarur t'i shkruajnë nga dy fjali pohore, të cilat më pas i kthejnë mohore. Pasi t'i shkruajnë fjalitë i prezantojnë para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore në fjalë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të shkruajnë fjali pohore dhe mohore sipas dëshirës.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.

Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.5; 3.4; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Cinxeri dhe milingona (ora e parë)

Fjalët kyçe: cinxeri, milingona

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Ritregon përrallëzën me fjalë të zgjedhura;
- Identifikon cilësitë e personazheve;
- Krahason insektet në fjalë.

Kriteret e suksesit:

- Përshkruaj personazhin kryesor;
- Vlerëso rëndësinë e veprimeve të personazheve;
- Analizo personazhet në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Bashkë me nxënës i analizojmë pyetjet e mëposhtme:

- *Keni dëgjuar për cinxerin?*
- *Po për milingonën?*

Të gjitha përgjigjet merren nga nxënësit dhe shënohen në tabelë.

REALIZIMI – Leximi zinxhiror

Pas kësaj, nxënësit udhëzohen që t'i hapin librat në faqen 47 të librit të gjuhë shqipe, si dhe të përcjellin me vëmendje shokët dhe shoqet e klasës, sepse leximin do ta bëjnë të gjithë nxënësit. Nxënësit do të orientohen me njëfarë lloj shenje në atë pjesë të përrallës, ku tregohen veçoritë e cinxerit dhe të milingonës, si personazhe kryesore.

REFLEKTIMI – Rrjeti i diskutimit

Me anë të kësaj teknike, nxënësit do të punojnë shembujt që janë në libër, në faqen 48. Do të punojnë shembujt prej 1 deri në 6. Pra, do të bëjnë plotësimin e rreshtave të zbrazët që janë në libër. Në fund, secili nxënës do të prezantojë atë që ka punuar, kurse nxënësit e tjerë do të bëjnë plotësimet e nevojshme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore në fjalë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ushtrimin 1, në faqen 49 të librit. Përrallëzën që është e dhënë në vargje ta përshtatni dhe ta shkruani në rreshta (prozë).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.

Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.5; 3.4; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Cinxeri dhe milingona (ora e dytë)

Fjalët kyçe: cinxeri, milingona

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Ritregon përrallëzën me fjalë të zgjedhura;
- Identifikon cilësitë e personazheve;
- Krahason insektet në fjalë.

Kriteret e suksesit:

- Përshkruaj personazhin kryesor;
- Vlerëso rëndësinë e veprimeve të personazheve;
- Analizo personazhet në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Mësuesja kontrollon detyrat e shtëpisë e më pas shtron pyetjet:

- *Cilët janë personazhet e përrallëzës?*
- *Si është shkruar ajo?*
- *Pse i kemi kafshët si personazhe?*
- *Çfarë teme trajtohet në këtë përrallëz?*

Merren përgjigjet e nxënësve, të cilat shënohen në tabelë e më pas komentohen së bashku me nxënës.

REALIZIMI – Leximi në dyshe

Nxënësit lexojnë në dyshe.

Nxënësi i parë lexon një pjesë të përrallëzës dhe e përmbledh atë me disa fjali të shkurtra. Ndërkaq, nxënësi i dytë parashtron pyetje që kanë të bëjnë me atë pjesë që u lexua nga nxënësi i parë. Kështu ndërrohen rolet. Krejt në fund, disa dyshe me disa fjali të shkurtra e përmbledhin tërë tekstin para klasës. Pastaj me nxënës diskutohet rreth personazheve të kësaj përrallëze – për cilësitë e personazheve në fjalë.

REFLEKTIMI – Shkrimi i lirë

Përmes kësaj teknike, nxënësit do të shkruajnë një shkrim të lirë, konkretisht për karakteristikat e personazheve, duke u mbështetur në përrallëzën në fjalë. Më pas, nxënësit do ta prezantojnë punën e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore në fjalë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Përmes fjalorit elektronik, nxënësit të shkruajnë me saktësi për cinxerin dhe milingonën.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.

Klasa: V

Kompetenca: Shkruajmë – lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.6; II.2; II.3; II.5; III.1; III.3; III.4; III.8; V.8; VI.2; VI.3; VI.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 1.7; 1.8; 1.9;1.10 ; 2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7; 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Letra (ora e parë)

Fjalët kyçe: letër kërkim - falje, letër zyrtare, letër falënderimi, letër miqësore

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Veçon elementet që duhet t'i ketë një letër;
- Shkruan sipas rregullave një letër;
- Krahason letrën me format tjera të shkrimit.

Kriteret e suksesit:

- Trego pjesët përbërëse të letrës;
- Shkruaj një letër sipas udhëzimeve të dhëna;
- Krahaso letrën me format e tjera të shkrimit.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Shkrim mbi shkrim

Meqenëse letrat kanë një strukturë formale, të cilën duhet respektuar, mësuesja shkruan në tabelë një letër, duke sqaruar se cilat informacione duhen futur patjetër në letër. Pas kësaj, nxënësit pak a shumë janë të njoftuar se në këtë orë mësimore kanë të bëjnë me letrën.

REALIZIMI – Leximi i drejtuar

Analizohet teksti i shkruar në faqen 50 të librit të gjuhës shqipe, i cili ka të bëjë me sqarimin se çfarë në fakt janë letrat. Teksti lexohet para nxënësve, duke i njoftuar në detaje me atë se çka është letra. Pastaj vijojmë me leximin e stileve të ndryshme të letrave, duke filluar nga *letrat e kërkim – faljes, letrave zyrtare, letra të falënderimeve, letra miqësore*. Mësuesja sqaron se secila nga këto letra i ka specifikat e veta. Ato dallojnë në mes tyre. Nxënësit njoftohen me llojet e letrave.

REFLEKTIMI – Letër e drejtuar - shkrimi i shpejtë

Nxënësit krijojnë zarfe me fletë A/4.

Në të fusin një letër, të cilën ua dërgojnë një njeriu me kompetenca shtetërore, qoftë kryetar komune apo shteti. Nxënësit mund të zgjedhin dhe ndonjë autor librash apo shkrimtar poezish. Nxënësit inkurajohen që të ruajnë strukturën e shkrimit, të shkruajnë shënimet e domosdoshme dhe të shkruajnë drejt.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore në fjalë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: T'u përgjigjen 5 pyetjeve në faqen 51 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.

Klasa: V

Kompetenca: Shkruajmë – lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.6; II.2; II.3; II.5; III.1; III.3; III.4; III.8; V.8; VI.2; VI.3; VI.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 1.7; 1.8; 1.9;1.10 ; 2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7; 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Letra (ora e dytë)

Fjalët kyçe: letër kërkim - falje, letër zyrtare, letër falënderimi, letër miqësore

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Tregon hapat që duhet ndjekur për shkrimin e një letre;
- Lexon modelet e letrave të paraqitura;
- Shpjegon dallimin midis modeleve të letrave të dhëna.

Kriteret e suksesit:

- Identifiko kriteret kryesore për shkrimin e një letre;
- Gjej dallimin midis letrave të paraqitura;
- Shkruaj bukur dhe qartë një letër një personi më të afërt.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Para nxënësve mësuesja i shtron këto pyetje:

- *Pse shkruajmë letra?*
- *Cilat janë llojet e letrave?*
- *Kujt i dërgojmë letra?*

Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë dhe komentohen bashkë me nxënës.

REALIZIMI – Punë e pavarur

Lexohen modelet e letrave të paraqitura në libër dhe diskutohet rreth shkrimit të tyre. Pastaj në fund të faqes 51 të librit të gjuhës janë katër korniza, ku nxënësit udhëzohen të shkruajnë katër letra sipas llojeve të letrave, të cilat i mësuam në orën e fundit. Nxënësit punojnë të pavarur, ndërkaq mësuesja përcjell punën e nxënësve, duke dhënë këshilla të nevojshme. Në fund, nxënësit prezantojnë punën e bërë.

REFLEKTIMI – Kllaster

Para nxënësve punohet një kllaster.

Kërkim – falje

zyrtare

Letra

Falënderimi

miqësore

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore në fjalë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të punohet ushtrimi i fundit në faqen 52 të librit të gjuhës shqipe. Shkruani një letër zyrtare për të ndjekur një kurs sipas dëshirës suaj!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.5; I.6; I.8; IV.3

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 2.1; 2.2; 3.5

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Harri Poter (ora e parë)

Fjalët kyçe: Harri Poter, Roni, letra, basti, post scriptum

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Zhvillon imagjinatën duke e lexuar letrën në fjalë;
- Shkruan disa veçori për letrën;
- Lexon bukur letrën, duke respektuar shenjat e pikësimit.

Kriteret e suksesit:

- Zhvillo imagjinatën;
- Shkruaj disa veçori për letrën;
- Shkruaj bukur dhe pa gabime.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Parashikimi me terma paraprakë

Kontrollohen detyrat e shtëpisë, si dhe bëjmë përsëritjen e njësisë së fundit mësimore. Pastaj mësuesja shënon në tabelë fjalët kyçe: *Harri Potter, Roni, letra, kujt i drejtohet, pse u shkrua kjo letër, basti*. Nxënësit do të shkruajnë individualisht nga një tregim të shkurtër, duke i marrë për bazë këto fjalë kyçe. Pastaj tregimet e punuara do t'i lexojnë para të tjerëve.

REALIZIMI – Leximi në dyshe, leximi i drejtuar

Pasi ndahen në grupe, nxënësit udhëzohen që të hapen librat e gjuhës shqipe në faqen 53, te teksti: *Harri Potter* dhe lexojnë letrën e parë. Dhe, sipas ndarjes do të punojnë në grupe për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

- *Kush e ka shkruar letrën?*
- *Kujt ia drejton?*
- *Pse u shkrua kjo letër?*
- *Kush ishte Hedvigu?*
- *A e dini pse janë shkruar fjalitë e fundit pas shkronjave P. S.?*

Nxënësit pos në grupe, diskutojnë edhe në dyshe për mendimet dhe idetë e tyre rreth pyetjeve dhe pastaj ato diskutohen me tërë klasën. Vlerësohen porositë më të bukura, ku ato shkruhen në një kënd të klasës. Pastaj angazhohen disa nxënës që ta lexojnë tekstin. Gjatë leximit nxënësit këshillohen që të respektohen shenjat e pikësimit. Në lexim angazhohen sa më shumë nxënës, në mënyrë që pjesa e leximit në fjalë të kuptohet sa më mirë. Kështu vazhdohet edhe me letrën e dytë, ku mësuesja paraqet pyetjet e nxënësit e përgjigjen. Njëjtë veprohet edhe me leximin e letrës së tretë. Nxënësit këshillohen që gjatë leximit t'i respektojnë shenjat e pikësimit.

REFLEKTIMI – Rrjeti i diskutimit

Së bashku me nxënës analizohen dhe punohen 4 ushtrimet në faqen 55 të librit të gjuhës shqipe. Tek ushtrimi 5, nxënësit të ndarë në grupe do të diskutojnë për karakteristikat e letrave drejtuar Harri Poterit, posaçërisht, se pse këto nuk janë tekste joletrare.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore në fjalë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani një letër joformale (vetjake) një shoku apo një anëtari të familjes!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.5; I.6; I.8; IV.3

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 2.1; 2.2; 3.5

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Harri Poter (ora e dytë)

Fjalët kyçe: Harri Poter, Roni, letra, basti, post scriptum

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përmbledh përmbajtjen e tekstit;
- Plotëson detyrat sipas kërksave të dhëna;
- Përshkruan personazhin me disa fjali.

Kriteret e suksesit:

- Plotëso detyrat e dhëna;
- Shkruaj përmbajtjen e tekstit;
- Përshkruaj personazhin kryesor me disa fjali të shkurtra.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Shqyrtimi i përbashkët

Me nxënës diskutohet rreth pyetjeve të mëposhtme:

- *Cili është mesazhi i letrave të dërguara?*
- *Cilat janë karakteristikat e këtyre letrave?*
- *Çka do të shtojmë në fund?*

REALIZIMI – Leximi në dyshe

Nxënësit lexojnë në dyshe.

Nxënësi i parë lexon letrën e parë dhe e përmbledh me disa fjali të shkurtra. Nxënësi i dytë parashtron pyetje rreth asaj që lexoi nxënësi i parë. Gjatë leximit, ndërrohen rolet. Kështu vazhdohet, ku krejt në fund disa dyshe e përmbledhin tekstin në përgjithësi. Pastaj, përmes bisedave me nxënës paraqiten cilësitë e secilit personazh.

REFLEKTIMI – Shkrimi i lirë

Nga nxënësit kërkohet që të shkruajnë me disa fjali për tri letrat që ia dërguan Harri Poterit. Me një fjalë të bëhet një analizë e shkurtër për letrat në fjalë. Disa punime të nxënësve lexohen para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore në fjalë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruajeni një letër sipas dëshirës suaj!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Shkruajmë – lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; II.7; III.4; III.5;

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 1.10; 2.5; 2.7; 3.2; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Metafora

Fjalët kyçe: metafora, figurë letrare, kuptim i figurshëm

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Tregon se çka janë metaforat;
- Thekson tiparet e ngjashmërisë ose të ndryshimit të fenomeneve;
- Analizon metaforat.

Kriteret e suksesit:

- Trego se çka janë metaforat;
- Analizo metaforat;
- Thekso tiparet e ngjashmërisë ose të ndryshimit të fenomeneve.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Kllasteri

Nxënësve iu prezantohet një kllaster, pikërisht për metaforat, konkretisht për përdorimin e gjerë në letërsi.

Figurë letrare

përdorim të gjerë në letërsi

Metafora

Vjen nga greqishtja

fjalë me kuptim të figurshëm

REALIZIMI – Dëgjim i drejtuar

Hapen librat e gjuhës shqipe në faqen 57. Lexohet teksti, ku nxënësit duhet të përqendrohen në përmbajtjen e tekstit. Nxiten nxënësit të bisedojnë rreth përmbajtjes së tekstit në fjalë. Nxënësit njihen se metaforat janë figura letrare me përdorim të gjerë në letërsi, në komunikim të përditshëm, si dhe te këngët popullore. Metafora është një fjalë me kuptim të figurshëm. Pasi njihen nxënësit me metaforën bëjnë pyetje të ndryshme rreth metaforave. Krejt në fund njihen dhe janë në gjendje të dallojnë lloje të ndryshme të metaforave. P.sh.: Ai shpejt merr *flakë*. Vullnet *i çeliktë*, etj.

REFLEKTIMI – Shkrimi i lirë

Nxënësve iu kërkohet, që duke u bazuar në shembujt e mësipërm të formojnë fjali me metafora. Natyrisht, mësuesja ofron ndihmën e nevojshme. Në fund, disa nxënës prezantojnë punën e bërë para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore në fjalë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyre shtëpie: Shkruani nga tri fjali me metaforë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Shkruajmë – lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; II.7; III.4; III.5;

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 1.10; 2.5; 2.7; 3.2; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Aktivitete kulturore

Fjalët kyçe: aktivitete, iniciativa, shoqata, klube

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Tregon se çka janë aktivitetet kulturore;
- Thekson ftesat që bëhen për aktivitetet kulturore;
- Analizon ftesat kulturore.

Kriteret e suksesit:

- Trego se çka janë aktivitetet kulturore;
- Analizo ftesat kulturore;
- Shkruaj ftesa kulturore.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Përmes kësaj teknike nxënësit përgjigjen në pyetjet e mëposhtme:

- *Ai zhvillohen aktivitetet kulturore?*
- *Si bëhen njoftimet për organizimin e aktiviteteve kulturore?*
- *Kujt i dërgohen ftesat?*
- *Dini ndonjë aktivitet kulturor që është tradicional?*

Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë dhe komentohen bashkërisht.

REALIZIMI – Punë në grupe

Nxënësit ndahen në dy grupe të mëdha:

Grupi i parë do të shkruajë një ftesë publike për një orë letrare.

Grupi i dytë do të përpilojë një listë se kush nga poetët e zyrtarët e tjerë do të marrin pjesë në këtë event.

Pastaj nxënësit do t'i prezantojnë punimet e tyre para klasës. Këto punime do të analizohen e komenton bashkërisht.

REFLEKTIMI – Shkrimi i lirë

Nxënësit individualisht dhe krejtësisht të lirë do të shkruajnë një ftesë për një organizim letrar, që do të organizohet në ambiente të shkollës. Pas kësaj, mësuesja do të shikojë se si është shkruar kjo ftesë. A janë përfshirë elementet e nevojshme që e bëjnë ftesën të pranueshme: Vendi se ku mbahet, data, ora dhe kush e dërgon. Krejt në fund jepen komente të ndryshme, lidhur me punën e nxënësve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore në fjalë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani një ftesë që ka të bëjë me ndonjë organizim kulturor tradicional.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; I.6; II.3; II. 4; III. 3; III. 4; III. 5; V. 8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 1.7; 2.1; 2.5; 3.3; 3.5

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shenjat e pikësimit në dialog

Fjalët kyçe: dialogu, fjalët e autorit, të folësit, pika, pikëpyetja, pikëçuditja

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon fjalët e folësit dhe të autorit;
- Vendos drejt shenjat e pikësimit në dialog;
- Analizon drejt dhe saktë shenjat e pikësimit në dialog.

Kriteret e suksesit:

- Dallo fjalët e autorit me ato të folësit;
- Vendos drejt dhe saktë shenjat e pikësimit;
- Korrigjo shenjat e pikësimit në dialog.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Parashikimi në bazë të titullit

Nxënësve i prezantohet në tabelë titulli i mësimit, së bashku disa foto që kanë të bëjnë me shenjat e pikësimit. Pastaj nxënësit njoftohen pak a shumë se cilat janë shenjat kryesore të pikësimit. Nxënësit përmes fotove shprehin mendimet e tyre për shenjat e pikësimit. Mendimet e secilit nxënës shënohen në tabelë.

REALIZIMI – Lexim i drejtuar

Pastaj hapen librat në faqen 60 dhe më pas nxënësit lexojnë se cilat janë shenjat kryesore të pikësimit. Merren shembuj të ndryshëm, ku janë shenjat kryesore të pikësimit. Pastaj nxënësit njoftohen me ushtrimin 1: *Kuzhinieri po demonstronte përgatitjen e gjellëve*, ku shenjat e pikësimit janë vendosur në vendin e duhur. Pastaj mësuesja së bashku me nxënës punojnë ushtrimin 2, ku do të vendosin shenjat e pikësimit aty ku duhet te fjalitë e dhëna. Në fund jepen komentet e nevojshme dhe plotësuese.

REFLEKTIMI – Analizo - shkruaj

Në këtë etapë të orës mësimore nxënësit do të shkruajnë nga një fjali për secilën shenjë të pikësimit: *Pikën, presjen, pikëpyetjen dhe pikëçuditjen*. Krejt në fund, mësuesja i urdhëron nxënësit që punën e bërë ta prezantojnë para të tjerëve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore në fjalë, si dhe për saktësinë e përgjigjeve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyre shtëpie: Të shkruajnë me fjali, ku në fund të tyre do të vendosin shenjat e pikësimit që kërkohen.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.4; I.6; II.1 ; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Verorja (ora e parë)

Fjalët kyçe: Verorja, Dasho Rrapi, Quli, Qeli, dialogu

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Shpreh njohuritë për dialogun;
- Përgjigjet në pyetjet që janë në tekst;
- Njihet me personazhet e tekstit.

Kriteret e suksesit:

- Dallo dialogun në tekst;
- Dallo shenjën e pikësimit që vendoset në fillim të dialogut;
- Dallo ndërhyrjen e narratorit (rrëfyesit).

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Diskutim për njohuritë paraprake

Diskutohet së bashku me nxënës për dialogun. Si zhvillohet dialogu. Nxënësit përgjigjen në pyetjet e mëposhtme:

- *Çka është dialogu?*
- *Çfarë kemi të vendosur para bisedës – dialogut?*
- *A kemi në dialog edhe ndërhyrjen e narratorit (rrëfyesit)?*

Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë dhe komentohen bashkërisht.

REALIZIMI – Lexim i drejtuar

Para nxënësve prezantohet titulli i pjesës së leximit.

Pjesa e leximit në fjalë lexohet me ndalesa. Pas çdo ndalese u drejtohen pyetje nxënësve rreth përmbajtjes së tekstit, si dhe inkurajohen nxënësit të japin parashikime për ngjarjen që do të ndodhë në vazhdim. Pyetjet që mund të parashtrohen:

- *Pse e pështynin Veroren?*
- *A mund të bëjë njeriu këlyshë?*
- *Kush nuk e pështyu Veroren?*
- *Kush përcillte kush pështynte e kush jo?*
- *Ç'bënte roja?*
- *Ç'bëri Qeli?*

Gjithashtu, sqarohen edhe fjalët e panjohura. Nxënësit lexojnë me intonacion, duke i respektuar shenjat e pikësimit.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Në këtë etapë mësimore, nxënësit do të ndahen në dy grupe të mëdha dhe do të diskutojnë për argumentet:

Grupi i parë: *Njeriu duhet të veprojë sipas logjikës dhe qëndrimeve të tij;*

Grupi i dytë: *Njeriu duhet të veprojë si të tjerët.*

Pasi të shkruhen argumentet i lexojnë grupet. Gjatë leximit, mbani shënim, nëse mendoni se ndonjë përfundim i grupit tjetër nuk është me vend, hidheni poshtë atë me argumente, duke pranuar edhe sqarimet e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore në fjalë, si dhe për punën e bërë në grupe.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: T'u përgjigjen 7 pyetjeve që janë në faqen 63 dhe 64 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.

Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.4; I.6; II.1 ; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Verorja (ora e dytë)

Fjalët kyçe: Verorja, Dasho Rrapi, Quli, Qeli, dialogu

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përmbledh përmbajtjen e tekstit;
- Përshkruan personazhet me disa fjali;
- Plotëson ushtrimet sipas kërkesës që është në libër.

Kriteret e suksesit:

- Përmbledh tekstin me fjalët tuaja;
- Përshkruaj personazhet e tekstit;
- Plotëso detyrat sipas kërkesës që janë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Shqyrtimi i përbashkët

Diskutohet së bashku me nxënës për pyetjet rreth tekstit në fjalë:

- *Cili është mesazhi i pjesë në fjalë?*
- *Në mes të kujt zhvillohet dialogu në këtë fragment?*
- *Shëno karakteristikat e Qulit dhe të Qelit?*
- *Cili nga personazhet në tekst nuk përfshihet fare në dialog?*

Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë dhe komentohen bashkërisht.

REALIZIMI – Lexim në dyshe

Nxënësit lexojnë dyshe.

Nxënësi i parë lexon një pjesë të fragmentit dhe e përmbledh me disa fjali të shkurtra. Nxënësi i dytë parashtron pyetje për atë që u lexua. Pastaj ndërrohen edhe rolet gjatë leximit. Pastaj nxënësit i paraqesin cilësitë e secilit prej personazheve.

REFLEKTIMI – Shkrim i lirë

Në këtë etapë mësimore, nxënësit do të udhëzohen që të shkruajnë me fjali të shkurtra për njërin nga personazhet. Punimet e nxënësve lexohen para klasës, ku më pas jepen komente plotësuese.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore në fjalë, si dhe për shkrimin e personazheve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruajeni me fjalët tuaja kuptimin e fragmentit në fjalë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.6; II.2; II.3; II.5; III.1; III.3; III.4; III.8; V.8; VI.2; VI.3;VI.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 1,7; 1.8; 1.9;1.10; 2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7; 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shkrimi i datës

Fjalët kyçe: data, muaji, viti, datë arabe, datë romake

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon datat e shkruara në mënyrë të drejtë;
- Shkruan si duhet datën;
- Korrigjon datat e shkruara gabim.

Kriteret e suksesit:

- Shkruaj saktë datat;
- Numëro mënyrat e shkrimit të muajve në datë;
- Korrigji datat e shkruara gabim.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.


PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Punë individuale

Kërkohet nga nxënësit e ndarë në grupe të shkruajnë sa më shumë data të rëndësishme në jetën e tyre. Secili nxënës del në tabelë për të shkruar një prej datave të rëndësishme. Mësuesja jep vlerësim për secilin rast se a është shkruar drejt apo gabim data. Mësuesja jep informatë, duke shkruar dhe mënyrat tjera se si mund të shkruajmë datat, duke përdorur numrat romakë apo me fjalë. Është e rëndësishme të kujtohet se si shkruhen me fjalë numrat dyshifrorë, treshifrorë dhe katërshifrorë.

REALIZIMI – Rrjeti i diskutimit

Hapen librat në faqen 65 të librit të gjuhës shqipe. Pastaj mësuesja i njofton nxënësit me shkrimin e saktë të datave. Më pas mësuesja vizaton një tabelë. Secili nxënës zgjedh një datë të rëndësishme kombëtare dhe personale dhe e ilustron atë. *Shembull:*



REFLEKTIMI – Punë në çift

Plotësohen detyrat në libër, në faqen 65 do të plotësohen saktë dhe drejt datat e dhëna. Nxënësit vlerësojnë punën e tjetrit me dy yje dhe një dëshirë për: bashkëpunim, fleksibilitet dhe saktësi.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore në fjalë, si dhe për shkrimin e saktë e të drejtë të datave.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të shkruajnë në fletoret e tyre datat e pavarësisë së Shqipërisë, të Kosovës, ditëlindjen e vet, datën se kur u hap Shkolla e parë shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.

Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3,4; II.5; III.1,2,4,5; V.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.4,9,10; 2.5,6; 3.2,7,8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Unë merrem me sport

Fjalët kyçe: sporti, forma fizike, shëndeti, vrapimi

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Trego disa nga sportet që di;
- Shpjego rolin e sportit në shëndetin e njeriut;
- Nxjerr disa rregulla për sportet e përmendura.

Kriteret e suksesit:

- Lexo tregimin me intonacion;
- Fol për sportin tuaj të preferuar;
- Diskuto për sportet në përgjithësi.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Pyetje-përgjigje

Mësuesja së bashku me nxënës përmes pyetjeve – përgjigjeve zhvillon një diskutim me tërë klasën:

- *A ju pëlqen sporti në përgjithësi?*
- *Cilin sport e preferoni?*
- *Për cilën skuadër bëni tifo?*
- *A luani për ndonjë klub sportiv për grupmoshën tuaj?*
- *Cilin sportist e adhuroni?*

Përmes pyetjeve shikohet se sa janë aktivë nxënësit për sa i përket njohurive për sportin.

REALIZIMI – DRTA

Mësuesja e shkruan titullin në tabelë: *Unë merrem me sport*. Pastaj teksti ndahet në dy paragrafë.

Lexohet paragrafi i parë dhe më pas shtrohen pyetjet e nevojshme:

Çka na ndihmon sporti?

Në çka kontribuon sporti?

Përmes sportit njeh shumë persona...

Pastaj kalohet në leximin e paragrafit të fundit, ku nxënësve u shtrohen pyetje që i përkasin paragrafit në fjalë. Pastaj disa nxënës udhëzohen që ta lexojnë tekstin në tërësi. Respektohen shenjat e pikësimit.

REFLEKTIMI – Loja e karriges

Nxënësit udhëzohen ta lexojnë tekstin edhe njëherë në heshtje. Kërkohej të zhvillohet loja e karriges. Sqarohen fjalët e panjohura, nëse ka diçka paqartësi. Në mes të klasës vendoset një karrige dhe nxënësit ulen në të, duke treguar tregimin. Vetë nxënësit i zgjedhin tregimtarët më të mirë. Kështu bëhet rekapitullimi i tregimit në fjalë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore në fjalë, si dhe për lojën me karrige, ku zgjidhen tregimtarët më të mirë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të shkruajnë në fletoret e tyre për sportin, për klubin dhe për sportistin më të preferuar.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3,4; II.5; III.1,2,4,5; V.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.4,9,10; 2.5,6; 3.2,7,8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Majlinda Kelmendi

Fjalët kyçe: Majlinda, Peja, Kosova, xhudoja, Lojërat Olimpike

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Trego disa nga sportet që di;
- Shpjego rolin e sportit në shëndetin e njeriut;
- Nxjerr disa rregulla për sportet e përmendura.

Kriteret e suksesit:

- Lexo tregimin me intonacion;
- Fol për sportin tuaj të preferuar;
- Diskuto për sportet me renome ndërkombëtare.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Diskutimi

Paraqitet tema për të cilën do të diskutohet me nxënësit. Përmend ndonjë nga sportet që di dhe trego cili të pëlqen më së shumti. Nxënësit diskutojnë me radhë brenda grupit për sportet që dinë, për sportistët tanë, etj. Mësuesja kërkon nga nxënësit që në pika të shkurtra të tregojnë për ndonjë sportistë kosovarë, që ka bërë emër në botë.

REALIZIMI – Ditari dypjesësh

Prezantohet tema: *Majlinda Kelmendi* – faqe 67. Më pas tregohet paraprakisht rëndësia e sportit për zhvillimin trupor dhe mendor të njeriut. Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe diskutohet me tërë klasën. Lexohet teksti që ka të bëjë me sukseset e *Majlinda Kelmendit* dhe nxirren informacionet për sportin e xhudos dhe për sukseset e Majlindës në arenën ndërkombëtare. Në një rën anë tregohet lloji i sportit, ndërsa në anën tjetër rregullat që duhen zbatuar për atë sport. Disa nga punimet e nxënësve lexohen dhe vlerësohen.

REFLEKTIMI – Shkrim i lirë

Nxënësit shkruajnë disa fjali për sportin e xhudos, konkretisht për Majlinda Kelmendin. Pastaj shkruajnë për rregullat që duhen zbatuar në sportin e xhudos.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore në fjalë, si dhe për shkrimin që ka të bëjë me sportisten tonë më të mirë – Majlinda Kelmendin.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: T'u përgjigjen 9 pyetjeve në faqen 68 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë – dëgjojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.2; II.5

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.3; 2.2; 2.5; 3.4

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ra si yll, po s’u shua (ora e parë)

Fjalët kyçe: Princesha Argjiro, kala, shkëmbi, humnera

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Tregon përmbajtjen e poezisë;
- Lexon poezinë bukur dhe me intonacion;
- Shpreh emocionet e poezisë dhe nxjerr mesazhin e saj.

Kriteret e suksesit:

- Dallo figurat letrare të krahasimit dhe të epitetit në këtë poezi;
- Trego përmbajtjen e poezisë;
- Lexo bukur poezinë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Bisedë e kombinuar me shpjegim

Së bashku me nxënës zhvillohet një bisedë që ka të bëjë me krijimtarinë letrare të poetit tonë të madh, Ismail Kadare. Mësuesja diskuton për vepra letrare të Kadaresë, me theks të veçantë për veprën fëmijërore: *“Princesha Argjiro”*. Pastaj tregohet në pika të shkurtra për përmbajtjen e veprës.

REALIZIMI – Ditari dypjesësh

Hapen librat në faqen 69 të librit të gjuhës shqipe. Fillimisht, poezinë e reciton mësuesja, kurse nxënësit dëgjojnë recitimin. Pas kësaj nënvizohen fjalët e panjohura dhe sqarohen për nxënësit. Fjalët e panjohura janë: *kala, kamare, mëkoj*. Pastaj vazhdohet leximi pjesë – pjesë i poezisë, si dhe analizohet. Pastaj nxënësit të ndarë dyshe i plotësojnë ushtrimet, që janë në faqen 70 dhe 71. Ushtrime janë të lehta dhe do të rrethohet vetëm përgjigjja e saktë. Më pas plotësohet ditari dypjesësh nga mësuesja dhe nxënësit.

Fjala	Komenti
Vështroi princesha krenare	Princesha qëndroi krenare, edhe kur shikonte trimat e saj që dhanë jetën. Ajo nuk u dorëzua tek armiqtë dhe nuk u frikësua.
Po a zihet ylli vallë?	Argjiroja është e bukur si yll dhe e pakapshme si yjet.
U vërvit si zog në erë	Ajo fluturoi me një shpejtësi në humnerë.
Edhe shkëmbi ju u copëtua, thanë u drodh, u gjallërua	Heroizmi i princeshës tronditi, jo vetëm njerëzit, por edhe shkëmbin.
Se fëmija i saj mbet i gjallë	Ky varg tregon fitoren e jetës mbi vdekjen, vazhdimësinë e jetës.

Më pas, së bashku me nxënës analizohet ditari dypjesësh.

REFLEKTIMI – Shkrim i lirë

Nxënësit shkruajnë disa fjali të shkurtra për heroizmin e princeshës. Pastaj secili lexon atë që ka shkruar para klasës. Jepen komentet dhe bëhen plotësimet e nevojshme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për bisedën e zhvilluar dhe komentet e tyre dhe trimërisë së princeshës, pastaj për plotësimin dhe analizën e ditarit dypjesësh.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: T’u përgjigjen 5 pyetjeve në faqen 70 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë – dëgjojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.2; II.5

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.3; 2.2; 2.5; 3.4

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ra si yll, po s’u shua (ora e dytë)

Fjalët kyçe: Princesha Argjiro, kala, shkëmbi, humnera

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Shkruan fjali të ndryshme për heroizmin;
- Shkruan këshilla të ndryshme që i dedikohen heroizmit;
- Lidh përmbajtjen e peozisë me situata të ndryshme jetësore.

Kriteret e suksesit:

- Shkruaj për heroizmin;
- Shkruaj për qëndresën heroike të popullit tonë;
- Lexo bukur poezinë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Diskutim

Mësuesja ka përgatitur pyetje të ndryshme për nxënësit, si më poshtë:

- *Për çka flet poema?*
- *Kush ishte Argjiroja?*
- *Pse paraqitet Argjiroja si yll?*
- *A ishte Argjiroja ilire?*
- *A shpëtoi djali i Argjiros?*

Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë dhe bashkërisht komentohen.

REALIZIMI – Copëza të përziera

Mësuesja për nxënës ka përgatitur poezinë me tiketa dhe ato i përzien për secilin grup (deri në 4 grupe) dhe kërkon që pasi të jepet shenja, grupet fillojnë të rregullojnë copëzat e përziera. Pra, ta rregullojnë tërë poezinë: ***Ra si yll, po s'u shua***. Kjo lojë do të vazhdojë deri në 5 xhiro dhe pastaj do të shpallet grupi më i mirë dhe më i shpejtë apo grupi që përnjëmend e ka mësuar poezinë në fjalë.

REFLEKTIMI – Pesëvargëshi

Nxënësit do të përpilojnë një pesëvargësh me temën: ***Heroina***.

Heroina
trime e shpejtë
u hodh mëkoi mbeti
Luftoi deri në vdekje.
trimëreshë

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për punën me tiketa, si dhe për përpilimin e pesëvargëshit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të shkruajnë për ndonjë heroizëm.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë – dëgjojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.2; II.5

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.3; 2.2; 2.5; 3.4

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Legjenda e Argjiros (ora e parë)

Fjalët kyçe: legjenda, gojëdhëna, realja, fantastikja

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Tregon se çka është legjenda;
- Dallon elementet e një legjende;
- Analizon elementet e vërteta dhe fantastike të legjendës.

Kriteret e suksesit:

- Trego për legjendat;
- Shkruaj një legjendë;
- Analizo elementet që i kanë legjendat.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:


Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Pemë e mendimeve

Para nxënësve prezantohet një pemë e mendimeve që ka të bëjë me legjendat:

?



Bashkë me nxënës analizohet kjo pemë e mendimeve.

REALIZIMI – Shkrim i drejtuar

Hapen librat në faqen 71 të librit të gjuhës shqipe. Lexohet me vëmendje: *Legjenda e Argjiros*.

Pastaj kalohet në analizimin e elementeve të legjendës. Pastaj nxënësit njoftohen se emri i qytetit të Gjirokastrës vjen pikërisht nga emri i princeshës.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i caktohet si detyrë të shkruajnë një legjendë për vendin, duke bazuar në elemente të vërteta dhe fantastike. Çdo grup paraqet punën e tij para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e legjendës si një gjini letrare. Pastaj, gjithashtu, vlerësohen për dallimin e reales dhe fantastikes.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ushtrimin në faqen 72 të librit të gjuhës, ku do të krahasojnë vargjet e tekstit për princeshën Argjiro.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë – dëgjojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.2; II.5

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.3; 2.2; 2.5; 3.4

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Legjenda e Argjiros (ora e dytë)

Fjalët kyçe: legjenda, gojëdhëna, realja, fantastikja

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Tregon se çka është legjenda;
- Dallon elementet e një legjende;
- Analizon elementet e vërteta dhe fantastike të legjendës.

Kriteret e suksesit:

- Trego për legjendat;
- Shkruaj një legjendë;
- Analizo elementet që i kanë legjendat.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Diskutim

Në këtë etapë të orës mësimore, mësuesja ka përgatitur pyetje të ndryshme lidhur me legjendën për Argjiron:

- *Argjiroja princeshë e cilit qytet ishte?*
- *Pse ky tekst është legjendë?*
- *Pse teksti në fjalë nuk është tekst letrar?*
- *Çka janë legjendat?*
- *Legjendat a kanë më shumë të vërteta a trillime?*

Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë dhe analizohen së bashku me nxënës.

REALIZIMI – Punë në çifte

Nxënësit në çifte angazhohen për të punuar ushtrimin 2 në faqen 73 të librit të gjuhës shqipe. Nxënësit, duke marrë parasysh shkrimet për Argjiron, plotësojnë skemën e dhënë:

2. Të dy legjendat e Argjiros	
Legjenda e Argjiros	Legjenda e Argjiros
A qyteti i Argjiros?	
Çfarë qyteti është ky?	

Më pas, çiftet prezantojnë punën e bërë. Analizohet puna e disa çifteve për t'u siguruar se puna është kryer si duhet.

REFLEKTIMI – Shkrimi i lirë

Nxënësit krejtësisht të pavarur me fjalë të veta do të shkruajnë një shkrim fare të shkurtër për Legjendën e Argjiros. Vlerësimi punës bëhet në fund, ku nxënësit do të paraqesin shkrimin për legjendën në fjalë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e legjendës si një gjini letrare. Pastaj, gjithashtu, vlerësohen për dallimin e reales dhe fantastikes.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të shkruajnë në fletoret e tyre ndonjë legjendë të ngjashme me atë të Argjiros.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; II.8; III.1; III.4; IV. 4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.5; 1.7; 2.1; 2.2; 2.4; 3.2; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Antonimet dhe sinonimet

Fjalët kyçe: antonime, sinonime, emra, mbiemra, ndajfolje

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon antonimet dhe sinonimet;
- Analizon vargjet me kuptim të njëjtë;
- Shndërron fjali që tregojnë të kundërtën e asaj fjalie që është dhënë.

Kriteret e suksesit:

- Dallo antonimet dhe sinonimet;
- Shkruaj çifte antonimike (me kuptim të kundërt);
- Analizo këto lloje fjalish.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Parashikimi nga termat

Prezantohen disa shembuj të ndryshëm, ku janë disa emra, si më poshtë:

Antonime:

*Ditë – natë (emra);
i zi – i bardhë (mbiemra);
dal – hyj (folje);
herët – vonë (ndajfolje).*

Sinonime:

*Djalë – çun;
Vajzë – gocë;
Vështroj – shoh;
Fshat – katund.*

Nxënësit udhëzohen që të gjejnë emra të tillë të përafërt.

REALIZIMI – Lexo, analizo, plotëso

Nxënësit këshillohen që të lexojnë, të analizojnë, por edhe t'i plotësojnë shembujt që janë në libër, në faqen 74 dhe 75 të librit të gjuhës shqipe. Fillimisht, i gjejnë antonimet, sipas shembullit:

Antonimet:

*I keq – i zi
i bardhë – i mirë
i vogël – i shkurtër
i gjatë – i madh
I rrallë – shpeshtë
Hap – larg
ditë – mbyll
afër – natë
zgjat – jap*

Sinonimet:

*Hap _____
Vrapoj _____
Gëzim _____
Shoh _____
Fik _____
Nis _____
Atdhe _____
Djalë _____
Vajzë _____*

Me nxënës së bashku analizohen antonimet dhe sinonimet e dhëna.

REFLEKTIMI – Ditari dypjesësh

Nxënësit udhëzohen që ta plotësojnë tabelën e mëposhtme:

Fjala	Sinonimi	Fjala	Antonimi
Djalë	çun	i bardhë	i zi

Disa nxënës i paraqesin punimet e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për gjithëpërfshirjen e tyre në veprimtaritë mësimore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruaj antonimet në faqen 75 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.

Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; II.8; III.1; III.4; IV. 4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.5; 1.7; 2.1; 2.2; 2.4; 3.2; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Fjalori

Fjalët kyçe: fjalori, libri, kuptimi i fjalës, rend alfabetik

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon llojet e fjalorëve;
- Dallon fjalën bazë në fjalor;
- Rendit sipas rendit alfabetik fjalët që janë dhënë.

Kriteret e suksesit:

- Dallo fjalorët;
- Përcakto elementet ndihmëse për gjetjen e fjalëve në fjalor;
- Rendit fjalët sipas alfabetit.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Mësuesja bisedon me nxënësit për pyetjet e parashtruara:

- Çfarë lloje fjalorësh kemi?
- A e dini se si përdoren?
- Kur duhet të përdoren fjalorët?
- A keni fjalorë në shtëpi?
- A mendoni se çdo familje duhet të ketë fjalorë në shtëpi?

Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë, diskutohen, analizohen dhe komentohet bashkërisht me nxënësit.

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapet libri i gjuhës shqipe në faqen 75. Pastaj lexohen të dhënat e librit, ku nxënësit njoftohen me fjalorin, si dhe me renditjen alfabetike të tij. Më nxënës diskutohet se si e gjejmë fjalën në fjalor sipas rendit alfabetik. P.sh. *Dasm-ë, ~A f sh ~A, ~AT, faqe 294.*

Shikojmë shkronjën e parë (**d**)

Shikojmë shkronjën e dytë (**da**)

Shikojmë shkronjën e tretë (**das**)

e me radhë...

Gjejmë kuptimin e fjalës *dasmë* dhe shohim edhe veçoritë gramatikore të fjalës.

REFLEKTIMI – Diskutim

Së bashku me nxënës diskutojmë edhe rreth asaj se cilat mund të jenë llojet e fjalorëve. Fjalorët mund të jenë: *shpjegues, terminologjik, historik, enciklopedik, drejtshkrimor, njëgjuhësh, dygjuhësh.*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për shprehitë e fituara gjatë orës mësimore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Fjalët e dhëna në faqen 75 të librit të gjuhës shqipe të shkruhen sipas rendit alfabetik.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; II.8; III.1; III.4; IV. 4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.5; 1.7; 2.1; 2.2; 2.4; 3.2; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Homonimet

Fjalët kyçe: homonimet, përputhja fonetike

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon homonimet si fjalë me kuptime të ndryshme;
- Ndërton fjali me homonime;
- Pasuron leksikun e shqipes me sa më shumë homonime.

Kriteret e suksesit:

- Dallo homonimet;
- Ndërto fjali duke përdorur homonime;
- Pasuro shqipen me homonime.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Diskutim

Me nxënës diskutohen disa fjalë të mëposhtme, si:

Bari (emër) dhe *bari* (bimë)

Verë (pije) dhe *verë* (stinë)

Ari (metal) dhe *ari* (kafshë)

Akrep (emër) dhe *akrep* (insekt)

Bel (vegël) dhe *bel* (pjesë e trupit)

Fletë (emër) dhe *fletë* (gjethe)

Homonimet e mësipërme diskutohen bashkë me nxënës.

REALIZIMI – Të nxënit bashkëpunues

I hapim librat në faqen 76, ku nxënësit njoftohen detajisht me homonimet. Ata lexojnë me kujdes informacionin për homonimet dhe vënë re rastet kur homonimet dalin me të njëjtën formë në të gjitha përdorimet ose vetëm në një përdorim. Me nxënës punohet tabela në faqen 76 të librit të gjuhës shqipe:

Çaj	Sot kemi pirë çaj	Unë po çaj dru
Fiku		
Qepë		
Veshë		
Pata		
Verë		
Ari		
Fletë		

REFLEKTIMI – Punë e pavarur

Nga nxënësit kërkohet që krejtësisht të pavarur të shkruajnë disa homonime. Më pas nxënësit prezantojnë punën e tyre. Jepen këshilla dhe sugjerime të nevojshme nga mësuesja.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për aftësitë e tyre për t'i dalluar dhe përdorur homonimet.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani fjali të ndryshme, ku do të përdorni homonimet.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; II.8; III.1; III.4; IV. 4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.5; 1.7; 2.1; 2.2; 2.4; 3.2; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Figurat stilistike (personifikimi)

Fjalët kyçe: personifikimi, poeti, kafazi, bilbili

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon figurat stilistike (personifikimin);
- Kupton figurën stilistike të personifikimit;
- Formon fjali me figurën stilistike të personifikimit.

Kriteret e suksesit:

- Dallo personifikimin;
- Formo fjali me figurën stilistike në fjalë;
- Gjej figurën stilistike të personifikimit në tekstet e dhëna.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Diskutim

Me nxënës diskutohen pyetjet e mëposhtme:

- *Keni dëgjuar për figurat stilistike?*
- *A mund të na i përmendi disa?*
- *Çka është personifikimi?*

Përgjigjet e nxënësve shënohen në tabelë.

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapet libri në faqen 76. Lexohet poezia: “*Vaji i bylbylit*” i Ndre Mjedjes. Pastaj së bashku me nxënës diskutojmë për poezinë në fjalë. Si poeti i drejtohet kafazit që të hapet dhe bilbili të fluturojë i lirë në natyrë. Me këtë rast u thuhet nxënësve që krijohet figura stilistike e *personifikimit*. Pra, poeti u drejtohet gjërave pa shpirt (objekteve) dhe kafshëve, sikur të ishin njerëz.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Mësuesja i ndan nxënësit në grupe, ku kërkon që të formulojnë fjali me këtë figurë stilistike, me fjalët: *zog, lumë, dhelpër, ari, mal*, etj. Në fund prezantohet puna e grupeve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për diskutimet përmbajtjesore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: T’u përgjigjen pesë pyetjeve në faqen 77 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; II.8; III.1; III.4; IV. 4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.5; 1.7; 2.1; 2.2; 2.4; 3.2; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Hiperbola

Fjalët kyçe: hiperbola, figurë retorike, efekte humori, ironia

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon figurat stilistike (hiperbolën);
- Kupton figurën stilistike të hiperbolës;
- Formon fjali me figurën stilistike të hiperbolës.

Kriteret e suksesit:

- Dallo hiperbolën;
- Formo fjali me figurën stilistike në fjalë;
- Gjej figurën stilistike të hiperbolës në tekstet e dhëna.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Diskutim

Me nxënës diskutohen pyetjet e mëposhtme:

- *Keni dëgjuar për figurat stilistike?*
- *A mund të na i përmendi disa?*
- *Çka është hiperbola?*

Përgjigjet e nxënësve shënohen në tabelë.

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapet libri në faqen 77. Lexohet për figurën stilistike të hiperbolës. Pastaj së bashku me nxënës diskutojmë për hiperbolën. Mësuesja i pyet nxënësit se a kanë dëgjuar fjalë të tilla të rriturit gjatë bisedave. Pastaj a e kanë kuptuar plotësisht figurën stilistike të hiperbolës. Pastaj pyet nxënësit se a i zmadhojnë ndonjëherë gjërat gjatë bisedës.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Mësuesja i ndan nxënësit në grupe, ku kërkon që të formulojnë sa më shumë fjali me hiperbola. Kjo mund të jetë njëfarë gare në mes të grupeve. Në fund, grupet prezantojnë punën e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për diskutimet përmbajtjesore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: T'u përgjigjen katër pyetjeve në faqen 78 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; II.8; III.1; III.4; IV. 4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.5; 1.7; 2.1; 2.2; 2.4; 3.2; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Litota

Fjalët kyçe: litota, figurë letrare, retorike

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon figurat stilistike (litotën);
- Kupton figurën stilistike të litotës;
- Formon fjali me figurën stilistike të litotës.

Kriteret e suksesit:

- Dallo litotën;
- Formo fjali me figurën stilistike në fjalë;
- Gjej figurën stilistike të litotës në tekstet e dhëna.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Diskutim

Me nxënës diskutohen pyetjet e mëposhtme:

- *Keni dëgjuar për figurat stilistike?*
- *A mund të na i përmendi disa?*
- *Çka është litota?*

Përgjigjet e nxënësve shënohen në tabelë.

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapet libri në faqen 78. Lexohet për figurën stilistike të litotës. Pastaj së bashku me nxënës diskutojmë për litotën. Mësuesja i pyet nxënësit se çfarë figure është litota . Pastaj a e kanë kuptuar plotësisht figurën stilistike të litotës. Pastaj pyet nxënësit se a e përdorin këtë figurë gjatë bisedës.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Mësuesja i ndan nxënësit në grupe, ku kërkon që të formulojnë sa më shumë fjali me litota. Në fund, grupet prezantojnë punën e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për diskutimet përmbajtjesore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: T'u përgjigjen tri pyetjeve në faqen 78 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.

Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; II.8; III.1; III.4; IV. 4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.5; 1.7; 2.1; 2.2; 2.4; 3.2; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Krahasimi

Fjalët kyçe: krahasimi, figurë letrare, ngjashmëri, pamje, cilësi

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon figurat letrare (krahasimin);
- Kupton figurën letrare të krahasimit;
- Formon fjali me figurën letrare të krahasimit.

Kriteret e suksesit:

- Dallo krahasimin;
- Formo fjali me figurën letrare në fjalë;
- Gjej figurën letrare të krahasimit në tekstet e dhëna.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Diskutim

Me nxënës diskutohen pyetjet e mëposhtme:

- *Keni dëgjuar për figurat stilistike?*
- *A mund të na i përmendi disa?*
- *Çka është krahasimi?*

Përgjigjet e nxënësve shënohen në tabelë.

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapet libri në faqen 79. Lexohet për figurën letrare të krahasimit. Pastaj së bashku me nxënës diskutojmë për krahasimin. Mësuesja në vazhdim u tregon nxënësve se figura letrare e krahasimit përdoret shpesh në komunikimin e përditshëm, në letërsinë artistike, gojore (popullore), si dhe te këngët në përgjithësi. Kjo figurë është e përafërt me metaforën.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Mësuesja i ndan nxënësit në grupe, ku kërkon nga grupet që të formojnë fjali me disa nga këto fjalë: *filxhan, kalem, sy, punëtor, i shkathët, bletë, buburrec, milingonë*, etj. Në fund, grupet prezantojnë punën e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për diskutimet përmbajtjesore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Formoni katër fjali me figurën e krahasimit!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Shkruajmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.2; I.3; II.4; III.4; V.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 2.7; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kuptimet e fjalëve

Fjalët kyçe: kuptimi parësor, i figurshëm, të nënkuptueshme

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon kuptimin parësor dhe të figurshëm të fjalëve;
- Formon fjali, ku fjalët e dhëna të përdoren me kuptimin parësor dhe të figurshëm;
- Analizon kuptimet e fjalëve.

Kriteret e suksesit:

- Dallo kuptimin parësor dhe atë të figurshëm;
- Formo fjali, ku fjalët e dhëna të përdoren me kuptimet në fjalë;
- Analizo kuptimet e fjalëve.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Diskutim

Në tabelë shënohen fjalitë e mëposhtme:

- *Dhelpra e re nuk frikohej.*
- *Shikonte si dhelpër.*

Nga nxënësit kërkohet që të shpjegohet fjala *dhelpër* në të dyja fjalitë e dhëna. Nxënësit sqarojnë të dyja rastet e përdorimit të fjalës *dhelpër*. Mësuesja sqaron se si dallohen kuptimi kryesor nga kuptimi i figurshëm.

REALIZIMI – Studim rasti

Kërkohet nga nxënësit t'i hapin librat në faqen 79 dhe t'i lexojnë informacionet e dhëna. Nxënësit me kujdes shikojnë fjalën *çerdhe*, në shembujt në libër:

Çerdhe zogjsh

Çerdhe fëmijësh

Çerdhe futbollli

Çerdhe hajdutësh

Siç shihet fjala *çerdhe* është përdorur në kuptimin e parë. Pastaj mësuesja merr shembuj edhe të fjalës me kuptim të figurshëm: *Çerdhe e ngrohtë fëmijësh.*

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Në këtë etapë mësimore, nxënësit ndahen në dy grupe të mëdha. Grupi i parë do të punojë ushtrimin A, kurse grupi i dytë do të punojë ushtrimin B. Mësuesja përcjell punën e grupeve, ku në fund përfaqësuesit e grupeve paraqesin punën e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen e tyre në diskutimin e të gjitha çështjeve të shtruara përgjatë gjithë orës mësimore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të punohet ushtrimi i fundit në faqen 80.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.6; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të veshurat shqiptare (ora e parë)

Fjalët kyçe: veshjet, kombi, tradita, kostum, gjuha

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Shpreh njohuritë që ka rreth veshjeve shqiptare;
- Përgjigjet në pyetjet rreth tekstit;
- Flet për traditën si pjesë përcaktuese e një kombi.

Kriteret e suksesit:

- Përgjigju në pyetjet e tekstit;
- Shpreh njohuritë që ke rreth veshjeve të popullit tonë;
- Analizo traditën e popullit shqiptar.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Diskutim për njohuritë paraprake

Me nxënës diskutohet rreth njohurive paraprake që kanë për veshjet shqiptare. Mësuesja parashtron pyetje:

- Çka dini për veshjet shqiptare?
- Sa është e vlefshme ruajtja e veshjeve shqiptare?
- Çfarë ruhet te veshjet kombëtare?

Përgjigjet e tyre shënohen në tabelë.

REALIZIMI – Lexim i drejtuar

Titulli paraqitet para nxënësve: *Të veshurat shqiptare*, faqe 81. Autori: **Faik Konica**.

Teksti lexohet me ndalesa. Pas çdo ndalese, mësuesja u drejton pyetje nxënësve, lidhur me përmbajtjen që lexuam. Gjithashtu, nxënësit inkurajohen të japin mendimet e tyre. Pastaj vazhdohet edhe me paragrafin tjetër. Vepohet njëjtë. Pyetjet e mundshme:

Përse bëhet fjalë në këtë tekst?

Përse është e vlefshme ruajtja e veshjeve?

Kush ishte Baroni Francis Nopça?

Për çfarë veshjesh flitet në tekst?

Cila është porosia e këtij teksti?

Me nxënës sqarohen fjalët e panjohura. Teksti lexohet me intonacion nga nxënësit.

REFLEKTIMI – Shkrim i lirë

Nxënësve u thuhet të shkruajnë çka dinë vetë për veshjet tona kombëtare. Në fund, punimet e nxënësve lexohen para klasës. Jepen komente dhe sqarime plotësuese.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për njohuritë që kanë për të veshurat shqiptare, si dhe për përgjigjet e sakta.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ushtrimet në faqen 82 dhe 83 të plotësohen në libër.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.6; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të veshurat shqiptare (ora e dytë)

Fjalët kyçe: veshjet, kombi, tradita, kostum, gjuha

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përmbledh përmbajtjen e tekstit;
- Plotëson ushtrimet sipas nevojës;
- Përshkruan baronin Francis Nopça.

Kriteret e suksesit:

- Përgjigju në pyetjet e tekstit;
- Shpreh njohuritë që ke rreth veshjeve të popullit tonë;
- Analizo traditën e popullit shqiptar.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Shqyrtimi i përbashkët

Me nxënës diskutohet rreth pyetjeve të mëposhtme:

- *Cila është porosia e pjesës?*
- *Për çfarë veshjesh flitet në këtë pjesë?*
- *Si e kuptoni se teksti është joletrar?*
- *Kush ishte baroni Francis Nopça?*

REALIZIMI – Lexim në dyshe

Nxënësit lexojnë në dyshe. Nxënësi i parë lexon një pjesë të caktuar të tekstit dhe me disa fjali e përmbledh atë. Ndërkaq, nxënësi i dytë parashtron pyetje rreth tekstit që u lexua. Pastaj ndërrohen rolet. Kështu vazhdohet edhe me nxënësit e tjerë, gjithnjë në dyshe. Gjatë leximit, mësuesja inkurajon nxënësit në respektimin e shenjave të pikësimit. Pastaj disa nxënës në dyshe e përmbledhin tekstin para klasës.

REFLEKTIMI – Shkrim i lirë

Nxënësve u thuhet të shkruajnë diçka për gjuhën dhe veshjet shqiptare. Në fund, lexohen punimet e nxënësve para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin në klasë, për leximin e pjesës, si dhe për respektimin e shenjave të pikësimit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të shkruajnë një ese në lidhje me veshjet kombëtare shqiptare.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë – shkruajmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.6; 3.3; 3.6

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shkruajmë ese

Fjalët kyçe: veshjet, kombi, tradita, kostum, gjuha

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përshkruan hapat e shkrimit të esesë;
- Shkruan një ese me temën: “Gjuha dhe tradita”
- Zbaton hapat e përpilimit të esesë sipas fazave të kërkuara.

Kriteret e suksesit:

- Përshkruaj hapat e një eseje;
- Shkruaj një ese për një temë të caktuar;
- Zbato hapat e shkrimit të esesë sipas fazave.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Pyetje

Mësuesja u drejton pyetje nxënësve:

- *Cilët janë hapat që duhet të ndjekim për të shkruar një ese?*

Nxënësit japin përgjigje të ndryshme, të cilat shënohen në tabelë. Diskutohen dhe komentohen përgjigjet e nxënësve.

REALIZIMI – Shkrim i organizuar

Nxënësit këshillohen, që duke i respektuar rregullat e shkrimit të esesë, të shkruajnë një ese me temën: **“Gjuha dhe tradita”**. Nxënësve u tregohet se eseja duhet ta ketë: *hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin*. Gjithashtu duhet shfrytëzuar hulumtimin nga burime të ndryshme: personat e tjerë, librat, informacionet nga interneti. Duhet gjithsesi të shënohet edhe burimi i informatave.

REFLEKTIMI – Rishikimi në dyshe

Në këtë etapë të orës mësimore, nxënësit shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin për të parë shkrimin e tyre. Nëse ka gabime, korrigjohen ato, në mënyrë që shkrimi i esesë të jetë sipas rregullave të kërkuara.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin në klasë dhe për shkrimin e esesë sipas rregullave të kërkuara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të shkruajnë një ese, temën e së cilës do ta përzgjedhin vetë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë – dëgjojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1. I.3. I.6. II.2. II.3. II.5. III.1. III.3. III.4. III.8. V.8. VI.2. VI.3 VI.3. VI.4.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 1.7; 1.8; 1.9; 1.10 2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7 3.1; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Gjuha shqipe

Fjalët kyçe: gjuha shqipe, kështjella, Shqipëria, atdheu

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Rendit me kuptim pjesët e poezisë;
- Përgjigjet në pyetjet rreth poezisë;
- Krahason gjuhën shqipe me gjuhët e tjera.

Kriteret e suksesit:

- Përshkruaj gjuhën shqipe;
- Krahaso gjuhën shqipe me gjuhët e tjera;
- Krijë poezi për gjuhën shqipe.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Copëza të përziera

Nxënësve ju ofrohet poezia e ndarë në vargje në fleta të vogla. Secili nxënës mundohet që të kombinojë këto vargje në mënyrë që të krijojë një poezi me kuptim. Lexojnë pesë nxënës poezinë e krijuar. Versioni i poezisë: *Gjuha shqipe* lexohet nga mësuesja dhe të gjithë nxënësit vetëvlerësojnë punën e tyre. Pyeten nxënësit se kush i renditi copëzat pa gabim. Nxënësit japin mendimet e tyre, të cilat më pas plotësohen nga mësuesja.

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Kujtohen elementet e poezisë dhe nxënësit udhëzohen që ta lexojnë me zë të lartë poezinë. Secili nxënës në fletoret e tyre shkruan tri karakteritika të gjuhës shqipe që i jep autori në poezi, si: *Kur në sulm u hodhën turqit. Të të bënin ty, donin/Shqipëri, memece/Po ja, erdhi Naimi/ Si yll mbi ty ecte*. Më pas, nxënësit fokusohen te analiza e poezisë, duke plotësuar të gjashtë kërkesat, që janë në faqen 85 dhe 86 të librit të gjuhës shqipe.

REFLEKTIMI – Pesëvargëshi

Secilit grup i ofrohet një fletë e bardhë dhe udhëzohen të krijojnë një pesëvargësh për gjuhën shqipe. Pastaj nxënësit individualisht prezantojnë pesëvargëshin para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin në klasë dhe për krijimin e pesëvargëshit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ushtrimin e fundit që është faqen 86: Të shkruajmë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.6; 3.3; 3.6

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Gjuha standarde dhe dialektet

Fjalët kyçe: gjuha standarde, dialektet, norma, drejtshkrimi

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Lexon poezinë e shkruar në dialektin geg;
- Dallon shkrimin në dialekt dhe në gjuhën standarde;
- Përcakton veçoritë gramatikore të dialekteve dhe gjuhës standarde.

Kriteret e suksesit:

- Diskuto për vlerën e dialekteve në pasurimin e fjalorit të shqipes;
- Krahaso dialektin geg e toskë me gjuhën standarde;
- Kthe poezinë nga dialekti geg në gjuhën standarde.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Mësuesja kërkon nga nxënësit që t'u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:

- *Sa dialekte ka gjuha shqipe?*
- *Cilat janë ato?*
- *Ku shtrihen këto dialekte?*
- *Çka është gjuha standarde dhe ku përdoret ajo?*

Nxënësit përgjigjen në pyetjet e parashtruara, ku më pas mësuesja bën plotësimin e përgjigjeve të nxënësve.

REALIZIMI – Lexo-dallo-argumento

Në në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesja lexon poezinë e shkruar në gegërisht: *Gjuha shqipe* e autorit Ndre Mjedja. Nxënësit menjëherë e dallojnë se në cilin dialekt është shkruar poezia. Më pas me nxënës sqarohen fjalët e panjohura. Gjithashtu u thuhet nxënësve se dialekti geg për dallim nga ai tosk ruan zanoret hundore, si grupet: *-ue, vo, n* në mes të dy zanoreve: *Za, nan*, etj. Jepen shembuj edhe të dialektit tosk, ku toskërisht *-n-* ndërmjet dy zanoreve kthehet në *r*, si: *syri, dryri, hiri*, etj. Nxënësit lexojnë me kujdes dallimet në mes të dialekteve në faqen 87 të librit të gjuhës shqipe.

REFLEKTIMI – Diskutim

Në këtë etapë të orës mësimore, së bashku me nxënës bëjmë rrumbullaksim të njësive mësimore në fjalë, ku thuhet se: Gjuha standarde është varianti themelor i gjuhës për fushat e komunikimit publik (shtetëror, ekonomik, politik, shkencor, arsimor dhe kulturor). Tipar themelor i gjuhës standarde është norma, e cila përcaktohet prerazi sipas drejtshkrimit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen e tyre në të gjitha veprimtaritë mësimore, si dhe në bashkëpunimin në mes tyre.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ta gjejnë një poezi apo tekst të shkurtër, që është e shkruar në dialektin geg dhe më pas ta kthejnë atë në gjuhën standarde.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.6; II.2; II.3; II.5; III.1; III.3; III.4; III.8; V.8; VI.2; VI.3;VI.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 1,7; 1.8; 1.9;1.10; 2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7; 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Besëlidhja shqiptare

Fjalët kyçe: drama, lojë skenike, ngjarja

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Numëron personazhet e pjesës tatrore;
- Nxjerr porosinë e pjesës teatrore: “Besëlidhja shqiptare” ;
- Veçon vlerat artistike që duhet t’i ketë aktori.

Kriteret e suksesit:

- Identifiko personazhet pozitive dhe negative;
- Analizo veprimet e personazheve;
- Listo disa karakteristikat që duhet t’i ketë një aktor.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Mësuesja kërkon nga nxënësit që t'u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:

- *A keni shikuar ndonjëherë shfaqje teatrore?*
- *Cilën shfaqje teatrore mund ta veçonit?*
- *Po ju ka pëlqyer ndonjë aktor?*
- *Cili është roli i aktorit në shfaqje?*

Nxënësit japin përgjigjet e mundshme, të cilat shkruhen në tabelë. Pastaj plotësohen eventualisht nga mësuesja.

REALIZIMI – Lexim i drejtuar

Titulli paraqitet para nxënësve: *Besëlidhja shqiptare (pjesë teatrore)*, faqe 88. Autori: *Sulejman Krasniqi*.

Pjesa teatrore lexohet me dy ndalesa. Pas çdo ndalese, mësuesja u drejton pyetje nxënësve, lidhur me përmbajtjen që lexuam. Gjithashtu, nxënësit inkurajohen të japin mendimet e tyre. Pastaj vazhdohet edhe me paragrafin tjetër. Veprohet njëjtë. Pyetjet e mundshme:

- *Ku zhvillohet ngjarja e dramës?*
- *Për cilën periudhë historike bëhet fjalë?*
- *Sa personazhe ka drama?*

REFLEKTIMI – Lexim i orientuar

Pastaj për nxënës ndahen rolet e fillohet me leximin e dramës me role. Gjatë këtij lloji leximi ju jepet mundësia të gjithë nxënësve për të lexuar. Mësuesja jep këshillat e nevojshme. Përcillen nxënësit gjatë leximit dhe shikohet se a po respektohen shenjat e pikësimit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen e tyre në të gjitha veprimtaritë mësimore, si dhe në leximin e dramës me role.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: T'u përgjigjen 5 pyetjeve në faqen 89 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.6; II.2; II.3; II.5; III.1; III.3; III.4; III.8; V.8; VI.2; VI.3;VI.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 1,7; 1.8; 1.9;1.10; 2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7; 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Drama

Fjalët kyçe: dialogu, monologu, autori

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Numëron personazhet e pjesës teatrore;
- Nxjerr porosinë e pjesës teatrore;
- Veçon vlerat artistike që duhet t'i ketë aktori.

Kriteret e suksesit:

- Identifiko personazhet pozitive dhe negative;
- Analizo veprimet e personazheve;
- Listo disa karakteristikat që duhet t'i ketë një aktor.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Mësuesja kërkon nga nxënësit që t'u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:

- *A keni shikuar ndonjëherë dramë?*
- *Cilën dramë mund ta veçonit?*
- *Po ju ka pëlqyer ndonjë aktor?*
- *Cili është roli i aktorit në shfaqje?*

Nxënësit japin përgjigjet e mundshme, të cilat shkruhen në tabelë. Pastaj plotësohen eventualisht nga mësuesja.

REALIZIMI – Rrjeti i diskutimit

Titulli paraqitet para nxënësve: **Drama**, faqe 89.

Së pari, mësuesja lexon tekstin që i dedikohet dramës. Mësuesja tregon se një dramë i dedikohet spektatorit, kurse autori flet përmes tyre. Pastaj, mësuesja i njofton nxënësit se cilat janë elementet kryesore të zhanrit dramatik: *akti, skena, pamja, dramaturgu, personazhet, regjia*. Pastaj së bashku me nxënësit, diskutohet për dramën: kush e shkruan tekstin, kush e bën regjinë e kush luan në të.

REFLEKTIMI – Pesëvargëshi

Secilit grup i ofrohet një fletë e bardhë dhe udhëzohen të krijojnë një pesëvargësh për dramën. Pastaj nxënësit individualisht prezantojnë pesëvargëshin para klasës.

Drama			
e mirë		e fuqishme	
interpreton	flet	tregon	
Dramën e shkruan dramaturgu.			
Shfaqje			

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen e tyre në të gjitha veprimtaritë mësimore, si dhe për përpilimin e pesëvargëshit

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: T'u përgjigjen 6 pyetjeve në faqen 90 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.

Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; II.2; II.4; II.5

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 1.10; 2.2; 2.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Fjalët e parme dhe jo të parme (ora e parë)

Fjalët kyçe: e parme, jo të parme, të prejardhura, të përbëra

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon fjalët e parme dhe jo të parme të fjalitë e dhëna;
- Analizon formimin e fjalëve jo të parme;
- Gjen fjalë të reja, duke i marrë për bazë shembujt e librit.

Kriteret e suksesit:

- Dallo fjalë të parme dhe jo të parme;
- Klasifiko fjalët sipas formimit të tyre: të parme, jo të parme
- Gjej fjalë të reja: të parme dhe jo të parme.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Mësuesja shkruan në tabelë fjalën **“Punë”** dhe kërkon nga nxënësit që, mundësisht, ta gjejnë kuptimin e fjalës së dhënë:

Punë: Veprimtari e dobishme e njeriut, që e kryen me forcën e krahut e të mendjes, veprimtari e ndërjegjishme prodhuese, krijuese, organizuese, etj.

Pastaj pyeten nxënësit se fjala e dhënë a mund të jetë fjalë e parme. Nxënësve u thuhet se fjala e dhënë është *fjalë e parme* dhe se nga kjo fjalë formohen fjalët: *punë + marrës, punë + dhënës, punë + tor*, etj.

REALIZIMI – Vëzhgo-analizo-plotëso

Hapet libri në faqen 91. Lexohen njohuritë gjuhësore për fjalët e parme dhe jo të parme (të prejardhura dhe të përbëra), të cilat janë të shoqëruara me disa shembuj. Nxënësit punojnë nën drejtimin dhe udhëzimin e mësueses.

Fjalë të parme: *dorë, derë, punë, natë, ditë.*

Fjalë të prejardhura: *qytetar, punëtor, rifillim, rindërtim.*

Fjalë të përbëra: *punëmarrës, punëdhënës, lirisdashës, këmbëngul.*

REFLEKTIMI – Punë e pavarur

Në këtë etapë të orës mësimore punohen ushtrimet 1, 2 dhe 3. Në këto ushtrime nxënësit gjejnë fjalët e parme, të prejardhura dhe të përbëra. Pastaj i ndajnë fjalët në pjesë përbërëse, si dhe formojnë fjalë të përbëra.

Treg + tar

Këngë + tar

Krye + qytet

Krye + madh

Mësuesja shikon nxënësit me radhë se a i kanë punuar saktë ushtrimet e dhëna 1, 2 dhe 3. Nxënësit, në bazë të njohurive të fituara kanë arritur që fjalët e dhëna t’i kuptojnë shumë mirë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësve bëhet duke u mbështetur në aftësitë e tyre për të dalluar fjalët e parme dhe jo të parme.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ushtrimet 4, 5 dhe 6 në faqen 91 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; II.2; II.4; II.5

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 1.10; 2.2; 2.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Fjalët e parme dhe jo të parme (ora e dytë)

Fjalët kyçe: e parme, jo të parme, të prejardhura, të përbëra

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Gjen fjalët e parme dhe jo të parme;
- Formon fjali të reja me parashtesa e prapashtesa;
- Krijon fjali duke përdorur fjalë të parme dhe jo të parme.

Kriteret e suksesit:

- Gjej fjali të parme dhe jo të parme;
- Formo fjali të reja me parashtesa dhe prapashtesa;
- Krijoj fjali duke përdorur fjalë të parme dhe jo të parme.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Copëza të përziera

Nxënësve u shpërndahen etiketat me fjalë të parme dhe jo të parme. Ata, pastaj formojnë fjali me to. Për shembull: *Ata në atë ditë punonin shumë. Ata kishin dorë në këtë çështje.* Më pas ata gjejnë fjalët e parme të këto dy fjali të dhëna: *ditë* dhe *dorë*. Fjalët e parme janë fjalë që nuk vijnë nga ndonjë fjalët tjetër. Pastaj marrim shembuj me fjalët e prejardhura: *punishte, punëtor, fshatar*, etj., si dhe me fjalët e përbëra: *kryeqytet, pesëqind, tridhjetë*, etj. Fjalët e mësipërme me një emër quhen fjalë jo të parme.

REALIZIMI – Vëzhgo-analizo-plotëso

Vazhdohet me mësimin në fjalë. Nxënësit udhëzohen që nga fjalët e parme të formojnë fjalë jo të parme. Marrim si shembull ushtrimin 3, ku nxënësit nga fjalët e parme të formojnë fjalë jo të parme: *Sy – Syzi, flokë – flokëverdhë, krye – kryeqytet*, etj.

REFLEKTIMI – Rishikim në dyshe

Në tabelë shkruhen fjalë të parme, ku më pas nxënësit nga këto fjalë të formulojnë fjalë jo të parme: të prejardhura dhe të përbëra: *punë+tor, liri+dashës, ri+fill-im, qytet-ar*, etj. Nxënësit, më pas shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin, në mënyrë që të korrigjojnë gabimet dhe bisedojnë për to.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për mënyrën se si i dallojnë fjalët e parme dhe jo të parme.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Nxënësit të gjejnë fjalë të parme dhe më pas nga ato të krijojnë fjalë jo të parme: të prejardhura dhe të përbëra.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.

Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë – dëgjojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.6; II.2; II.3; II.5;

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 2.1; 2.2; 2.7; 3.1; 3.2; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Skënderbeut

Fjalët kyçe: Skënderbeu, atdheu, shpata, përkrenarja

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Rendit saktë vargjet e poezisë;
- Arsyeton zgjedhjen për pjesën e preferuar të poezisë;
- Përgjigjet në pyetjet rreth poezisë.

Kriteret e suksesit:

- Numëro fitoret e Skënderbeut;
- Zgjidh një pjesë të poezisë dhe shpjegoje me fjalët tuaja;
- Identifiko figurat letrare dhe rimat në poezi.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Copëza të përziara

Nxënësit ndahen në dyshe. Atyre ju jepet në copëza të përziara poezia. Pra, poezia e ndarë në vargje i ofrohet secilit çift të nxënësve. Kërkohet nga ta që këto vargje t'i rendisin në mënyrë që poezia të ketë kuptim në fund. Lexohet renditja e vargjeve nga secili çift. Mësuesja me informatë kthyesë vlerëson se si kanë punuar nxënësit te poezia: *Skënderbeut*.

REALIZIMI – Ditari trepjesësh

Mësuesja e lexon poezinë. Pastaj nga nxënësit kërkohet që ta analizojnë mirë e mirë poezinë. Më pas nxënësve u jepen fleta me ngjyra dhe pasi ta kenë analizuar mirë poezinë, kërkohet nga ata që ta zgjedhin pjesën e preferuar, ku në ditarin trepjesësh ta arsyetojnë zgjedhjen, si dhe ta ilustronë pjesën në fjalë.

Pjesa e pëlqyer	Komenti	Ilustrimi

REFLEKTIMI – Turi i galerisë

Nxënësit vendosin në mur të gjitha punimet e bëra në fletën A4 me ngjyrë dhe fëmijët shëtisin, duke vendosur vlerësim me figura te punimet që ata veçojnë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësve bëhet duke u bazuar në punën që kanë bërë te ditari trepjesësh, si dhe aktivitetin: Turi i galerisë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: T'u përgjigjen 10 pyetjeve që janë në libër në faqen 92 dhe 93.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.

Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.2; I.3; II.4; III.4; III.5; III. 8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 2.7; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pjesët përbërëse të fjalës

Fjalët kyçe: tema, mbaresa, rrënja, parashtesa, prapashtesa

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon pjesët përbërëse të fjalës;
- Formon fjalë të prejardhura me parashtesat e prapashtesat e dhëna;
- Analizon këto lloje fjalësh.

Kriteret e suksesit:

- Dallo pjesët përbërëse të fjalës;
- Formo fjalë të prejardhura;
- Analizo lloje të tilla fjalësh.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Mësimin e fillojmë me pyetje të parashtruara për nxënësit:

- Çka quajmë fjalë të parme?
- Çka quajmë fjalë jo të parme?
- Fjalët e parme sa llojesh janë?
- Si formohen fjalët e prejardhura?
- Si formohen fjalët e përbëra?

Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë dhe më pas analizohen e plotësohen nga mësuesja.

REALIZIMI – Mendo-trego-diskuto

Hapen librat në faqen 94. Më pas mësuesja lexon tekstin që është në fillim të mësimin. Pastaj nxënësve u thotë se si pësoi ndryshime fjala **qytetar** gjatë përdorimit: *qytet-ar-i, qytet-ar-in, qytet-ar-it*. Më pas nxënësit njoftohen se tema e fjalës mbetet kur i hiqet mbaresa. Tema bart kuptimin e saj. Tema: vend-i, -it, -it, -in, -it. Mbaresa quhet ndryshimi që pëson fjala gjatë përdorimit, si:

E vend-i vajz-a

GJ i, e vend-it i, e vajzë-s

DH vend-it vajz(ë)s

K vend-in vajz(ë)n

RR prej vend-it vajz(ë)s

Nxënësit njoftohen edhe me pjesët përbërëse të fjalës:

Fjalë të parme: **punë**

Fjalë të prejardhura: **punë+tor**

Fjalë të përbëra: **Krye+qytet**

REFLEKTIMI – Punë e drejtuar

Nën drejtimin e mësueses punohet dhe sqarohet ushtrimi me fjalët e prejardhura që kanë një temë me parashtesë pse prapashtesë, si: *dukje – zhdukje, vesh – zhvesh, treg-tar, arsim-tar*. Me parashtesë dhe prapashtesë: *Për+fill+je, Ri+fill+im*. Në fund, nxënësit e kanë të qartë mësimin në fjalë, ku me disa pyetje sqaruese drejtuar mësueses e bëjnë rekapitullimin e mësimin në fjalë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre që nga etapa e parë e mësimin e deri në përfundim të saj.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Në tekstin “*Gavrosi i vogël*”, që është në fund të faqes 94, t’i gjejnë fjalët e parme, të prejardhura dhe të përbëra.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë – dëgjojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.6; II.2; II.3; II.5; III.1; III.3; III.4; III.8; V.8; VI.2; VI.3;VI.4.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 1,7; 1.8; 1.9;1.10; 2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Amaneti (ora e parë)

Fjalët kyçe: Skënderbeu, Dedë Skura, Zaku, luftëtarët

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Lexon bukur dhe me intonacion;
- Komenton tekstin me fjalët e veta;
- Analizon tekstin: “Amaneti”.

Kriteret e suksesit:

- Lexo bukur duke i respektuar shenjat e pikësimit;
- Krahaso personazhet në këtë tekst;
- Analizon tekstin e lexuar.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Gjej titullin

Së bashku me nxënësit fillohet një bashkëbisedim. Mësuesja për nxënësit ka përgatitur një tekst të shkurtër në një fletë A/4. Tekstin në fjalë ua shpërndanë nxënësve në dyshe dhe më pas i udhëzon të lexojnë tekstin ngadalë dhe me intonacion. Pas leximit nxënësit kanë si detyrë ta gjejnë një titull më të përshtatshëm për tekstin e lexuar. Pas leximit fillohet me pyetjet:

- *Çka mendoni cili do të ishte titulli më i preferuar për tekstin në fjalë?*
- *Pse mendoni se ky titull i përshtatet?*
- *Në çka u bazuat që ia vendosët këtë titull?*

Nxënësit do të japin përgjigje të ndryshme, por do të zgjidhen ata tituj që janë më të përafërt dhe që i përgjigjen tekstit. Pas kësaj, nxënësit i njoftoj me pjesën e leximit: **“Amaneti”**, në faqen 95 të librit të gjuhës shqipe.

REALIZIMI – DRTA

Teksti në fjalë ndahet në dy tërësi logjike. Fillohet me leximin e paragrafit të parë. Pasi të lexohet paragrafi i parë, nxënësve u parashtrohen pyetjet:

- *Kush ishte Dedë Skura?*
- *Çfarë i kishte ndodhur atij?*
- *Kë e kishte pranë ai?*

Nxënësit japin përgjigjet e tyre për paragrafin e parë. Pastaj pyeten se çfarë mund të ndodhë. Kalohet në leximin e paragrafit të dytë, ku shtrohen pyetjet:

- *Kë donte të shihte?*
- *Kush erdhi që i ofroi ta marrë?*
- *Cili ishte amaneti i Dedës?*

Përgjigjet merren nga nxënësit. Më pas pas leximit sipas paragrafëve, lexohet pjesa në tërësi. Sqarohen edhe fjalët e panjohura.

REFLEKTIMI – Dora e pyetjeve

Në këtë etapë të orës mësimore mësuesja i udhëzon nxënësit të punojnë në një fletë të bardhë A/4, ku i vendosin dy duart e tyre dhe pastaj i vizatojnë format e duarve. Në njërin dorë shkruhen pyetjet, kurse në dorën tjetër përgjigjet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre që nga etapa e parë e mësimimit e deri në përfundim të saj.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Në faqen 95 dhe 96 të plotësohen kërkesat që janë në libër.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë – dëgjojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.6; II.2; II.3; II.5; III.1; III.3; III.4; III.8; V.8; VI.2; VI.3;VI.4.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 1,7; 1.8; 1.9;1.10; 2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Amaneti (ora e dytë)

Fjalët kyçe: Skënderbeu, Dedë Skura, Zaku, luftëtarët

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përmbledh përmbajtjen e tekstit;
- Plotëson detyrat sipas kërkesave të dhëna;
- Përshkruan personazhet me disa fjali.

Kriteret e suksesit:

- Plotëso detyrat sipas udhëzimit të dhënë;
- Shpjego tekstin në fjalë;
- Përshkruaj personazhet e tekstit shkurtimisht.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Aktro duke lexuar

Mësuesja kërkon nga nxënësit që të dalin dhe të lexojnë nga një pjesë logjike, duke u mundur të lexojnë sa më mirë dhe duke aktruar. Pasi lexohet pjesa, duke aktruar përfundohet edhe etapa e parë e orës mësimore.

REALIZIMI – Lexim në dyshe

Nxënësit lexojnë në dyshe. Nxënësi i parë lexon një pjesë dhe pastaj e përmbledh atë me disa fjali, kurse nxënësi i dytë parashton pyetje rreth pjesës së lexuar. Gjatë leximit të tekstit ndërrohen rolet. Pastaj mësuesja përmes disa dysheve e përmbledh tekstin në tërësi para klasës.

REFLEKTIMI – Shkrim i lirë

Nga nxënësit kërkohet që të shkruajnë disa fjali për njërin nga personazhet e tekstit në fjalë. Pastaj disa shkrime të nxënësve lexohen para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përmbledhjes së tekstit, si dhe për përshkrimin e njërit prej personazheve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të shkruajnë diçka për Skënderbeun – heroin tonë kombëtar.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë – dëgjojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.6; II.2; II.3; II.5; III.1; III. 3; III.4; III.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 2.1; 2.2; 2.7; 3.1; 3.2; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Çelësi i artë (ora e parë)

Fjalët kyçe: zogu, vullkani, tufani, vargjet

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Identifikon elementet e poezisë;
- Veçon elementet e poezisë;
- Analizon poezinë në tërësi.

Kriteret e suksesit:

- Shkruaj elementet e poezisë;
- Veço elementet që ka poezia;
- Mëso përmendësh poezinë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Copëza të përziera

Nxënësit ndahen në dyshe. Atyre ju jepet në copëza të përziera poezia. Pra, poezia e ndarë në vargje i ofrohet secilit çift të nxënësve. Kërkohej nga ta që këto vargje t'i rendisin në mënyrë që poezia të ketë kuptim në fund. Lexohet renditja e vargjeve nga secili çift. Mësuesja me informatë kthyes vlerëson se si kanë punuar nxënësit.

REALIZIMI – Ditari trepjesësh

Mësuesja e lexon poezinë në faqen 98. Pastaj nga nxënësit kërkohej që ta analizojnë mirë e mirë poezinë. Më pas nxënësve u jepet fleta me ngjyra dhe pasi ta kenë analizuar mirë poezinë, kërkohej nga ata që ta zgjedhin pjesën e preferuar, ku në ditarin trepjesësh ta arsyetojnë zgjedhjen, si dhe ta ilustrojnë pjesën në fjalë.

Pjesa e pëlqyer	Komenti	Ilustrimi

REFLEKTIMI – Turi i galerisë

Nxënësit vendosin në mur të gjitha punimet e bëra në fletën A4 me ngjyrë dhe fëmijët shëtisin, duke vendosur vlerësim me figura te punimet që ata veçojnë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të plotësohen vijat e zbrazëta në faqen 99, si dhe t'u përgjigjen tri pyetjeve.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II. **Klasa:** V

Kompetenca: Lexojmë – dëgjojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.6; II.2; II.3; II.5; III.1; III. 3; III.4; III.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 2.1; 2.2; 2.7; 3.1; 3.2; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Çelësi i artë (ora e dytë)

Fjalët kyçe: zogu, vullkani, tufani, vargjet

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Identifikon elementet e poezisë;
- Veçon elementet e poezisë;
- Analizon poezinë në tërësi.

Kriteret e suksesit:

- Shkruaj elementet e poezisë;
- Veço elementet që ka poezia;
- Mëso përmendësh poezinë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathhtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË
ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Mësuesja u parashtron pyetje nxënësve si më poshtë:

- *Sa vargësh janë strofat e poezisë: **Çelësi i artë?***
- *Çfarë rime kanë vargjet?*
- *Përse flet poeti në poezi?*
- *Pse është e rëndësishme fjala?*

Të gjitha përgjigjet merren nga nxënësit dhe shkruhen në tabelë. Analizohen e komentohen.

REALIZIMI – Copëza të përziera

Mësuesja për nxënës ka përgatitur poezinë me tiketa dhe ato i përzien për secilin grup (deri në 4 grupe) dhe kërkon që pasi të jepet shenja, grupet fillojnë të rregullojnë copëzat e përziera. Pra, ta rregullojnë tërë poezinë: **Çelësi i artë**. Kjo lojë do të vazhdojë deri në 5 xhiro dhe pastaj do të shpallet grupi më i mirë dhe më i shpejtë apo grupi që përnjëmend e ka mësuar poezinë në fjalë. Pasi poezia tashmë është përvetësuar, nxënësit do të plotësojnë analizën e strofave në faqen 100 të librit.

REFLEKTIMI – Pesëvargëshi

Do të përpilohet një pesëvargësh me temën: **Çelësi**.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Mëso poezinë përmendësh.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.2; I.3; II.4; III.4; V.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 2.7; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Emri i përgjithshëm dhe emri i përveçëm

Fjalët kyçe: emri, emër i përgjithshëm, i përveçëm,

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Identifikon emrin në fjali;
- Tregon kujt i përkasin emrat në fjalë;
- Sqaron se me çfarë shkronje fillojnë këta emra.

Kriteret e suksesit:

- Dallo këta emra në fjali;
- Trego cilit grup i përkasin emrat në fjalë;
- Sqaro se me çfarë shkronje fillojnë emrat e dhënë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Krijim i lirë

Mësuesja kërkon nga nxënësit, që për një kohë të shkurtër të shkruajnë një tekst, ku do të përdorëshin emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm. Më pas, bashkë me nxënësit do të analizohet ky tekst, ku do t'i identifikojmë emrat e përgjithshëm, por edhe ata të përveçëm. Pra, nxënësit informohen saktësisht se emrat e përgjithshëm shkruhen me shkronjë të vogël, kurse emrat e përveçëm shkruhen me shkronjë të madhe.

REALIZIMI – Vëzhgo - plotëso

Hapen librat në faqen 101 të librit të gjuhës shqipe. Fillimisht, mësuesja lexon pjesën e parë, ku shkruan se çka janë emrat e përgjithshëm e çka ata të përveçëm. Pastaj punohet ushtrimi 1, ku lexohet teksti e më pas do të nënvizohen emrat e përveçëm dhe ata të përgjithshëm. Pastaj emrat e zgjedhur do të hedhen në një tabelë, të formuar enkas për këtë pjesë të leximit.

Emra njerëzish	Emra kafshësh	Emra sendesh e vendesh

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit ndahen në dy grupe të mëdha, ku do të punojnë së bashku. Do të jepen si shembull emrat: *derë, dorë, letër, klasë, dritare*. Grupi i parë do të tregojë se e janë emrat të përveçëm apo të përgjithshëm, kurse grupi i dytë do të tregojë se emrat e dhënë a janë emrat konkretë apo abstraktë. Më pas përfaqësuesit e grupeve do të prezantojnë punën e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet dhe mendimet e dhëna lidhur me emrat në fjalë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyre shtëpie: Shkruani 10 emra të përveçëm dhe 10 emra të përgjithshëm.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.2; I.3; II.4; III.4; V.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 2.7; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përdorimi i shkronjës së madhe

Fjalët kyçe: shkronja e madhe, emra të përveçëm, rregull

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përdor shkronjën e madhe sipas rregullit që kërkohet;
- Sqaron se ku duhet të përdoret shkronja e madhe;
- Analizon fjalitë me shkronjën e madhe.

Kriteret e suksesit:

- Sqaro se kur duhet të përdoret shkronja e madhe;
- Korrigjo fjalët nëse nuk është përdorur si duhet shkronja e madhe;
- Analizo fjalitë me shkronja të mëdha.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Rrjeti i diskutimit

Mësuesja paraqet në tabelë një tekst, ku nxënësit do t'i identifikojnë shkronjat e mëdha. Më pas, nxënësit do të inkuadrohen në bisedë, duke treguar se ku ndodhen shkronjat e mëdha. Pastaj, mësuesja tregon se fjalia fillon me shkronjë të madhe. Gjithashtu, emrat e përveçëm të vendeve, të rrugëve, të shesheve, të shkollave vihen në thonjëza. Për shembull:

SHFMU “Asim Vokshi”;

Rruga “Dëshmorët e Kombit”;

Më pas emrat që tregojnë festa, institucione, organizata shoqërore, parti politike:

28 Nëntori, 17 Shkurti, Viti i Ri, Partia Demokratike, Kuvendi i Kosovës, Kuvendi i Shqipërisë, etj.

REALIZIMI – Të nxënit në bashkëpunim

Nxënësit udhëzohen t'i hapin librat në faqen 102. Pastaj fillojnë ngadalë ta punojnë ushtrimin 2. Në këtë ushtrim, nxënësit do t'i shkruajnë pesë emra shkollash, sipas shembullit: *SHMU “Asim Vokshi”*. Pasi të plotësohet ushtrimi 2, fillohet me ushtrimin e tretë, ku nxënësit do të plotësojnë pesë emra rrugësh, sipas shembullit: *Rruga “Dëshmorët e Kombit”*. Mësuesja përcjell punën e nxënësve, duke dhënë udhëzime e sqarime të nevojshme.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit ndahen në dy grupe të mëdha, ku do të punojnë së bashku. Nxënësit e grupit të parë do të punojnë ushtrimin 4, ku do të korrigjojnë fjalët e shkruara gabim, kurse grupi i dytë do të punojnë ushtrimin 5, ku do të gjejnë raste që shkronja e madhe nuk është përdorur ku duhet. Për shembull:

Akademia e shkencave

Fakulteti i kimisë

Shkolla “hasan Prishtina”

Pas kësaj pune, grupet paraqesin detyrat e bëra, ku mësuesja bën sqarimet e nevojshme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për përdorimin e saktë të shkronjës së madhe.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani emrat e institucioneve në qytetin tuaj.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.6; I.8; II.5; III.1; III.3; III.4; III.8; V.5; V.8; VI.2; VI.3; VI.3

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10; 2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Çamarrokët

Fjalët kyçe: çamarrokë, manare, mburojë

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Zgjedh një pjesë të pëlqyer të tekstit në fjalë;
- Komenton zgjedhjen e vet;
- Analizon ngjarjen e tekstit në fjalë.

Kriteret e suksesit:

- Veço një pjesë të pëlqyer;
- Komento pjesën e pëlqyer;
- Analizo ngjarjen e tekstit në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Parashikimi përmes fotografisë

Mësuesja paraqet fotografinë para nxënësve dhe kërkon nga nxënësit që për pak minuta të mendojnë dhe të përshkruajnë me fjalë një tregim të shkurtër përmes kësaj fotografie.



REALIZIMI – Ditari dypjesësh

Mësuesja kërkon nga nxënësit që të lexojnë tekstin (faqe 104) me vëmendje dhe pasi ta lexojnë në fletoret e tyre të shkruajnë në njërën anë të fletës Citati dhe në anën tjetër Komenti. Te pjesa e citatit të shkruajnë një pjesë të përzgjedhur nga teksti dhe te pjesa e komentit të shkruajnë komentimin e pjesës së përzgjedhur. Disa nga shkrimet lexohen në klasë dhe në këtë mënyrë bëhet një lloj komentimi i tekstit në fjalë.

Citati	Komenti

Kështu bëhet edhe komentimi i tekstit në fjalë dhe analiza e elementeve të tij.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit ndahen në grupe. Pastaj ashtu të ndarë në grupe do të diskutojnë për ndonjë fëmijë që njihin apo kanë lexuar a parë në film vizatimor, që është çamarrok apo çamarroke. Pasi të vendosin se cila syresh është më çamarrok apo çamarroke do të shkruajnë për të. Në fund secili prezanton punën e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për punën e bërë dhe plotësimin e ushtrimeve në tekst.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyre shtëpie: Shkruani për ndonjë aventurë tënden, kur jeni qortuar nga prindërit!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 1; I. 4; I. 5; I. 6; II. 1; II. 4; II. 5; II. 7; III. 1; III. 2

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.3; 1.4; 1.7; 1.9; 2.2; 2.5; 2.6; 3.7; 3.8; 3.9

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Posedioni pengon Odiseun të kthehet në atdhe (ora e parë)

Fjalët kyçe: Posedioni, Odiseja, Ciklopi, Athina, Hyjnesha Leukota

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Komenton tekstin me fjalët e veta;
- Parashikon rrjedhën e ngjarjes pas çdo ndalese;
- Argumenton vetë titullin: Posedioni pengon Odiseun të kthehet në atdhe.

Kriteret e suksesit:

- Veço një pjesë të pëlqyer;
- Komento pjesën e pëlqyer;
- Analizo ngjarjen e tekstit në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Parashikimi me terma paraprakë

Kontrollohen detyrat e shtëpisë, si dhe bëjmë përsëritjen e njësisë së fundit mësimore. Pastaj mësuesja shënon në tabelë fjalët kyçe: **Posedioni, Odiseu, Ciklopi, Athina, Hyjnesha Leukota**. Nxënësit do të shkruajnë individualisht nga një tregim të shkurtër, duke i marrë për bazë këto fjalë kyçe. Pastaj tregimet e punuara do t'i lexojnë para të tjerëve.

REALIZIMI – Rishikimi në dyshe, leximi i drejtuar

Pasi ndahen në grupe, nxënësit udhëzohen që të hapen librat e gjuhës shqipe në faqen 106, te teksti: **Posedioni pengon Odiseun të kthehet në atdhe** dhe lexojnë deri te ndalesa e parë: - *Hyjnesha Leukota u shfaq pranë tij...* Dhe, sipas ndarjes do të punojnë në grupe për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

- *Kush e vështirësoi udhëtimin e Odiseut?*
- *Sa ditë lundroi Odiseu?*
- *Kush ishte hidhëruar me Odiseun dhe hyjnitë?*
- *Hyjnesha Leukota me kë zhvilloi dialog?*

Nxënësit pos në grupe, diskutojnë edhe në dyshe për mendimet dhe idetë e tyre rreth pyetjeve dhe pastaj ato diskutohen me tërë klasën. Vlerësohen porositi më të bukura, ku ato shkruhen në një kënd të klasës. Pastaj angazhohen disa nxënës që ta lexojnë tekstin. Gjatë leximit nxënësit këshillohen që të respektohen shenjat e pikësimit. Në lexim angazhohen sa më shumë nxënës, në mënyrë që pjesa e leximit në fjalë të kuptohet sa më mirë.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit ndahen në grupe. Pastaj ashtu të ndarë në grupe do të do të punojnë ushtrimet në faqen 108.

Grupi i parë do të shkruajë rreth fjalisë: *Posedioni pengon Odiseun të kthehet në atdhe është mit...*

Grupi i dytë do të shkruajë rreth fjalisë: *Hyjnitë e mitologjisë janë qenie me fuqi, si...*

Grupi i tretë do të shkruajë rreth fjalisë: *Odiseu arrin ta përballojë tërbimin e Posedionit, sepse ndihmohet nga...*

Grupi i katërt do të shkruajë rreth fjalisë: *Odiseu dyshonte edhe kur i ofrohej ndihmë, sepse...*

Nxënësit do të punojnë në grupe, kurse pas mbarimit të detyrave përfaqësuesit e grupeve do ta prezantojnë

punën e bërë në grup. Jepen sqarime e plotësime të nevojshme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për punën e bërë dhe plotësimin e ushtrimeve në tekst.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të shkruajnë për Ciklopin.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 1; I. 4; I. 5; I. 6; II. 1; II. 4; II. 5; II. 7; III. 1; III. 2

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.3; 1.4; 1.7; 1.9; 2.2; 2.5; 2.6; 3.7; 3.8; 3.9

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Posedioni pengon Odiseun të kthehet në atdhe (ora e dytë)

Fjalët kyçe: Posedioni, Odiseja, Ciklopi, Athina, Hyjnesha Leukota

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përmbledh përmbajtjen e tekstit;
- Plotëson detyrat sipas kërkesave të librit;
- Përshkruan personazhet me disa fjali.

Kriteret e suksesit:

- Plotëso detyrat sipas kërksave të librit;
- Komentoj tekstin në fjalë;
- Përshkruaj personazhet e tekstit në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Shqyrtimi i përbashkët

Nxënësve u parashtrihen pyetjet e mëposhtme:

- *Kush ishte Posedioni?*
- *Kush ishte Hyjnesha Athina e Leukota?*
- *Sa ditë lundroi Odiseu?*
- *Kush ishte Ciklopi?*
- *Kush e kishte vrarë Ciklopin?*

REALIZIMI – Lexim në dyshe

Nxënësit lexojnë në dyshe.

Në fillim, lexon nxënësi i parë një pjesë të tekstit dhe pastaj me disa fjali e përmbledh atë, kurse nxënësi i dytë parashtron pyetje rreth pjesës së lexuar. Pastaj gjatë leximit ndërrohen rolet. Kështu vazhdohet edhe me dyshet e tjera, ndërsa krejt në fund disa dyshe e përmbledhin tekstit para tërë klasës.

REFLEKTIMI – Shkrimi i lirë

Nga nxënësit kërkohet që të shkruajnë me disa fjali për njërin nga personazhet që u ka pëlqyer më së shumti. Disa nxënës i lexojnë punimet e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për punën e bërë dhe leximin në dyshe. Gjithashtu, vlerësohen edhe për shkrimin e lirë për personazhin që u ka pëlqyer më së shumti.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ta plotësojnë faqen 109, ku ashtu si e mendojnë ta vizatojnë Ciklopin.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.2; I.3; II.4; III.4; V.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 2.7; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Emrat konkretë dhe abstraktë

Fjalët kyçe: fjalë, konkrete, abstrakte

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Identifikon emrat në fjali;
- Tregon se çka emërtojnë këto fjalë;
- Analizon emrat në fjalë.

Kriteret e suksesit:

- Identifiko emra konkretë dhe abstraktë;
- Trego se cilët janë këta emra;
- Analizo emrat në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Krijim i lirë

Mësuesja kërkon nga nxënësit, që për një kohë të shkurtër të shkruajnë një tekst, ku do të përdorëshin emrat konkretë dhe emrat abstraktë. Më pas, bashkë me nxënësit do të analizohet ky tekst, ku do t'i identifikojmë emrat konkretë, por edhe ata abstraktë. Pra, nxënësit informohen saktësisht se emrat konkretë janë fjalë që emërtojnë diçka që shikohen, preken, ndjehen, kurse emrat abstraktë janë fjalë që emërtojnë diçka që nuk mund të perceptohet dhe nuk mund të paraqitet me vizatim.

REALIZIMI – Vëzhgo - plotëso

Hapen librat në faqen 110 të librit të gjuhës shqipe. Fillimisht, mësuesja lexon pjesën e parë, ku shkruan se çka janë emrat konkretë e çka ata abstraktë. Pastaj punohet detyra, ku nxënësit do të shkruajnë për temën: Pranë lumit (7 – 8 rreshta) dhe pastaj do të gjejnë emrat konkretë dhe abstraktë në dy shtylla:

Emra konkretë	Emra abstraktë

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit ndahen në dy grupe të mëdha, ku do të punojnë së bashku. Do të jepen si shembull emrat: *dashuri, derë, urrëjtje, fletore, mirënjohje, gëzim*. Grupi i parë do të tregojë se cilat janë emrat konkretë, kurse grupi i dytë do të tregojë se emra janë abstraktë. Më pas përfaqësuesit e grupeve do të prezantojnë punën e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet dhe mendimet e dhëna lidhur me emrat në fjalë

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të shkruajnë 10 emra konkretë dhe 10 emra abstraktë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.2; I.3; II.4; III.4; V.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 2.7; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Gjinia dhe numri i emrit

Fjalët kyçe: gjinia mashkullore, femërore, asnjënjëse

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Identifikon emrat e tillë;
- Tregon shembuj me emra të tillë;
- Analizon emrat dhe gjininë e tyre.

Kriteret e suksesit:

- Identifikoj emra të gjinisë mashkullore, femërore dhe asnjënjëse;
- Trego se si krijohen këta emra;
- Gjej emrat e këtyre gjinive.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Krijim i lirë

Mësuesja kërkon nga nxënësit, që për një kohë të shkurtër të shkruajnë një tekst, ku do të përdorëshin emrat gjinisë mashkullore, femërore dhe asnjane. Më pas, bashkë me nxënës do të analizohet ky tekst, ku do t'i identifikojmë emrat e gjinisë mashkullore, femërore dhe asnjane. Pra, nxënësit informohen saktësisht se emrat e gjinisë mashkullore në emëroren e shquar marrin mbarekat: **-i, -u**; emrat e gjinisë femërore marrin mbarekat: **-a, -ja**, kurse emrat e gjinisë asnjane dalin me: **-t, -it**.

REALIZIMI – Vëzhgo - plotëso

Hapen librat në faqen 111 dhe 112 të librit të gjuhës shqipe. Fillimisht, mësuesja lexon pjesën e parë, ku shkruan se me çka përfundojnë emrat e gjinisë mashkullore, femërore e asnjane. Pastaj punohet ushtrimi 1 dhe ushtrimi 2. Në ushtrimin 1, nxënësit do të gjejnë emrat e këtyre gjinive, ku do t'i nënvizojnë ato me ngjyra të ndryshme. Në ushtrimin 2, nxënësit do të shkruajnë emra të gjinisë femërore përballë emra të gjinisë mashkullore. Shembull:

Kali – Pela

Burrë – Grua

Punëtor – Punëtore

Bari - Bareshë

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit ndahen në dy grupe të mëdha, ku do të punojnë së bashku. Do të shkruajnë në shumës të pashquar dhe të shquar emrat në faqen 112 të librit të gjuhës. Grupi i parë do të punojë detyrat e grupit A, kurse grupi i dytë – detyrat e grupit B. Pastaj në fund prezantohen detyrat e punuara. Jepen sqarime e plotësime të nevojshme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet dhe mendimet e dhëna lidhur me emrat në fjalë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të shkruajnë 5 emra të gjinisë mashkullore, 5 emra të gjinisë femërore dhe 5 emra të gjinisë asnjane.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 1; I. 4; I. 5; I. 6; II. 1; II. 4; II. 5; II. 7; III. 1; III. 2

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.3; 1.4; 1.7; 1.9; 2.2; 2.5; 2.6; 3.7; 3.8; 3.9

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Fshehtësia e breshkës (ora e parë)

Fjalët kyçe: Xhuxhi, Bimbashi, kaprolli, kalorësi

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Komenton tekstin me fjalët e veta;
- Parashikon rrjedhën e ngjarjes pas çdo ndalese;
- Argumenton vetë titullin: Fshehtësia e breshkës.

Kriteret e suksesit:

- Veço një pjesë të pëlqyer;
- Komento pjesën e pëlqyer;
- Analizo ngjarjen e tekstit në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Parashikimi me terma paraprakë

Kontrollohen detyrat e shtëpisë, si dhe bëjmë përsëritjen e njësisë së fundit mësimore. Pastaj mësuesja shënon në tabelë fjalët kyçe: *Xhuxhi, Bimbashi, kaprolli, kalorësi*. Nxënësit do të shkruajnë individualisht nga një tregim të shkurtër, duke i marrë për bazë këto fjalë kyçe. Pastaj tregimet e punuara do t'i lexojnë para të tjerëve.

REALIZIMI – Rishikimi në dyshe, leximi i drejtuar

Pasi ndahen në grupe, nxënësit udhëzohen që të hapen librat e gjuhës shqipe në faqen 113, te teksti: *Fshehtësia e breshkës* dhe lexojnë deri te ndalesa e parë: - *Zërin e kishte fare të qetë*. Dhe, sipas ndarjes do të punojnë në grupe për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

Me çfarë merrej Xhuxhi?

Cili ishte mjeti i transportit të tij?

Përse shkoi në fshat Xhuxhi?

Vazhdohet me leximin e paragrafit të dytë. Do të parashtrihen pyetjet, ku përgjigjet do të jepen nga nxënësit. Nxënësit më pas në grupe, diskutojnë në dyshe për mendimet dhe idetë e tyre rreth pyetjeve dhe pastaj ato diskutohen me tërë klasën. Vlerësohen porositë më të bukura, ku ato shkruhen në një kënd të klasës. Pastaj angazhohen disa nxënës që ta lexojnë tekstin. Gjatë leximit nxënësit këshillohen që të respektohen shenjat e pikësisimit. Në lexim angazhohen sa më shumë nxënës, në mënyrë që pjesa e leximit në fjalë të kuptohet sa më mirë.

REFLEKTIMI – Pesëvargëshi

Nxënësit do të përpilojnë një pesëvargësh me temën: *Xhuxhi*.

Xhuxhi
i shkurtër i mençur
shalonte arriti bënte
Ishte një mjek popullor.
shkurtabiq

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet dhe përpilimin e pesëvargëshit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të analizojnë pyetjet në faqen 115 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 1; I. 4; I. 5; I. 6; II. 1; II. 4; II. 5; II. 7; III. 1; III. 2

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.3; 1.4; 1.7; 1.9; 2.2; 2.5; 2.6; 3.7; 3.8; 3.9

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Fshehtësia e breshkës (ora e dytë)

Fjalët kyçe: Xhuxhi, Bimbashi, kaprolli, kalorësi

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përmbledh përmbajtjen e tekstit;
- Plotëson detyrat sipas kërkesave të librit;
- Përshkruan personazhet me disa fjali.

Kriteret e suksesit:

- Plotëso detyrat sipas kërksave të librit;
- Komento tekstin në fjalë;
- Përshkruaj personazhet e tekstit në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Shqyrtimi i përbashkët

Nxënësve u parashtrihen pyetjet e mëposhtme:

- *Me çfarë merrej Xhuxhi?*
- *Cili ishte mjeti i transportit të tij?*
- *Pse shkoi në fshat Xhuxhi?*
- *Si e pritën njerëzit?*
- *Po Bimbashi?*
- *Cilat ishin pasojat?*

REALIZIMI – Leximi në dyshe

Nxënësit lexojnë në dyshe.

Në fillim, lexon nxënësi i parë një pjesë të tekstit dhe pastaj me disa fjali e përmbledh atë, kurse nxënësi i dytë parashtron pyetje rreth pjesës së lexuar. Pastaj gjatë leximit ndërrohen rolet. Kështu vazhdohet edhe me dyshet e tjera, ndërsa krejt në fund disa dyshe e përmbledhin tekstit para tërë klasës.

REFLEKTIMI – Shkrim i lirë

Nga nxënësit kërkohet që të shkruajnë me disa fjali për njërin nga personazhet që u ka pëlqyer më së shumti. Disa nxënës i lexojnë punimet e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për punën e bërë dhe leximin në dyshe. Gjithashtu, vlerësohen edhe për shkrimin e lirë për personazhin që u ka pëlqyer më së shumti.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: T'u përgjigjen 6 pyetjeve në faqet 116 dhe 117.

GJUHA SHQIPE – 5 B
ME FLETORE PUNE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë – dëgjojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 1; I.3; II.2; II.5

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.3; 2.2; 2.5; 3.4

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ekuatori

Fjalët kyçe: Ekuatori, Zana, Dielli

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përgjigjet në pyetjet rreth poezisë;
- Identifikon figurat letrare;
- Provon të shkruajë se si e mendon Ekuatorin.

Kriteret e suksesit:

- Përgjigju në pyetjet që kanë të bëjnë me poezinë;
- Identifiko figurat letrare;
- Provo të shkruash poezi për Ekuatorin.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Paraqiten ilustrime të ndryshme të globit, me theks të veçantë për Ekuatorin. Pastaj për nxënës shtrohen pyetje të mundshme:

- *Çfarë po shihni në foto?*
- *Po kjo vija në mes në çka ju asocon?*
- *Keni dëgjuar ndonjëherë për Ekuatorin?*

REALIZIMI – Lexim i drejtuar

Lexohet poezia dhe analizohet secila strofë përmes disa pyetjeve:

- *A keni folur për Tokën?*
- *Çka na qenka Ekuatori?*
- *Pse pjesa e Ekuatorit është më e thatë?*

Me nxënës diskutohet edhe ndërtimi i strofave, si dhe përdorimi i rimës. Pastaj poezinë në fjalë e lexojnë disa nxënës.

REFLEKTIMI – Shkrim i lirë

Nga nxënësit kërkohet që sipas mundësisë të shkruajnë ndonjë varg për Ekuatorin. Pastaj punimet e tyre ekspozohen te këndi i punimeve letrare. Pastaj disa punime lexohen.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për punën e bërë, për identifikimin e figurave letrare.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: T'u përgjigjen 11 pyetjeve që janë në libër, në faqet 3 dhe 4 të librit të gjuhës.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Parafjalët

Fjalët kyçe: parafjalët, rasat e emrit, grup emëror

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Rendit fjalitë sipas kuptimit;
- Dallon parafjalët në tekst;
- Shkruan drejt dhe pa gabime parafjalët.

Kriteret e suksesit:

- Gjej parafjalët në tekstin e dhënë;
- Trego se çka janë parafjalët;
- Analizo parafjalët.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Copëzat e përziera

Me anë të videoprojektorit nxënësit shohin një tekst, ku parafjalët janë të nënvizuara me ngjyrë të kuqe. Më pas nxënësve u parashtrihen pyetjet si më poshtë:

- Çka janë fjalët me ngjyrë të kuqe?
- Çka dini për parafjalët?

Nxënësit i paraqesin mendimet e tyre, të cilat shënohen në tabelë. Analizohen dhe plotësohen mendimet e nxënësve nga ana e mësueses.

REALIZIMI – Lexo-analizo-plotëso

Nxënësve u thuhet që të lexojnë informacionet nga teksti për parafjalët, që është në faqen 4 të librit të gjuhës (Gjuha shqipe – 5 B). Së bashku me nxënës diskutohet për parafjalët. Nxënësve u thuhet se: *parafjalët i gjejmë para emrave të rasave të ndryshme*. Gjithashtu, nxënësve u tregohet se rasia dhanore nuk përdoret me parafjalë. Pastaj ushtrimin 1 e punojmë së bashku me nxënës, ku në tekstin e paraqitur do t'i dallojmë dhe do t'i nënvizojmë parafjalët.

REFLEKTIMI – Rishikim në dyshe

Pas plotësimit të ushtrimit 1, nxënësit shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin. Korrigjohen gabimet eventuale, si dhe bisedohet për parafjalët në tërësi.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për punën e bërë dhe për gjetjen dhe dallimin e parafjalëve në tekstin e dhënë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Te teksti: *Zënia rob e Guliverit* të gjenden parafjalët dhe të nënvizohen me ngjyrë të kuqe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Luli i vocërr

Fjalët kyçe: oborr, cak, mësuesi, dielli, çizmet

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Rendit veprimet sipas rrjedhës së ngjarjes;
- Lexon në heshtje pjesën në fjalë që t'u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes;
- Mban qëndrim të drejtë ndaj veprimeve dhe sjelljeve të personazheve.

Kriteret e suksesit:

- Shpjego kuptimin e figurshëm të disa fjalëve;
- Zbuloj emrin e autorit;
- Analizo tekstin në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Lojë e diskutim

Para nxënësve, mësuesja përmes videoprojektorit paraqet dy skeda për dy autorë të letërsisë shqipe, që janë të njohur për nxënësit. Të dhënat e para jepen për shkrimtarin *Naim Frashëri*, kurse në skedën e dytë të dhënat janë për *Migjenin*. Kërkohet nga nxënësit të tregojnë, në bazë të pyetjeve në videoprojektor, se për cilët autorë bëhet fjalë. Nëse nxënësit nuk e japin përgjigjen e saktë, atëherë kjo bëhet nga mësuesja.

REALIZIMI – Lexim në heshtje

Hapen librat në faqen 5 dhe lexohet tregimi. Nxënësit udhëzohen të lexojnë në heshtje për t'iu përgjigjur pyetjeve të ndryshme. Gjatë leximit të tregimit nxënësit njihen edhe me fjalët e shprehjet e panjohura. Nxënësve u thuhet që gjatë leximit të jenë të kujdesshëm, ngase do të punohet rubrika: *Të analizojmë gjuhën dhe formën e shkrimit*. Në këtë rubrikë janë gjithsej 5 ushtrime më vete, ku secila prej tyre përmban nga katër përgjigje. Nxënësit do të rrumbullakojnë përgjigjet e sakta.

REFLEKTIMI – Punë e drejtuar

Së bashku me nxënës analizohet gjuha e autorit. Analizohen shprehjet:

Në cak të vet – te këndi ose qoshja e vet.

Hundën picrroke – hundën e vogël.

Tollumba – opinga a këpucë llastiku të sheshta.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen dhe përgjigjet e sakta të nxënësve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: T'u përgjigjen 5 pyetjeve në faqen 5 të librit të gjuhës (Gjuha shqipe – 5 B).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kiara i shkruan një letër Migjenit (ora e parë)

Fjalët kyçe: Kiara, varfëria, fëmijët, mësuesi

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Shpreh njohuritë që ka rreth letrave imagjinare;
- Përgjigjet rreth pyetjet rreth tekstit në fjalë;
- Formulon një përmbyllje tjetër për letrën imagjinare në fjalë.

Kriteret e suksesit:

- Shkruaj një letër imagjinare;
- Përgjigju rreth pyetjeve të tekstit në fjalë;
- Analizo letrën imagjinare në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Diskutim për njohuritë paraprake

Diskutohet me nxënës për njohuritë që i kanë për tekstet apo letrat imagjinare. Nxënësve u parashtrohen pyetjet:

- Çka dini për letrat imagjinare?
- Keni dëgjuar apo lexuar për ndonjë letër imagjinare?

Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë.

REALIZIMI – Lexim i drejtuar

Titulli i letrës imagjinare paraqitet para nxënësve: ***Kiara i shkruan një letër Migjenit.***

Letra imagjinare lexohet me ndalesa. Për çdo ndalesë nxënësve u drejtohen pyetje lidhur me përmbajtjen e letrës imagjinare, si dhe nxiten nxënësit të japin parashikimet për ngjarjen në vazhdim.

Pyetjet që u parashtrohen nxënësve:

- Kush është Kiara?
- Pse e shkroi ajo letrën?
- Kujt ia drejtoi ajo letrën?
- Pse letra e saj është imagjinare?
- Çfarë mësoi Kiara nga skicat dhe poezitë e Migjenit?
- Si kishte dëgjuar Kiara për Lulin dhe Migjenin?

Përgjigjet merren nga nxënësit. Pastaj sqarohen edhe fjalët e panjohura. Më pas fillohet leximi i tekstit, ku nxënësit lexojnë bukur, duke i respektuar shenjat e pikësimit.

REFLEKTIMI – Shkrim i lirë

Nxënësit inkurajohen të formulojnë një përmbyllje mundësisht tjetër për letrën imagjinare të Kiara drejtuar Migjenit. Pastaj nxënësit i lexojnë punimet e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për njohuritë që kanë për letrat imagjinare, si dhe për mënyrën e përmbylljes së letrës imagjinare në fjalë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të plotësohet detyra në faqen 9 të librit të gjuhës shqipe (Gjuha shqipe – 5 B).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.5; 3.4; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kiara i shkruan një letër Migjenit (ora e dytë)

Fjalët kyçe: Kiara, varfëria, fëmijët, mësuesi

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përmbledh përmbajtjen e letrës imagjinare në fjalë;
- Plotëso detyrat sipas kërkesave të dhëna;
- Përshkruan mënyrën e formulimit të kësaj letre imagjinare nga Kiara.

Kriteret e suksesit:

- Shkruaj një letër imagjinare;
- Plotëso detyrat sipas kërkesave të librit;
- Vlerëso letrën imagjinare të Kiarës drejtuar Migjenit.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Shqyrtimi i përbashkët

Me nxënës diskutohen pyetjet në vazhdim:

- *Cili është mesazhi i letrës imagjinare në fjalë?*
- *Pse letra e Kiarës është imagjinare?*
- *A mendoni se gjyshi i Kiarës e njihte Migjenin?*
- *Pse Kiara shkruan: “Ju nuk mund ta imagjinoni të ardhmen e tij, sepse u ndatë nga jeta në kulmin e rinisë?”*

REALIZIMI – Lexim në dyshe

Nxënësit lexojnë në dyshe. Së pari, lexon nxënësi i parë, kurse nxënësit i dytë parashtron pyetje të mundshme dhe rreth asaj që u lexua. Pastaj ndërrohen rolet: lexon nxënësi i dytë, kurse nxënësi i parë parashtron pyetjet. Krejt në fund, mësuesja i angazhon disa dyshe për ta lexuar tekstin dhe për të përmbledhur atë me disa fjali të shkurtra. Jepen sqarime e plotësime të nevojshme nga ana e mësueses.

REFLEKTIMI – Shkrim i lirë

Nxënësit do të shkruajnë disa fjali për Kiarën, e cila i është drejtuar me një letër imagjinare Migjenit. Disa punime të nxënësve do të lexohen dhe do të shihet se si nxënësit e kanë përshkruar letrën imagjinare të Kiarës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për leximin në dyshe dhe për angazhimin e tyre në pjesën e reflektimit, ku kanë shkruar për Kiarën dhe letrën e saj imagjinare drejtuar Migjenit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Nxënësit të shkruajnë një letër imagjinare sipas dëshirës së tyre.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lakimi i emrave

Fjalët kyçe: emër, lakim, rasa, trajta

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon emrin në fjali;
- Dallon emrat sipas lakimit të tyre;
- Përdor në rasa të ndryshme emrat në fjali.

Kriteret e suksesit:

- Dallo emrat në fjali;
- Dallo emrat sipas lakimit të tyre;
- Lexo emrat e lakimeve në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Pyetja sjell pyetjen

Mësuesja përmes videoprojektorit paraqet emra të lakimeve të ndryshme. Pastaj nxënësit inkurajohen që t'i dallojnë mbaresat. Pastaj mësuesja parashtron pyetje:

- Çka është lakimi?
- Si quhen format që merr emri gjatë lakimit?
- Sa rasa ka emri?

Përgjigjet merren nga nxënësit. Nëse nxënësit eventualisht nuk japin përgjigjet që kërkohen, atëherë mësuesja bënë plotësimin e kërkuar.

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapet teksti në faqen 10. Lexohet materiali që ka të bëjë me lakimin e emrave. Mësuesja u thotë nxënësve se: Lakim quajmë format, të cilat i merr emri sipas rasave. Gjuha shqipe ka pesë rasa. Emrat në gjuhën shqipe ndahen në katër lakime:

Lakimi i parë: emrat e gjinisë mashkullore që në emëroren e shquar njëjës mbarojnë me **-i**, si: laps-**i**, lis-**i**;

Lakimi i dytë: emrat e gjinisë mashkullore që në emëroren e shquar njëjës mbarojnë me **-u**, si: shok-**u**;

Lakimi i tretë: emrat femërore që në emëroren e shquar njëjës marrin mbaresën **-a**, si: shkolla, klasa;

Lakimi i katërt: emrat e gjinisë asnjënjësore që mbarojnë me **-t, -it, -te**, si: të shikuarit, të lexuarit.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit ndahen në dy grupe të mëdha. Grupet do të punojnë detyrat e dhëna, ku emrat në numrin njëjës të shquar të shkruhen në njëjës të shquar dhe të tregojnë se cilit lakim i takojnë. Punohet ushtrimi 1.

Grupi A

Lis - _____

Mal - _____

Fushë - _____

Arë - _____

Verë - _____

Peshk - _____

Grupi B

Besim - _____

Kushtrim - _____

Të folur - _____

Të shkruar - _____

Bankë - _____

Fletore - _____

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për lakimet e emrave, gjetjen e rasës së emrave në fjali.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të shkruajnë nga pesë emra për secilin lakim.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lakimi i parë

Fjalët kyçe: emër, lakim, rasa, trajta

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Veçon emrat e lakimit të parë;
- Dallon rasën e emrave;
- Lakon emra të ndryshëm të lakimit të parë.

Kriteret e suksesit:

- Lako emra të lakimit të parë;
- Dallo emrat sipas lakimit të tyre;
- Lexo emrat e lakimit të parë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Kllaster

Bashkërisht me nxënësit kujtohen njohuritë për emrin dhe kujtohet se çfarë është lakimi i emrave, cilat janë rasat e gjuhës shqipe dhe pyetjet për secilën rasë. Të gjitha këto informata shënohen në tabelë. Po ashtu, në tabelë veçohen me ngjyra mbaresat e emrave që futen në lakimin e parë.

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapet teksti në faqen 10. Lexohet materiali që ka të bëjë me lakimin e parë të emrave. Mësuesja u thotë nxënësve se: Lakimi i parë përfshin emrat e gjinisë mashkullore, që në emëroren e shuar njëjës dalin me *-i*, si: laps-*i*, lis-*i*, etj. Gjithashtu, nxënësve iu thuhet se rasia gjinore përdoret për nyjat e përparme: *i*, *e*, *të*, *së*. Rasia rrjedhore përdoret, kryesisht, me një nga parafjalët. Pastaj me nxënësit punohet ushtrimi 1, 2 dhe 3 në klasë, ku nxënësit do të plotësojnë tabelat me lakimin e parë.

REFLEKTIMI – Shqyrtimi kategorizues

Në tabelë shkruhen disa fjali. Këto fjali më pas, nxënësit i shkruajnë në fletoret e tyre. Në vazhdim, nxënësit gjejnë emrat e lakimit të parë. Pastaj hapet diskutimi dhe bëhen plotësimet e nevojshme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për gjetjen e emrave të lakimit të parë dhe për kontributin e dhënë në pjesën përfundimtare të orës mësimore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ushtrimi i katërt, në faqen 11.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lakimi i dytë

Fjalët kyçe: emër, lakim, rasa, trajta

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Veçon emrat e lakimit të dytë;
- Dallon rasën e emrave;
- Lakon emra të ndryshëm të lakimit të dytë.

Kriteret e suksesit:

- Lako emra të lakimit të dytë;
- Dallo emrat sipas lakimit të tyre;
- Lexo emrat e lakimit të dytë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Diskutim

Bashkërisht me nxënësit kujtohen njohuritë për emrin dhe kujtohet se çfarë është lakimi i emrave, cilat janë rasat e gjuhës shqipe dhe pyetjet për secilën rasë. Të gjitha këto informata shënohen në tabelë. Po ashtu, në tabelë veçohen me ngjyra mbaresat e emrave që futen në lakimin e dytë.

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapet teksti në faqen 11. Lexohet materiali që ka të bëjë me lakimin e dytë të emrave. Mësuesja u thotë nxënësve se: Lakimi i dytë përfshin emrat e gjinisë mashkullore, që në emëroren e shquar marrin mbaresën **-u**. Disa emra të lakimit të dytë në emëroren e pashquar njëjës mbarojnë me zanore, si: ari-**u**, dhe-**u**, shi-**u**, bari-**u**, etj. Pastaj me nxënësit punohen ushtrimet 1 dhe 2, ku do të plotësohen këto dy ushtrime, në të dy trajtat dhe në të dy numrat. Shembull: **një mjek – disa mjekë; mjeku – mjekët.**

REFLEKTIMI – Shqyrtimi kategorizues

Në tabelë shkruhen disa fjali. Këto fjali më pas, nxënësit i shkruajnë në fletoret e tyre. Në vazhdim, nxënësit gjejnë emrat e lakimit të dytë. Pastaj hapet diskutimi dhe bëhen plotësimet e nevojshme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për gjetjen e emrave të lakimit të dytë dhe për kontributin e dhënë në pjesën përfundimtare të orës mësimore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ushtrimi i tretë, në faqen 12.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.6; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pritje vëllazërore

Fjalët kyçe: Diana, lufta, nëna, vëllai, mikpritësit

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Shpreh njohuritë që ka rreth ngjarjeve të luftës;
- Përgjigjet në pyetjet rreth tekstit;
- Flet për tmerret e luftës që përjetoi populli ynë.

Kriteret e suksesit:

- Përgjigju në pyetjet e tekstit;
- Shpreh njohuritë që ke rreth ngjarjeve të luftës;
- Analizo tekstin në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Diskutim për njohuritë paraprake

Me nxënës diskutohet rreth njohurive paraprake që kanë për veshjet shqiptare. Mësuesja parashtron pyetje:

- *Keni dëgjuar për luftën e fundit në Kosovë?*
- *Dini për ndonjë masakër që është mbi popullatën shqiptare?*
- *Keni dëgjuar për eksodin e popullit tonë?*
- *Çfarë dini për pritjet vëllazërore që u janë bërë shqiptarëve në vendet ku janë strehuar?*

Përgjigjet e tyre shënohen në tabelë.

REALIZIMI – Lexim i drejtuar

Titulli paraqitet para nxënësve: *Pritje vëllazërore*, faqe 13. Autori: Xh. K.

Teksti lexohet me ndalesa. Pas çdo ndalese, mësuesja u drejton pyetje nxënësve, lidhur me përmbajtjen që lexuam. Gjithashtu, nxënësit inkurajohen të japin mendimet e tyre. Pastaj vazhdohet edhe me paragrafin tjetër. Vepronet njëjtë. Pyetjet e mundshme:

- *Kush e filloi tregimin?*
- *Kush e rrëfeu ngjarjen në tërësi?*
- *Kur kanë ndodhur këto ngjarje tronditëse?*
- *Ku po shkonte Diana me shumë të tjerë?*
- *Përse po iknin nga shtëpitë e tyre?*
- *Si u pritën atje ku shkuan?*

Me nxënës sqarohen fjalët e panjohura. Teksti lexohet me intonacion nga nxënësit.

REFLEKTIMI – Shkrim i lirë

Nxënësve u thuhet të shkruajnë çka dinë vetë për ngjarjet e luftës, si dhe pritjet vëllazërore që u janë bërë shqiptarëve atje ku janë strehuar. Në fund, punimet e nxënësve lexohen para klasës. Jepen komente dhe sqarime plotësuese.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në klasë, si dhe për shkrimin e lirë që e punuan dhe e prezantuan para klasës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruajeni një ngjarje të dëgjuar nga lufta e fundit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Shkruajmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.5; 3.4; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Tregimi (rrëfimi)

Fjalët kyçe: tregimi, ngjarja, paragrafi, autori

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon tregimin (rrëfimin);
- Përcakton elementet e një tregimi të dhënë;
- Dallon strukturën strukturën e tregimit.

Kriteret e suksesit:

- Dallo tregimin (rrëfimin);
- Dallo paragrafët e tregimit;
- Diskuto për ndërtimin e një tregimi (rrëfimi).

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Pyetje - përgjigje


Mësuesja para shtron pyetje, si:

- Çfarë janë tregimet?
- Kush e rrëfen tregimin?
- Kush është në qendër të ngjarjes?
- Çfarë mund të jetë ngjarja?

Përgjigjet jepen nga nxënësit dhe shkruhen në tabelë.

REALIZIMI – Pema e mendimeve

Në tabelë punohet një pemë e mendimeve, ku për bazë kemi tregimin.



REFLEKTIMI – Diskutim

Nxënësit diskutojnë dhe analizojnë të gjitha elementet se si ndërtohet një tregim. Gjithashtu, e kanë parasysh se tregimi ka fillimin, zhvillimin e ngjarjes dhe përfundimin e saj.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në klasë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruajeni një ngjarje, të cilën do t'ua tregojë dikush nga familjarët, por ju ta shkruani në gjuhën standarde. Shkrimi të ketë nga 70 deri në 100 fjalë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lakimi i tretë

Fjalët kyçe: emër, lakim, rasa, trajta

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Veçon emrat e lakimit të tretë;
- Dallon rasën e emrave;
- Lakon emra të ndryshëm të lakimit të tretë.

Kriteret e suksesit:

- Lako emra të lakimit të tretë;
- Dallo emrat sipas lakimit të tyre;
- Lexo emrat e lakimit të tretë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Diskutim

Bashkërisht me nxënësit kujtohen njohuritë për emrin dhe kujtohet se çfarë është lakimi i emrave, cilat janë rasat e gjuhës shqipe dhe pyetjet për secilën rasë. Të gjitha këto informata shënohen në tabelë. Po ashtu, në tabelë veçohen me ngjyra mbaresat e emrave që futen në lakimin e tretë.

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapet teksti në faqen 14. Lexohet materiali që ka të bëjë me lakimin e tretë të emrave. Mësuesja u thotë nxënësve se: Lakimi i tretë përfshin emrat e gjinisë femërore, që në emëroren e shquar njëjës mbarojnë me *-a* ose *-ja*, si: shkoll-*a*, klas-*a*, der-*a*, fletor-*ja*. Po ashtu, theksohet se në lakimin e tretë hyjnë edhe disa emra të gjinisë mashkullore, të cilët tregojnë frymorë, si: *Lekë, Kolë, Ramë, Mustafë*, etj. Pastaj, së bashku me nxënësit punohen ushtrimet 1, 2 dhe 3 në klasë, ku nxënësit do të lakojnë emra të lakimit të tretë, si: *dora, lulja, vajza, fleta*, në të dy trajtat dhe në të dy numrat.

REFLEKTIMI – Shqyrtimi kategorizues

Në tabelë shkruhen disa fjali. Këto fjali më pas, nxënësit i shkruajnë në fletoret e tyre. Në vazhdim, nxënësit gjejnë emrat e lakimit të tretë. Pastaj hapet diskutimi dhe bëhen plotësimet e nevojshme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për gjetjen e emrave të lakimit të tretë dhe për kontributin e dhënë në pjesën përfundimtare të orës mësimore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ushtrimi i katërt, në faqen 14 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shumësi i emrave mashkullorë

Fjalët kyçe: emra, gjinia mashkullore, shumësi i emrave

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Formon shumësin e emrave të gjinisë mashkullore;
- Shkruan saktë dhe pa gabime emrat e gjinisë mashkullore;
- Lakon emra të ndryshëm të gjinisë mashkullore.

Kriteret e suksesit:

- Formo shumësin e emrave mashkullorë;
- Shkruaj saktë emrat mashkullorë;
- Lako pa gabime emrat e gjinisë mashkullore.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Pyetja sjell pyetjen

Mësuesja përmes videoprojektorit paraqet emra të gjinisë mashkullore në numrin njëjës: *drapër, lepur, përrua, mbret*. Pastaj nxënësit inkurajohen që emrat në fjalë t'i kthejnë shumës. Pastaj mësuesja tërheq vëmendjen nxënësve: të përqendrohen te disa emra që shumësin e formojnë me – *nj, -j*. Shembull: *drapër – drapërinj, ari – arinj, lepur – lepuj, etj.*

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapet teksti në faqen 15. Pastaj lexohen shembujt dhe nënvizohet shumësi i emrave mashkullorë. Merren shembuj emrat në njëjës: *ftua, dragua, shkëmb, kalli*, të cilët më pas kthehen në shumës. Me nxënës punohen ushtrimet 1 dhe 2, ku në ushtrimin 1 nxënësit do t'i lidhin me shigjetë emrat e numrit njëjës me ato të numrit shumës. Kurse në ushtrimin e dytë emrat në numrin njëjës i kthejnë në numrin shumës.

REFLEKTIMI – Zbatimi i njohurive të marra

Nxënësit do të punojnë ushtrimin 3 të librit në faqen 15. Do të formojnë gjashtë fjali, të cilat do të kenë njërën nga këto fjalë në shumës të shquar: *Kushëri, lepur, kalli, bari, lumë, përrua*, etj. Në fund, nxënësit i lexojnë punimet e tyre. Mësuesja jep sqarimet plotësuese.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për formimin e shumësit të emrave mashkullorë, si dhe angazhimin e tyre në pjesën përfundimtare të orës mësimore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani 10 emra mashkullorë në njëjës dhe më pas i ktheni ato në numrin shumës.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë – dëgjojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 1; I.3; II.2; II.5

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.3; 2.2; 2.5; 3.4

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Për ty Bacë!

Fjalët kyçe: Adem Jashari, lufta, familja, liria, lapidari

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përgjigjet në pyetjet rreth poezisë;
- Identifikon figurat letrare;
- Provon të shkruajë poezi të ngjashme me luftën e Jasharajve.

Kriteret e suksesit:

- Përgjigju në pyetjet që kanë të bëjnë me poezinë;
- Identifiko figurat letrare;
- Provo të shkruash poezi heroizmin e Adem Jasharit dhe familjes Jashari.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Mësuesja parashtron pyetje për nxënësit:

- *Keni dëgjuar ndonjëherë për ndonjë luftëtar trim?*
- *A mund të na përshkruani ndonjë betejë të zhvilluar?*
- *Dini për ndonjë lapidar që është ngritur në Kosovë në shenjë nderimi për luftëtarët trima?*

REALIZIMI – Lexim i drejtuar

Lexohet poezia dhe analizohet secila strofë përmes disa pyetjeve:

- *Kujt i kushtohet kjo poezi?*
- *Për kë ndizen zjarre për tri ditë?*
- *Kush nuk e ndali luftën për tri ditë para gjithë atij armatimi?*
- *A e keni vizituar Kullën e Jasharajve?*

Me nxënës diskutohet edhe ndërtimi i strofave, si dhe përdorimi i rimës. Pastaj poezinë në fjalë e lexojnë disa nxënës.

REFLEKTIMI – Shkrim i lirë

Nga nxënësit kërkohet që sipas mundësisë të shkruajnë ndonjë varg për trimërinë e Adem Jasharit dhe të familjes Jashari. Pastaj punimet e tyre ekspozohen te këndi i punimeve letrare. Pastaj disa punime lexohen.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për punën e bërë, për identifikimin e figurave letrare.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të shkruajnë një ese për luftën heroike të Adem Jasharit dhe të familjes Jashari.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm

Fjalët kyçe: mbiemra, të nyjshëm, të panyjshëm, mbaresa, nyja

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm;
- Dallon nyjat te mbiemrat e nyjshëm;
- Plotëson shembujt e dhënë në libër.

Kriteret e suksesit:

- Dallo mbiemra të nyjshëm e të panyjshëm;
- Shoqëro emrat e dhënë me mbiemra, duke i përshtatur në gjini dhe në numër me emrat;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Pyetja sjell pyetjen

Mësuesja përmes videoprojektorit paraqet mbiemra të nyjshëm dhe të panyjshëm. Shembull: *i kuq, i lartë, të vjetër, i thatë, e ftohtë, shtegtarë, besnike, fisnik*, etj. Pastaj pyeten nxënësit se çka ju kujtohet për mbiemrat. Nxënësit japin mendimet e tyre, të cilat pastaj plotësohen nga mësuesja.

REALIZIMI – Të nxënit në bashkëpunim

Hapet libri në faqen 18. Pastaj lexohet materiali që ka të bëjë me mbiemrat. Mësuesja kujton se mbiemri është pjesë e ndryshueshme e ligjëratës, që tregon cilësinë e emrit. Sipas formimit mbiemrat janë të nyjshëm dhe të panyjshëm. Me nxënës punohen ushtrimet 1 dhe 2. Te ushtrimin 1 me një vijë do të dallohen mbiemrat e nyjshëm dhe me dy vija mbiemrat e panyjshëm, të cilat janë dhënë në tekstin në fjalë. Ndërkaq, në ushtrimin 2, emrave të dhënë duhet t'ua vendosim një mbiemër, duke bërë përshtatjen në numër dhe në gjini.

Shembull:

Top _____

Fushë _____

Këngë _____

Mësues _____

Nënë _____

Nxënës _____

Shkollë _____

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit do të ndahen në dy grupe të mëdha. Grupi A dhe grupi B te shembujt e mëposhtëm do të shkruajnë njëjën e përparme:

Grupi A

Top _kuq

Djalë _vogël

Mal _madh

Burra _gjatë

Pemë _madhe

Nxënëse _mirë

Grupi B

Letër _bardhë

Makinë _kaltër

Fusha _gjera

Autobus _ri

Tavolina _mëdha

Ushqime _preferuara

Pastaj grupet i prezantojnë detyrat e bëra në grup. Jepen sqarime e plotësime të nevojshme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në gjetjen dhe identifikimin e mbiemrave të nyjshëm e të panyjshëm.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani 10 mbiemra të nyjshëm dhe 10 mbiemra të panyjshëm.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.6; II.2; II.3; II.5; III.1; III.3, III.4; III.8; V.8; VI.2; VI.3;VI. 4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 1,7; 1.8; 1.9;1.10; 2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7; 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kosova ka dhënë shumë figura të shquara, me të cilët mund të ndihemi krenarë para botës (ora e parë)

Fjalët kyçe: personalitete, figura, shkencëtarë, filozofë, civilizim

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Shpreh njohuritë që ka rreth figurave dhe personaliteteve shqiptare;
- Nxjerr porosinë e tekstit;
- Flet për figurat kombëtare të popullit tonë.

Kriteret e suksesit:

- Fol dhe shkruaj për personalitetet dhe figurat kombëtare;
- Diskuto për çmimet që morën figurat në fjalë;
- Analizo figurat kombëtare që përmenden në këtë tekst.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Diskutim për njohuritë paraprake

Me nxënës diskutohet rreth njohurive paraprake që kanë për personalitetet kombëtare. Mësuesja parashtron pyetje:

- *A keni dëgjuar për ndonjë personalitet apo figurë kombëtare?*
- *Në cilat fusha këto personalitete kanë kontribuar?*
- *Keni dëgjuar a janë nderuar me ndonjë çmim këto personalitete?*
- *A mund të na i përmendni disa prej tyre?*

Përgjigjet e nxënësve shënohen në tabelë dhe diskutohen më pas edhe nga mësuesja.

REALIZIMI – Lexim i drejtuar

Titulli paraqitet para nxënësve.

Teksti lexohet me ndalesa. Pas çdo ndalese, mësuesja u drejton pyetje nxënësve, lidhur me përmbajtjen që lexuam. Gjithashtu, nxënësit inkurajohen të japin mendimet e tyre. Pastaj vazhdohet edhe me paragrafin tjetër. Veprohet njëjtë. Pyetjet e mundshme:

- *Për kë flet teksti?*
- *Cilët ishin personalitetet më të njohura në Kosovë?*
- *Pse Nënë Tereza veçohet nga të tjerët?*
- *Pse çmimi NOBEL i është dhënë Nënë Terezës?*
- *Pse përmenden Bekim Fehmiu e Faruk Begolli?*
- *A dini ndonjë person nga fusha e muzikës apo të sportit që ka dhënë kontribut për njohjen e Kosovës?*

Me nxënës sqarohen fjalët e panjohura. Teksti lexohet me intonacion nga nxënësit. Pastaj nxënësit iu përgjigjen pyetjeve në faqen 20 e 21. Përgjigjet plotësohen në libër.

REFLEKTIMI – Shkrim i lirë

Nxënësve u thuhet të shkruajnë çka dinë vetë për personalitetet e lartpërmendura. Nxënësit punojnë të pavarur dhe më pas i prezantojnë shkrimet e tyre para klasës. Mësuesja bashkë me klasën diskutojnë për punimet e nxënësve, ku jepen sqarime e plotësime të nevojshme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në klasë, si dhe për identifikimin e figurave dhe personaliteteve kombëtare.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Hulumto dhe shkruaj për jetën e Gonxhe Bojaxhiut – Nënë Terezës!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II. **Klasa:** V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 1; I. 4; I. 5; I. 6; II. 1; II. 4; II. 5; II. 7; III. 1; III. 2

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1. 3; 1. 4; 1.7; 1.9; 2.2; 2.5; 2. 6; 3.7; 3.8; 3.9

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kosova ka dhënë shumë figura të shquara, me të cilët mund të ndihemi krenarë para botës (ora e dytë)

Fjalët kyçe: personalitete, figura, shkencëtarë, filozofë, civilizim

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përmbledh përmbajtjen e tekstit;
- Plotëson detyrat sipas kërkesave të librit;
- Përshkruan figurat dhe personalitetet kombëtare.

Kriteret e suksesit:

- Plotëso detyrat sipas kërksave të librit;
- Komento tekstin në fjalë;
- Përshkruaj figurat dhe personalitetet kombëtare.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Shqyrtimi i përbashkët

Nxënësve u parashtrihen pyetjet e mëposhtme:

- *Kush ishte Nënë Tereza?*
- *Çka mendoni pse një person fiton çmimin për paqe?*
- *Çfarë çmimi kanë fituar ish-presidenti Rugova dhe veprimtari Adem Demaçi?*
- *Për çka dallohen Bekim Fehmiu e Faruk Begolli?*
- *Kush ishte Nexhmije Pagarusha?*
- *Keni dëgjuar ndonjëherë për Anton Çettën?*
- *Po kush ishte Adem Jashari?*
- *Përgjigjet e nxënësve shënohen në tabelë dhe diskutohen bashkë me nxënësit.*

REALIZIMI – Lexim në dyshe

Nxënësit lexojnë në dyshe.

Në fillim, lexon nxënësi i parë një pjesë të tekstit dhe pastaj me disa fjali e përmbledh atë, kurse nxënësi i dytë parashtron pyetje rreth pjesës së lexuar. Pastaj gjatë leximit ndërrohen rolet. Kështu vazhdohet edhe me dyshet e tjera, ndërsa krejt në fund disa dyshe e përmbledhin tekstit para tërë klasës.

REFLEKTIMI – Pesëvargëshi

Nxënësit do të përpilojnë një pesëvargësh me temën: **Personaliteti**.

Personaliteti
i mençur i madh
bënë punuan kontribuuan
Ndihe mi krenarë para botës.
Figurë

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për leximin në dyshe, si dhe për përpilimin e pesëvargëshit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruaj për personalitetin e ish-presidentit Ibrahim Rugova.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.8; II.5; III.1; III.3; III.4; III.8; V.5; V.8; VI.2; VI.3;VI.3

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.4; 2.1; 2.5; 2.6; 2.7; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Drejtshkrimi i mbiemrave të nyjshëm dhe të panyjshëm me shumësin e pashquar

Fjalët kyçe: mbiemra, të nyjshëm, të panyjshëm, shumësi i shquar, saktë, gabim

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Sqaron lidhjen që kanë emrat dhe mbiemrat në gjini, numër;
- Shkruan saktë mbiemrat e caktuar;
- Identifikon mbiemrat e shkruar gabimisht.

Kriteret e suksesit:

- Përshtat mbiemrat me gjininëdhenumrin e emrit;
- Shkruaj saktë mbiemrat;
- Identifiko mbiemrat e shkruar gabimisht

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projeksi, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Diskutimi për njohuritë paraprake

Nxënësit bashkë me mësuesen diskutojnë njohuritë mbi drejtshkrimin e mbiemrave. Diskutimi bëhet mbi bazën e drejtshkrimit të mbiemrave të nyjshëm e të panyjshëm me shumësin e shquar. Pastaj mbiemrat si duhet të shkruhem saktë e pa gabime në shumësin e pashquar. Për shembull: *djalë besnik – djem besnikë, etj.*

REALIZIMI – Punë e përbashkët

Hapet libri bazë në videoprojektor dhe analizohen të gjitha të dhënat dhe shembujt. Mësuesja bashkërisht me nxënësit komentojnë dhe plotësojnë detyrat dhe sqarimet e dhëna në libër. Jepen shembujt si më poshtë:

Djalë besnik – djem besnikë

Djalë punëtor – djem punëtorë

Shkrimtar i madh – shkrimtarë të mëdhenj

Mësues i ri – mësues të rinj

Djalë trim – djem trima

Vajzë e mirë – vajza të mira.

Pastaj plotësohet ushtrimi 1 në faqen 22, ku nxënësit do t'i shkruajnë në shumësin e pashquar mbiemrat, sipas shembullit: *Vajzë e mirë – vajza të mira; mësues i madh – mësues të mëdhenj.* Kështu vazhdohet edhe me shembujt e tjerë.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit do të ndahen në dy grupe të mëdha. Grupi A dhe Grupi B. Grupi A të shkruajë 10 mbiemra të gjinisë femërore, kurse grupi B do të formojë 5 fjali me mbiemra të dy gjinive. Përcillet puna e grupeve. Në fund, përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e bërë. Jepen sqarime dhe plotësime të nevojshme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre për drejtshkrimin e saktë të mbiemrave të lartpërmendur.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani 10 mbiemra në shumësin e pashquar.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përshtatja e mbiemrit me emrin

Fjalët kyçe: mbiemra, grup emëror, emra, lakimi

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përshtatni mbiemrin me emrin në gjini, në numër dhe në rasë;
- Lakoni mbiemrin së bashku me emrin e cilësuar;
- Plotëson shembujt e dhënë në libër.

Kriteret e suksesit:

- Përshtat mbiemrin me emrin në gjini, në numër dhe në rasë;
- Lako mbiemrin së bashku me emrin e cilësuar;
- Analizo shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Pyetja sjell pyetjen

Mësuesja përmes videoprojektorit paraqet shembuj të përshtatjes së mbiemrit me emrin në gjini, në numër dhe në rasë Shembull: *bankë e re, derë e re, mësues i ri, banka të reja, dyer të reja, mësues të rinj, topa të rinj*, etj. Pastaj pyeten nxënësit se çka ju kujtohet për përshtatjen e mbiemrit me emrin. Nxënësit japin mendimet e tyre, të cilat pastaj plotësohen nga mësuesja.

REALIZIMI – Të nxënit në bashkëpunim

Hapet libri në faqen 23. Pastaj lexohet materiali që ka të bëjë me përshtatjen e mbiemrat me emrin. Mësuesja kujton se mbiemri i takon grupit emëror, prandaj përshtatet me emrin në gjini, në numër dhe në rasë. Mbiemri lakohet së bashku me emrin e cilësuar. Po ashtu, gjatë lakimit të mbiemrit ndryshon vetëm nyja. Shembull:

Një bankë e re – disa banka të reja (trajta e pashquar)

Banka e re - bankat e reja (trajta e shquar)

Një top i ri – disa topa të rinj (trajta e pashquar)

Topi i ri – topa të rinj (trajta e shquar)

Pastaj punohen ushtrimet 1, 2 dhe 3 së bashku me nxënësit. Në ushtrimet 1 dhe 2 nënvizohen mbiemrat, kurse në ushtrimin 3 lakohet emri bashkë me mbiemrin: *letër e bardhë* në trajtën e shquar njëjës dhe shumës.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit do të ndahen në dy grupe të mëdha. Grupi A do të shënojë 5 mbiemra të nyjshëm, kurse grupi B 5 mbiemra të panyjshëm. Në fund gruper paraqesin punën e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në përshtatjen e mbiemrit me emrin në gjini, në numër dhe në rasë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Lakoni emrin bashkë me mbiemrin: *Lis i madh, vajzë e re, lule të bardha* në trajtën e shquar në numrin njëjës dhe në numrin shumës.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.6; II.2; II.3; II.5; III.1; III.3, III.4; III.8; V.8; VI.2; VI.3;VI. 4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 1,7; 1.8; 1.9;1.10; 2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7; 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Dallëndyshja e cirkut Zenit

Fjalët kyçe: cirku Zenit, dallëndyshet, vogëlushi, fokat

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Shpreh njohuritë që ka rreth cirkut dhe akrobatëve;
- Nxjerr porosinë e tekstit;
- Flet për temën, motivin dhe idenë.

Kriteret e suksesit:

- Fol për njohuritë që ke rreth cirkut;
- Diskuto për atë se a mund të përcaktohet koha me moshën e personazhit;
- Analizo fjalët e shkruara gabimisht.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Diskutim për njohuritë paraprake

Me nxënës diskutohet rreth njohurive paraprake që kanë për personalitetet kombëtare. Mësuesja parashtron pyetje:

- *A keni dëgjuar ndonjëherë për fjalën cirk?*
- *Kush punon në cirk?*
- *A keni shkruar ju ndonjëherë në ndonjë cirk?*
- *Çfarë keni parë aty?*

Përgjigjet e nxënësve shënohen në tabelë dhe diskutohen më pas edhe nga mësuesja.

REALIZIMI – Lexim i drejtuar

Titulli paraqitet para nxënësve: *Dallëndyshja e cirkut Zenit*, faqe 25. Autori: Xhani Rodari
Teksti lexohet me ndalesa. Pas çdo ndalese, mësuesja u drejton pyetje nxënësve, lidhur me përmbajtjen që lexuam. Gjithashtu, nxënësit inkurajohen të japin mendimet e tyre. Pastaj vazhdohet edhe me paragrafin tjetër. Veprohet njëjtë. Pyetjet e mundshme:

- *Përse shërben cirku?*
- *Sa nga kafshët e përmendura i kemi parë?*
- *Pse thuhet se djaloshi njohu tigrat para pulave e ariun para maçokut?*
- *Në çfarë moshe filloi djaloshi të ketë pikë të veten në shfaqje?*
- *Çfarë bënin dallëndyshet?*
- *Pse tregimi e ka titullin: Dallëndyshet e cirkut Zenit?*

Me nxënës sqarohen fjalët e panjohura. Teksti lexohet me intonacion nga nxënësit. Pastaj së bashku me nxënës e plotësojmë rubrikën: *Të analizojmë*, ku janë gjithsej 6 pyetje në faqen 27 dhe 28 të librit.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit ndahen në grupe. Mësuesja ua ka caktuar se për çfarë do të shkruajnë ata.

Grupi i parë: Tema

Grupi i dytë: Motivi

Grupi i tretë: Ideja

Grupi i katërt: Kush është rrëfimtari dhe pse?

Në fund prezantohet puna e bërë. Mësuesja jep sqarimet plotësuese.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në klasë, si dhe për punën e bërë në grupe.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të plotësohet grafiku në faqen 29 të librit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përemrat vetorë

Fjalët kyçe: përemrat vetorë, veta, numri njëjës, numri shumës

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon përemrat vetorë në fjalitë e dhëna
- Tregon se cilët përemra i përkasin njerëzve e cilët edhe frymorëve e sendeve;
- Shkruan fjali të ndryshme, duke përdorur përemra vetorë.

Kriteret e suksesit:

- Dallo përemra vetorë në fjali;
- Trego se cilët përemra i përkasin njerëzve e cilët frymorëve e sendeve;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme


Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Mësuesja iu drejton pyetje nxënësve se çka dinë për përemrat vetorë. Paraqet një lloj grafiku përemrat:



REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapen librat në faqen 30. Pastaj lexohet materiali që ka të bëjë me përemrat vetorë. Mësuesja kujton se përemrat vetorë tregojnë veta. Mësuesja, po ashtu, tregon se përemrat e vetës së parë dhe vetës së dytë përdoren vetëm për njerëz. Përemri vetor i vetës së tretë përdoret për të evituar përsëritjen e një emri. Këta përemra përdoren edhe për frymorë dhe për sende. Pastaj mësuesja shkruan në tabelë përemrat vetorë: **unë, ti, ai (ajo), ne, ju, ata (ato)**. Më pas vazhdohet me ushtrimet 1, 2 dhe 3. Në ushtrimin 1 do të gjenden përemrat vetorë në tekstin e dhënë dhe do të nënvizohen. Në ushtrimin 2 fjalitë do të plotësohen me përemrin vetor, kurse në ushtrimin 3 nxënësit do të shkruajnë vetën dhe numrin.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit do të ndahen në dy grupe të mëdha. Grupi A dhe grupi B do të punojnë të pavarur. Grupi A do të punojnë ushtrimin e prezantuar nga mësuesja, ku para fjalëve vendosin përemrin vetor të kërkuar.

Shembull:

Unë shkruaj

_____ shkruanit

_____ shkrove

Kurse grupi B do të formojë fjali me emrat: *nxënësi, shoku, shoqja, fletoret, lapsat, topi, shtëpitë, dera* dhe krenda kllapash do të shkruajnë përemrin vetor.

Shembull:

Nxënësi (Ai) ishte vonuar

Shoku (_____) _____

Shoqja (_____) _____

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e përemrave vetorë, për përshtatjen e tyre në fjali.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani 10 fjali me përemra vetorë

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; II.8; III.1; III.4; IV. 4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.5; 1.7; 2.1; 2.2; 2.4; 3.2; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Figurat e përsëritjes

Fjalët kyçe: Figurë, përsëritje, anaforë

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon figurën e përsëritjes;
- Tregon vëmendjen e lexuesit në një ide të veçantë;
- I jep fuqi shprehëse vargut.

Kriteret e suksesit:

- Dallo anaforën dhe epiforën;
- Trego vëmendjen e lexuesit në një ide të veçantë;
- Dallo fuqinë shprehëse vargut.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Diskutim

Me nxënës diskutohen pyetjet e mëposhtme:

- *Keni dëgjuar për figurat e përsëritjes?*
- *Për çka shërbejnë këto figura?*
- *Keni parë se në vargjet e poezive e njëjta fjalë përsëritet në fillimin e çdo vargu. A thua pse?*

Përgjigjet e nxënësve shënohen në tabelë

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapet librin në faqe 31. Lexohet në pika të shkurtra për figurat e përsëritjes. Lexohen vargjet e Dritëro Agollit, të Kadaresë dhe disa vargje popullore, ku shihet më së miri figura e përsëritjes. Analizohen dhe jepen plotësime të nevojshme.

REFLEKTIMI – Shkrim i lirë

Mësuesja kërkon nga nxënësit, që sipas mundësive dhe shembullit të mësipërm, të krijojnë disa vargje, që kanë figurën e përsëritjes. Disa punime lexohen nga nxënësit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për krijimin e disa vargjeve, ku për bazë kemi marrë figurat e përsëritjes.

Detyrë shtëpie: Gjeneroni nëpër libra të ndryshëm të leximit figurat e përsëritjes dhe disa syresh i shkruani në fletoret tuaja.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lakimi i përemrave vetorë dhe trajtat e shkurtra

Fjalët kyçe: përemrat vetorë, lakimet, rasat, trajtat e shkurtra

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon përemrat vetorë;
- Dallon rasën e përemrave vetorë dhe vendos saktë trajtën e shkurtër që nevojitet;
- Shkruan saktë dhe pa gabime përemrat vetorë.

Kriteret e suksesit:

- Dallo përemra vetorë në fjali;
- Dallo rasën e përemrave vetorë;
- Lako përemrat vetorë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Diskutim i ideve

Mësuesja përmes videoprojektorit ka paraqitur një tekst, ku nxënësit do t'i dallojnë përemrat vetorë, duke i marrë për bazë pyetjet, që janë sipas rasave: *Kë? – ne; kujt? – mua; kush? – ne; kujt? – neve; kujt? – mua.*

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Punohet materiali i dhënë në tekst në faqen 32. Pastaj nxënësit i shohin ndryshimet që pësojnë përemrat vetorë kur përdoren në fjali. Pastaj nxënësit lexojnë në tekst tabelën e lakimit të përemrave vetorë, si dhe i dallojnë trajtat e shkurtra të përemrave vetorë. Në vazhdim nxënësve iu prezantohet tabela e lakimit të përemrave vetorë dhe trajtat e shkurtra:

	VETA I		VETA II		VETA III			
	Njëjës	Shumës	Njëjës	Shumës	Gjinia mashkullore		Gjinia femërore	
					Njëjës	Shumës	Njëjës	Shumës
E.	unë	ne	ti	ju	ai	ata	ajo	ato
Gj.	-	-	-	-	i atij	i atyre	i asaj	i atyre
Dh.	mua më	neve na	ty të	juve ju	atij i	atyre u	asaj i	atyre u
K.	mua më	ne na	ty të	ju ju	atë e	ata i	atë e	ato i
Rr.	meje	nesh	teje	jush	atij (tij)	atyre (tyre)	asaj (saj)	atyre (tyre)

Së bashku me nxënës punohen ushtrimet 1 dhe 2, ku në ushtrimin 1 do t'i nënvizojnë përemrat vetorë dhe trajtat e shkurtra, kurse në ushtrimin 2 do të nënvizohen trajtat e plota dhe trajtat e shkurtra. Jepen sqarime dhe plotësime të nevojshme. Nxënësve u thuhet se trajtat e shkurtra që nuk shkruhen me apostrof janë: *ma, ta, na e, ju, ia, nai, jua, ua*. Ndërkaq, shkruhen me apostrof: *T'i, m'i, t'ia*.

REFLEKTIMI – Punë e pavarur

Nxënësit punojnë të pavarur ushtrimin 3 në faqen 32 të librit, ku në shembullin e dhënë do të plotësohen trajtat e shkurtra. Mësuesja përcjell punën e nxënësve, duke dhënë rekomandimet e nevojshme. Në fund, disa nxënës prezantojnë punën e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për lakimin dhe për gjetjen e përemrave vetorë dhe të trajtave të shkurtra.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruajeni një tekst dhe më pas gjeni përemrat vetorë dhe trajtat e shkurtra.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë – dëgjojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.6; II.2; II.3; II.5; III.1; III. 3; III.4; III.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 2.1; 2.2; 2.7; 3.1; 3.2; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Korça

Fjalët kyçe: Korça, gjuha shqipe

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Identifikon elementet e poezisë;
- Veçon elementet e poezisë;
- Analizon poezinë në tërësi.

Kriteret e suksesit:

- Shkruaj elementet e poezisë;
- Veço elementet që ka poezia;
- Mëso përmendësh poezinë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Copëza të përziara

Nxënësit ndahen në dyshe. Atyre ju jepet në copëza të përziara poezia. Pra, poezia e ndarë në vargje i ofrohet secilit çift të nxënësve. Kërkohej nga ta që këto vargje t'i rendisin në mënyrë që poezia të ketë kuptim në fund. Lexohet renditja e vargjeve nga secili çift. Mësuesja me informatë kthyes vlerëson se si kanë punuar nxënësit.

REALIZIMI – Ditari trepjesësh

Mësuesja e lexon poezinë në faqen 33. Pastaj nga nxënësit kërkohej që ta analizojnë mirë e mirë poezinë. Më pas nxënësve u jepen fleta me ngjyra dhe pasi ta kenë analizuar mirë poezinë, kërkohej nga ata që ta zgjedhin pjesën e preferuar, ku në ditarin trepjesësh ta arsyetojnë zgjedhjen, si dhe ta ilustrojnë pjesën në fjalë.

Pjesa e pëlqyer	Komenti	Ilustrimi

Pastaj nxënësit plotësojnë rubrikën: *Të shkruajmë*, ku do t'u përgjigjen 7 pyetjeve në faqen 34, si dhe rubrika: *Të analizojmë*, ku do të analizojnë tri pyetje të radhës.

REFLEKTIMI – Turi i galerisë

Nxënësit vendosin në mur të gjitha punimet e bëra në fletën A4 me ngjyrë dhe fëmijët shëtisin, duke vendosur vlerësim me figura te punimet që ata veçojnë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyre shtëpie: Në faqen 35 të punohet ushtrimi 1, ku do të vizatojnë një kartolinë dhe do të shkruajnë urimin për mësuesen me rastin e festës së saj.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përemrat pronorë

Fjalët kyçe: përemrat pronorë, veta, numri njëjës, numri shumës

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon përemrat pronorë në fjalitë e dhëna;
- Tregon se përemrat pronorë kanë kategorinë gramatikore të vetes, numrit dhe gjinisë;
- Shkruan fjali të ndryshme, duke përdorur përemra pronorë.

Kriteret e suksesit:

- Dallo përemra pronorë në fjali;
- Trego se përemrat pronorë kanë kategorinë gramatikore të vetës, numrit dhe gjinisë;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme


Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Kllaster

Mësuesja ua paraqet nxënësve një pemë të mendimeve, lidhur me përemrat pronorë:



REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapen librat në faqen 36. Pastaj lexohet materiali që ka të bëjë me përemrat pronorë. Mësuesja kujton se përemrat pronorë kanë kategorinë gramatikore të vetes, të numrit dhe të gjinisë. Mësuesja gjithashtu thekson se përemrat pronorë: **im, ime, jonë, ynë**, nuk shkruhen me nyjë të përparme: **i im, e ime, e jonë, e ynë**. Më pas vazhdohet me ushtrimet 1, 2. Në ushtrimin 1 do të plotësohen vendet e zbrazëta, kurse në ushtrimin 2, në tekstin e dhënë, do të gjenden përemrat pronorë bashkë me kategoritë gramatikore të vetës, të numrit dhe të gjinisë.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit do të ndahen në grupe.

Grupi i parë: Do të punojë ushtrimin 3 të librit.

Grupi i dytë: Do të punojë ushtrimin 4 të librit.

Grupi i tretë: Do të punojë ushtrimin 5 të librit.

Grupi i katërt: Do të punojë ushtrimin 6 të librit.

Më pas grupet do të paraqesin punën e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e përemrave pronorë dhe për përshtatjen e tyre në fjali.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani 10 fjali me përemra pronorë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.6; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mësuesi është i shenjtë

Fjalët kyçe: Laureati (Lali), gjyshi

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Shpreh njohuritë që ka rreth detyrës së shenjtë të mësuesit;
- Përgjigjet në pyetjet rreth tekstit;
- Flet për mësuesin që dhuron dituri.

Kriteret e suksesit:

- Përgjigju në pyetjet e tekstit;
- Shpreh njohuritë që ke rreth detyrës së shenjtë të mësuesit;
- Analizo tekstin në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Diskutim për njohuritë paraprake

Me nxënës diskutohet rreth njohurive paraprake që kanë për mësuesin dhe detyrën e shenjtë që e ka. Mësuesja parashtrohet pyetje:

- *Keni dëgjuar për fjalën: e shenjtë?*
- *Si ka qenë mësuesi përpara?*
- *Dini për ndonjë mësues që dha jetën për lirinë që sot po e gëzojmë?*

Përgjigjet e tyre shënohen në tabelë.

REALIZIMI – Lexim i drejtuar

Titulli paraqitet para nxënësve: *Mësuesi është i shenjtë*, faqe 37. Autori: *Sadri A. Kelmendi*.

Teksti lexohet me ndalesa. Pas çdo ndalese, mësuesja u drejton pyetje nxënësve, lidhur me përmbajtjen që lexuam. Gjithashtu, nxënësit inkurajohen të japin mendimet e tyre. Pastaj vazhdohet edhe me paragrafin tjetër. Veprohet njëjtë. Pyetjet e mundshme:

- *Në mes të kujt zhvillohet biseda në tregim?*
- *Përse i flet gjyshi Lalit?*
- *A na paraqitet edhe me një emër tjetër Lali?Pse?*
- *Për çka e qorton gjyshi Lalin?*
- *Pse e përqafton gjyshi nipin e tij?*

Me nxënës sqarohen fjalët e panjohura. Teksti lexohet me intonacion nga nxënësit. Pastaj punohet rubrika: *Të analizojmë*, ku nxënësit do të plotësojnë 6 pyetjet në vazhdim në faqen 38 dhe 39.

REFLEKTIMI – Punë në dyshe

Me shokun ose shoqen e bankës do të bisedoni për profesionin e mësuesit, duke pasur model mësuesen tuaj. Më pas shënoni tre elemente, të cilat mendoni se e bëjnë një mësuese të shenjtë dhe tregoni arsyen. Më pas prezantohet puna e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në klasë, si dhe për leximin, ku u respektuan shenjat e pikësimit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani një letër falënderuese për mësuesen tënde.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përemrat pyetës

Fjalët kyçe: përemrat pyetës, rasë, fjali, lakim, frymor, jofrymor

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dalloni përemrat pyetës në fjalitë e dhëna dhe tregoni përse shërbejnë;
- Lakoni përemrat pyetës;
- Shkruan fjali të ndryshme me përemrat pyetës.

Kriteret e suksesit:

- Dallo përemra pyetës në fjali;
- Përdor përemrat pyetës në rasa;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Mendo - diskuto

Mësuesja pyet nxënësit:

- *Si ndahen përemrat sipas kuptimit?*
- *Çfarë rolesh kanë ata në fjali?*

Përgjigjet merren nga nxënësit, të cilat shkruhen në fjali. Dallojmë përemra: **dëftorë, vetorë, pronorë**. Me anë të videoprojektorit, mësuesja paraqet përemrat pyetës: **Çfarë?, Kush?, Cila?, Cili?, Sa?, I sati?, Ç’?**

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapen librat në faqen 40. Nxënësit lexojnë shembujt e dhënë në tekst dhe veçojnë përemrat pyetës. Pastaj mësuesja iu thotë nxënësve disa fjalë për përemrin pyetës: *Fjalët që shërbejnë për të pyetur dhe për të formuar fjali pyetëse quhen përemra pyetës.*

Shembull:

Kush po flet?

Cila fushë është kjo?

Cili djalë ka shkuar?

Sa djem janë në klasë?, etj.

Gjithashtu, theksohet se përemri pyetës **kush** përdoret vetëm për njerëz, ndërsa përemri **cili** për frymorë dhe jofrymorë. Përemrat pyetës kanë edhe kategorinë gramatikore të rasës: **Cili, i , e cilit, cilit, cilin, prej cilit**. Nxënësve iu bëhet me dije se përemri **çfarë** nuk shkruhet me apostrof, kurse përemri **ç’** gjithmonë shkruhet me apostrof. Në vazhdim punohen ushtrimet 1 dhe 2. Në ushtrimin 1 me format rasore të përemrit pyetës **cili** do të krijohen 5 fjali. Kurse në ushtrimin 2. në tekstin e dhënë do të nënvizohen përemrat pyetës.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit do të ndahen në dy grupe të mëdha. Grupi A do të lakojë përemrin **kush** (ushtrimi 3 i librit), kurse grupi B do të krijojë fjali me të gjithë përemrat pyetës (ushtrimi 4 i librit). Puna e bërë do të prezantohet para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e përemrave pyetës dhe për krijimin e fjalive me të gjithë përemrat pyetës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani 10 fjali me përemra pyetës.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Apostrofi te përemri pyetës

Fjalët kyçe: apostrofi, përemri pyetës, trajtat e shkurtra

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon rastet e përdorimit të apostrofit;
- Dallon përemrat pyetës, si dhe trajtat e shkurtra;
- Shkruan fjali të ndryshme ku përdoret apostrofi.

Kriteret e suksesit:

- Dallo rastet e përdorimit të apostrofit;
- Korrigjo fjalë, ku apostrofi është përdorur gabimisht;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Mendo - diskuto

Mësuesja shkruan në tabelë këto fjali:

- *S'të shkruan letër?*
- *Ç'do në këtë kohë?*
- *Ç'të solli këtu?*

Nxënësit dallojnë apostrofin dhe tregojnë përdorimin e tij.

REALIZIMI – Punë e drejtuar - 25 minuta

Hapen librat në faqen 40. Nxënësit lexojnë shembujt e dhënë në libër. Pastaj mësuesja iu thotë nxënësve se apostrofi përdoret:

- pas pjesëzës mohuese *s'*
- pas përemrit pyetës *ç'*
- në trajtat e bashkuara të përemrit vetor: *m'i, t'i*.

Më pas punohen ushtrimet 1 dhe 2. Tek ushtrimi 1, nxënësit do të plotësojnë fjalitë me përemrat pyetës, ndërkaq tek ushtrimi 2, nxënësit do të rrethojnë përemrat pyetës, ku nuk është përdorur saktë apostrofi. Shembull: *Ç'farë ekspozite keni hapur?* Në këtë rast përemri pyetës *çfarë* është përdorur gabimisht.

REFLEKTIMI – Punë në dyshe

Nxënësit do të punojnë në dyshe ushtrimin, në faqen 42. Do të krijojnë 8 fjali ku përdoret apostrofi. Puna prezantohet para klasës. Më pas mësuesja bën vlerësimin e njohurive.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e përemrave pyetës dhe të pacaktuar, përdorimin e saktë të apostrofit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani 10 fjali, ku do të përdoret apostrofi.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.6; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Beni ecën vetë

Fjalët kyçe: Beni, xhaxhai Thomai, Goni,

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Shpreh njohuritë që ka rreth filmit;
- Përgjigjet në pyetjet rreth tekstit;
- Flet për filmin sipas motiveve të tekstit: *Beni ecën vetë*.

Kriteret e suksesit:

- Përgjigju në pyetjet e tekstit;
- Shpreh njohuritë që ke për filmin: *Beni ecën vetë*;
- Analizo tekstin në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Diskutim për njohuritë paraprake

Me nxënës diskutohet rreth njohurive paraprake që kanë për filmin shqiptar për fëmijë. Mësuesja parashtron pyetje:

- Keni dëgjuar ndonjëherë për filmin shqiptar për fëmijë?
- A e keni parë ndonjëherë ndonjë film shqiptar?
- Mund ta veçoni ndonjë personazh në ndonjë film shqiptar?

Përgjigjet e tyre shënohen në tabelë.

REALIZIMI – Lexim i drejtuar

Titulli paraqitet para nxënësve: **Beni ecën vetë**, faqe 42. Autori: **Kiço Blushi**.

Teksti lexohet me ndalesa. Pas çdo ndalesë, mësuesja u drejton pyetje nxënësve, lidhur me përmbajtjen që lexuam. Gjithashtu, nxënësit inkurajohen të japin mendimet e tyre. Pastaj vazhdohet edhe me paragrafin tjetër. Veprohet njëjtë. Pyetjet e mundshme:

- Ku zhvillohet ngjarja dhe në çfarë stine?
- Çfarë mendonte Beni në fillim?
- Pse u gëzua ai kur pa gomarin të vraponte?
- Pse u frikësua më pas Beni?

Me nxënës sqarohen fjalët e panjohura. Teksti lexohet me intonacion nga nxënësit. Në lexim angazhohen sa më shumë nxënës, në mënyrë që pjesa e leximit në fjalë të kuptohet sa më mirë.

REFLEKTIMI – Krijim i lirë

Nxënësit do të krijojnë një skeç me dy-tre personazhe. Për ta krijuar më lehtë këtë skeç mësuesja jep disa fjalë, të cilat mund t'i përdorin si lehtësim: *Gëzim, kënaqësi, dhimbje, trishtim, dashuri, mirësi, lëndim, fyerje, inat, dyshim, ankth*. Mund të përdoren edhe fjalë të tjera.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në klasë, si dhe për leximin, ashtu edhe për krijimin e një skeçi të shkurtër me dy-tre personazhe.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani në pika të shkurtra përmbajtjen e filmit: Beni ecën vetë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.

Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë – dëgjojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.6; II.2; II.3; II.5; III.1; III. 3; III.4; III.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 2.1; 2.2; 2.7; 3.1; 3.2; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mjerimi i shekullit 21

Fjalët kyçe: mjerimi, padrejtësia, vuajtje

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Identifikon elementet e poezisë;
- Veçon elementet e poezisë;
- Analizon poezinë në tërësi.

Kriteret e suksesit:

- Shkruaj elementet e poezisë;
- Veço elementet që ka poezia;
- Mëso për padrejtësitë dhe vuajtjet e popullit shqiptar.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Copëza të përziara

Nxënësit ndahen në dyshe. Atyre ju jepet në copëza të përziara poezia. Pra, poezia e ndarë në vargje i ofrohet secilit çift të nxënësve. Kërkohej nga ta që këto vargje t'i rendisin në mënyrë që poezia të ketë kuptim në fund. Lexohet renditja e vargjeve nga secili çift. Mësuesja me informatë kthyes vlerëson se si kanë punuar nxënësit.

REALIZIMI – Ditari trepjesësh

Mësuesja e lexon poezinë në faqen 44. Pastaj nga nxënësit kërkohej që ta analizojnë mirë e mirë poezinë. Më pas nxënësve u jepet fleta me ngjyra dhe pasi ta kenë analizuar mirë poezinë, kërkohej nga ata që ta zgjedhin pjesën e preferuar, ku në ditarin trepjesësh ta arsyetojnë zgjedhjen, si dhe ta ilustrojnë pjesën në fjalë.

Pjesa e pëlqyer	Komenti	Ilustrimi

Pastaj nxënësit plotësojnë rubrikën: *Të analizojmë*, ku do t'u përgjigjen 10 pyetje, të cilat janë në vazhdim. Natyrisht edhe mësuesja do të ndihmojë në përgjigjet e sakta. Kështu, së bashku do të bëhet rumbullakimi i poezisë në fjalë.

REFLEKTIMI – Pesëvargëshi

Nxënësit do të përpilojnë një pesëvargësh me temën: *Mjerimi*.

Mjerimi
i varfër i pangopur
kërkojnë hedhin dëgjojnë
Jeta ka shumë padrejtësi.
Vuajtje

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Të shkruajnë në fletoret e tyre për mjerimin dhe vuajtjet e popullit shqiptar ndër vite.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.

Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë – dëgjojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.6; II.2; II.3; II.5; III.1; III. 3; III.4; III.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 2.1; 2.2; 2.7; 3.1; 3.2; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mëshirë për fëmijët!

Fjalët kyçe: mëshira, ndihma, shpresa

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Lexon pastër dhe pa gabime poezinë në fjalë;
- Thotë kuptimin e poezisë më fjalët e veta;
- Gjykojnë për tematikën dhe idetë e autores.

Kriteret e suksesit:

- Lexo pastër dhe pa gabime poezinë;
- Veço elementet që ka poezia;
- Mëso përmendësh poezinë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme


Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Kllaster

Do të punohet një pemë e mendimeve, ku do të paraqitet mënyrat e të ndihmuarit të fëmijëve, të cilët jetojnë në varfëri.



REALIZIMI – Ruaje fjalën e fundit për mua

Nxënësit do të punojnë në bazë të udhëzimeve që do t'u jepen në vazhdim. Në fillim, hapen librat në faqen 46 dhe udhëzohen që ta lexojnë poezinë. Gjatë leximit kërkohet që të zgjedhin një pjesë që u pëlqen më shumë dhe të njëjtën ta shkruajnë në fletoret e tyre. Në anën tjetër të fletës, do të shkruajnë komentën e zgjedhur. Mund të shkruajnë edhe ndonjë gjë, që është në kundërshtim me pjesën e zgjedhur. Pas përfundimit të leximit dhe mbajtjes së shënimeve, një nxënës lexon pjesën e zgjedhur, ndërkaq nxënësit, të cilët kanë zgjedhur po atë pjesë japin mendimet e tyre. Kështu vazhdon edhe me nxënësit e tjerë.

REFLEKTIMI – Pesëvargëshi

Nxënësit do të përpilojnë një pesëvargësh me temën: *Mëshira*.

Mëshira
i thatë i zhveshur
shikojnë dallojnë mungojnë
Lypsarët kërkojnë ndihmën e duhur.
Ndihma

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore.

Detyrë shtëpie: Poezinë në fjalë ta mësojnë përmendësh.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përemrat dëftorë

Fjalët kyçe: përemrat dëftorë, frymor, send, gjini, numër, rasë

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon përemrat dëftorë në fjalitë e dhëna
- Përdor si duhet përemrat dëftorë, duke i përshtatur në gjini, në numër dhe në rasë;
- Shkruan fjali të ndryshme, duke përdorur përemra dëftorë.

Kriteret e suksesit:

- Dallo përemra dëftorë në fjali;
- Përdor si duhet përemrat dëftorë;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Mendo-diskuto

Mësuesja shkruan në tabelë fjalitë:

- **Ky** djalë erdhi me kohë.
- **Kjo** vajzë erdhi më vonë.
- **Këta** djem erdhën me kohë.
- **Këto** vajza erdhën më vonë.

Nxënësve u thuhet se fjalët me: *ky, kjo, këta, këto* shërbejnë për të veçuar frymorë e sende dhe për të treguar tipare të përbashkëta të frymorit apo të sendit.

REALIZIMI – Të nxënit në bashkëpunim

Hapen librat në faqen 48. Pastaj lexohet materiali që ka të bëjë me përemrat vetorë. Në vazhdim u thuhet nxënësve se fjalët: **ky, kjo, këta, këto, i këtillë, e këtillë, të këtillë, i tillë, të tilla, i atillë** janë përemra dëftorë. Përemrat dëftorë kanë kategorinë e gjinisë, të numrit dhe të rasës. Pastaj japin shembullin e lakimit të përemrave dëftorë:

Emërore: *Ky, kjo, këta, këto, ai, ajo, ata ato*

Gjinore: *i, e këtij, e kësaj*

Dhanore: *këtij, kësaj*

Kallëzore: *këtë, këtë*

Rrjedhore: *prej këtij, kësaj.*

Me nxënës punohet ushtrimi 1, ku nxënësit në tekstin e mëposhtëm do të gjenden e do të nënvizohen përemrat dëftorë, si dhe do të tregohet se cilët nga këta përemra tregojnë afërsi e cilët largësi.

REFLEKTIMI – Punë individuale

Nxënësit do të punojnë në mënyrë individuale ushtrimin 2, ku do të formojnë fjali me përmra dëftorë. Përcillet puna e nxënësve në vazhdimësi. Në fund, nxënësit paraqesin punën e bërë para klasës. Jepen sqarimet dhe plotësimet e nevojshme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e përemrave dëftorë dhe përdorimin e tij si duhet në fjali.

Detyrë shtëpie: Shkruani 6 fjali me përemra dëftorë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.6; II.2; II.3; II.5; III.1; III.3, III.4; III.8; V.8; VI.2; VI.3;VI. 4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 1,7; 1.8; 1.9;1.10; 2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7; 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Djaloshi i çuditshëm

Fjalët kyçe: djaloshi, Bardhi, Bacolli, gruaja

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Shpreh njohuritë që ka rreth tekstit në fjalë;
- Nxjerr porosinë e tekstit;
- Flet për personazhet e tekstit.

Kriteret e suksesit:

- Fol për njohuritë që ka rreth tekstit në fjalë;
- Diskuto për personazhet e tekstit;
- Analizo tekstin në tërësi.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Parashikimi me terma paraprakë

Pasi i kontrollon detyrat e shtëpisë, mësuesja shënon katër terma në tabelë: *djaloshi, t'ia qante dertin, i çuditshëm, manaferrat*. Nxënësit në mënyrë individuale do të shkruajnë nga një tregim të shkurtër, duke i përdorur termat në fjalë. Pasi të përfundojnë tregimin do t'i lexojnë njëri-tjetrit në dyshe e më pas edhe para gjithë klasës. Pas këtij aktiviteti arrijmë deri te qëllimi i orës mësimore dhe titullin e shënojmë në tabelë.

REALIZIMI – Lexim i drejtuar

Titulli paraqitet para nxënësve: *Djaloshi i çuditshëm*, faqe 49. Autori: *Qamil Batalli*.

Teksti lexohet me ndalesa. Pas çdo ndalesë, mësuesja u drejton pyetje nxënësve, lidhur me përmbajtjen që lexuam. Gjithashtu, nxënësit inkurajohen të japin mendimet e tyre. Pastaj vazhdohet edhe me paragrafin tjetër. Vepohet njëjtë. Pyetjet e mundshme:

- *Cilët janë personazhet e tekstit në fjalë?*
- *Pse ishte i çuditshëm Bacoli?*
- *Përse mblidhte dhe shiste ai manaferra?*
- *Çfarë ishte me profesion Bardhi?*
- *Si i kishte siguruar ai librat për shkollim?*
- *Pse blinte Bardhi manaferra?*
- *Pse Bacoli nuk do të blinte libra me paratë e fituara?*

Me nxënës sqarohen fjalët e panjohura. Teksti lexohet me intonacion nga nxënësit. Pastaj mësuesja së bashku me nxënës plotësojnë rubrikë: *Të analizojmë*, ku iu përgjigjen katër pyetjeve në faqen 51.

REFLEKTIMI – Punë individuale

Nxënësit do të punojnë në mënyrë individuale pyetjen 5 të rubrikës: *Të analizojmë*, ku nxënësit do të bëjnë përshkrimin e personazheve të fragmentit. Ata do të shkruajnë për karakteristikat e karakterit të personazheve. Personazhet i përshkruajnë, duke i vendosur në nivelin e piramidës, sipas rëndësisë, të cilën ua jep shkrimtari.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në klasë, si dhe për lexim e rrjedhshëm të tekstit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani në fletoret tuaja përmbajtjen e tekstit: *Djaloshi i çuditshëm*.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zgjedhimet e foljes

Fjalët kyçe: folja, zgjedhimi, numri njëjës, numri shumës, vetat, kohët

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon zgjedhimet e foljes;
- Dallon veprimet që kryen folja;
- Shkruan fjali të ndryshme sipas zgjedhimeve.

Kriteret e suksesit:

- Dallo zgjedhimet e foljeve;
- Shkruaj shembuj të ndryshëm sipas zgjedhimit;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Mendo - diskuto

Mësuesja shkruan në tabelë këto fjali:

- *Unë mësoj shumë.*
- *Ai vjel rrush.*
- *Ti rri tërë ditën në shtëpi.*

Nxënësit dallojnë zgjedhimet. Shembuj e mësipërm flasin për tri zgjedhimet e foljes.

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapen librat në faqen 52. Nxënësit lexojnë shembujt e dhënë në libër. Pastaj mësuesja iu thotë nxënësve se foljet kanë tri zgjedhime. Ato ndahen sipas mbaresës që marrin në veten I, në numrin njëjës – koha e tashme.

Shembull:

Zgjedhimi i parë me *-j*: *shkruaj, qëndroj, lexoj, këndoj.*

Zgjedhimi i dytë: foljet që mbarojnë me bashkëtingëllore: *hap, mat, vjel.*

Zgjedhimi i tretë: foljet që mbarojnë me zanore: *di, lë, vë, zë, rri.*

Në vazhdim do të punohet ushtrimi 1 dhe 2 në faqen 52, ku nxënësit do të shkruajnë shembuj për çdo zgjedhim, si dhe në ushtrimin 2 do të nënvizohen foljet dhe do të grupohen sipas zgjedhimit.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit do të ndahen në dy grupe të mëdha. Grupi i parë do të shkruajë 5 fjali me folje të zgjedhimit të parë: *shkruaj, punoj, lexoj, këndoj, zbatoj.* Grupi i dytë do të shkruajë 5 fjali me folje të zgjedhimit të dytë: *hap, mat, zbret, mbjell, vjel.* Pastaj përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e bërë, e cila plotësohet eventualisht nga mësuesja.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e zgjedhimeve të foljeve, si dhe për punën e bërë në grupe.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 6 në faqen 53.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.5; II.4; III.1; III.4; IV.3; V.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 2.7; 3.2; 7.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shprehjet frazeologjike

Fjalët kyçe: shprehje frazeologjike, këshillë

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Tregon shprehje frazeologjike të treguara më parë;
- Lexon situatat duke lidhur me fjalitë që përshtaten;
- Shpjegon kuptimin dhe rëndësinë e shprehjeve frazeologjike.

Kriteret e suksesit:

- Trego një shprehje frazeologjike të treguar më parë;
- Lexo me kujdes situatat e dhëna për të lidhur me fjalitë që përshtaten;
- Puno për të kuptuar kuptimin e shprehjeve frazeologjike në ushtrimet e dhëna.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIM – Stuhi mendimesh

Kërkohet nga nxënësit të tregojnë ndonjë shprehje frazeologjike të dëgjuar më parë. Disa prej shprehjeve shënohen në tabelë dhe diskutohen së bashku me nxënësit.

REALIZIMI – Vëzhgo-puno

Hapen libri në faqen 53 dhe për disa minuta nxënësit lexojnë në heshtje informacionin e dhënë për shprehjet frazeologjike. Paqartësitë sqarohen. Kërkohet nga nxënësit t'i lidhin këto situata me fjalitë që përshtaten. Nxënësit u thuhet se shprehjet frazeologjike janë shprehjet popullore, të cilat përçojnë mesazhin me nënkuptim (indirekt). Janë të ngjashme me batutat.

Shembull:

- *Unë për lisa e ti për fshisa!*
- *Shtati pyll e menja fyll!*
- *Nuk ka pyll pa derra!*
- *U rrokullis tenxherja gjeti kapakun!*

REFLEKTIMI – Punë e pavarur

Nxënësit punojnë të pavarur ushtrimin që është në faqen 53 të librit. Ata do të plotësojnë pjesën e dytë të shprehjes.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen bazuar në përgjigjet e tyre të sakta, si dhe për angazhimin e tyre në orën mësimore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Me ndihmën e prindërve gjeni tre shprehje frazeologjike.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kohët e foljes në mënyrën dëftore (ora e parë)

Fjalët kyçe: folja, mënyra dëftore, kohët e foljes, e tashme, e shkuar, e ardhme

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon foljet e mënyrës dëftore në fjali;
- Dallon kohët e foljes të mënyrës dëftore;
- Klasifikon foljet e mënyrës dëftore.

Kriteret e suksesit:

- Dallo foljet e mënyrës dëftore;
- Krijon një tekst duke përdorur foljet e mënyrës dëftore;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Mendo - diskuto

Me anë të videoprojektorit nxënësit vërejnë fjali me foljet në mënyrën dëftore, të cilat janë të nënvizuara. Nxënësve u parashtrohen pyetje:

- Çka tregojnë foljet?
- Me cilën pyetje gjenden ato?

Pastaj kërkohet nga ta t'i dallojnë kohët e foljeve, sipas shembullit të mëposhtëm:

Punoj (koha e tashme)

Punoja (koha e pakryer)

Punova (koha e kryer e thjeshtë)

Kam punuar (koha e kryer)

Do të punoj (koha e ardhme)

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapen librat në faqen 54. Lexohen shembujt e dhënë në tekst, si dhe rregullat gjuhësore për kohët e foljes të mënyrës dëftore. Nxënësve u thuhet se mënyra dëftore i ka të gjitha kohët. Foljet në mënyrën dëftore u përgjigjen pyetjeve: **Ç'bën? Çfarë? Kush? Ç'është?** etj. Pastaj punohet ushtrimi 1 dhe ushtrimi 2 në faqen 55 të librit. Në ushtrimin 1, konkretisht në tekstin e dhënë do të gjenden foljet dhe do të tregohet edhe në cilën kohë janë. Ndërkaq, në ushtrimin 2 do të nënvizohen foljet e kohës së tashme. Nxënësit përcillen gjatë punës dhe plotësimit të ushtrimeve. Mësuesja jep sqarime të nevojshme për çdo detaj.

REFLEKTIMI – Punë në dyshe

Nxënësit do të punojnë në dyshe, ku do të shkruajnë nga një fjali në secilën kohë të mënyrës dëftore. Më pas dyshet preaztojnë punën e bërë. Kështu vazhdohet edhe me disa dyshe të tjera, derisa arrihet rumbullakimi i njësisë mësimore në fjalë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e foljeve në të gjitha kohët e mënyrës dëftore. Gjithashtu, vlerësohet kontributi në punën në dyshe.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani nga një fjali në të gjitha kohët e mënyrës dëftore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kohët e foljes në mënyrën dëftore (ora e dytë)

Fjalët kyçe: folja, mënyra dëftore, kohët e foljes, e tashme, e shkuar, e ardhme

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Identifikon foljet në të gjitha kohët e mënyrës dëftore;
- Klasifikon foljet e mënyrës dëftore;
- Krijon fjali duke përdorur folje në mënyrën dëftore.

Kriteret e suksesit:

- Identifiko folje në të gjitha kohët e mënyrës dëftore;
- Klasifiko folje në mënyrën dëftore ;
- Plotëso projektin e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Lojë me tiketa

Nxënësve u shpërndahen etiketat me fjali. Në fjalitë e paraqitura ata identifikojnë folje në mënyrën dëftore. **Shembull:**

- *Bardhi **shkon** në shkollë.*
- *Arsimi **pati shkuar** në shkollë.*
- *Shpresa **do të shkojë** në shkollë.*
- *Beni **shkoi** në shkollë.*

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Nxënësve do t'u prezantohet një projekt, që është në libër, në faqen 54. Kjo punë do të kryhet në grupe nga 6 anëtarë. Do të merret si shembull teksti: *Djaloshi i çuditshëm*. Bardhi kishte kryer shkollimin me librat e blerë nga shitja e manaferrave. Për periudhën prej një muaji, të ndarë në grupe, përpiloheni një projekt për mbledhjen apo sigurimin e librave për bibliotekën e shkollës. Mendoni, fillimisht, se si do të ndihmoheni dhe pastaj përpiloheni projektin, ku do të përfshini:

1. *Si mund të sigurohen librat?*
2. *Mënyrën – në çfarë forme do të realizohet.*
3. *Kujt i drejtohet?*
4. *Sqarimin për qëllimin tuaj (p.sh.: vizatime, ese, etj.).*

Java I: Plani.

Java II: Ndani detyrat për çdo anëtarë të grupit (nga 2 nxënës në çdo grup punues).

Java III: Realizimi i projektit.

Java IV: Përshkrimi i rezultateve, si dhe idetë për projektet e ardhshme.

REFLEKTIMI – Punë individuale

Nxënësit do të punojnë të pavarur. Do të marrin shembuj të ndryshëm të foljeve në të gjitha kohët e mënyrës dëftore. Prezantohet puna e secilit nxënës para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për përpilimin e planit për projektin se si do t'i sigurojnë librat për bibliotekën e shkollës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Do të shkruajnë një tekst, të cilin do ta përzgjedhin vetë e më pas do t'i nënvizojnë foljet në kohët e mënyrës dëftore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Foljet: marr, dal, shoh, jap në kohën e tashme

Fjalët kyçe: folje, koha e tashme, zgjedhimi i dytë, veta, numri

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Zgjedhon foljet e theksuara më lart në kohën e tashme;
- Dallon vetat ku foljet dalin ndryshe nga foljet e vetave të tjera;
- Krijon fjali duke përdorur foljet e theksuara më lart në veta dhe në numra të ndryshëm.

Kriteret e suksesit:

- Zgjedho foljet e theksuara më lart në kohën e tashme;
- Dallo vetat e foljes;
- Krijoj fjali duke përdorur foljet: *marr, dal, shoh* dhe *jap* në kohën e tashme.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Kllaster

Para nxënësve do të paraqitet një kllaster:



REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapet libri në faqen 57 dhe lexohet teksti i dhënë. Dallohen foljet me ngjyra, duke gjetur kohën dhe vetën e tyre. Nxënësve u thuhet se foljet në kohën e tashme tregojnë një veprim që ndodh në kohën kur flasim.

Shembull:

Unë marr	<i>dal</i>	<i>jap</i>	<i>shoh</i>
Ti merr	<i>del</i>	<i>jep</i>	<i>sheh</i>
Ai (ajo) merr	<i>del</i>	<i>jep</i>	<i>sheh</i>
Ne marrim	<i>dalim</i>	<i>japim</i>	<i>shohim</i>
Ju merrni	<i>dilni</i>	<i>jepni</i>	<i>shihni</i>
Ata (ato) marrin	<i>dalin</i>	<i>japin</i>	<i>shohin</i>

Në ushtrimin 1, në tekstin e dhënë do të nënvizohen foljet. Pastaj mësuesja bën plotësimet e nevojshme.

REFLEKTIMI – Punë individuale

Si detyrë u jepet nxënësve që të krijojnë fjali me foljet: **marr, dal, jap, shoh** në kohën e tashme, në vetë dhe në numër të ndryshëm. Lexohen fjalitë që krijuan nxënësit. Jepen sqarime e plotësime eventuale nga mësuesja.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për zgjedhimin e foljeve të lartpërmendura në kohën e tashme, si dhe për dallimin e tyre në fjali.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 2 në faqen 57 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara): I.1; I.6; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Sytë e shkollës

Fjalët kyçe: zogu, sytë e shkollës

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Shpreh njohuritë që ka rreth shkollës;
- Përgjigjet në pyetjet rreth tekstit;
- Flet për dialogun si karakteristikë e gjinisë letrare të dramatikes.

Kriteret e suksesit:

- Përgjigju në pyetjet e tekstit;
- Shpreh njohuritë që ke rreth shkollës si institucion edukativo-arsimor;
- Analizo tekstin në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Diskutim për njohuritë paraprake

Me nxënës diskutohet rreth njohurive paraprake që kanë për shkollën. Mësuesja parashtron pyetje:

- *Çka dini në përgjithësi për shkollën?*
- *Si kanë qenë shkollat përpara?*
- *Keni dëgjuar ndonjëherë për dialogun?*
- *Ku përdoret më së shumti dialogu?*

Përgjigjet e tyre shënohen në tabelë.

REALIZIMI – Lexim i drejtuar

Titulli paraqitet para nxënësve: *Sytë e shkollës*, faqe 58. Autori: Kalosh Çeliku.

Teksti lexohet me ndalesa. Pas çdo ndalese, mësuesja u drejton pyetje nxënësve, lidhur me përmbajtjen që lexuam. Gjithashtu, nxënësit inkurajohen të japin mendimet e tyre. Pastaj vazhdohet edhe me paragrafin tjetër. Veprohet njëjtë. Pyetjet e mundshme:

- *Ku ishte vendosur shkolla?*
- *Kush erdhi afër dritares?*
- *Përse zogu nuk deshi të hynte brenda?*
- *Kush e pengoi?*
- *Pse ishin të nevojshme dritaret për shkollën?*
- *Çfarë tha zogu kur e kuptoi rëndësinë që kishte dritarja?*

Me nxënës sqarohen fjalët e panjohura. Teksti lexohet me intonacion nga nxënësit.

REFLEKTIMI – Punë në dyshe

Me shokun ose shoqen e bankës do të bisedoni për shkollën, duke pasur një model shkollën tuaj.

Më pas shënoni tre elemente, të cilat mendoni se e bëjnë shkollën tuaj model për të mirë dhe tregoni arsyen. Më pas prezantohet puna e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në klasë, si dhe për leximin, ku u respektoan shenjat e pikësimit. Gjithashtu, vlerësohet edhe puna në dyshe.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani diçka për dialogun si karakteristikë e gjinisë letrare të dramatikes.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.6; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shoku ynë muzikant

Fjalët kyçe: i moshuari, shkolla, oborri, shatërvani, busti

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Shpreh njohuritë që ka rreth tekstit në fjalë;
- Përgjigjet në pyetjet rreth tekstit;
- Flet për personazhet e tekstit.

Kriteret e suksesit:

- Përgjigju në pyetjet e tekstit;
- Shpreh njohuritë që ka për tekstin në fjalë;
- Analizo tekstin në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIM – Diskutim për njohuritë paraprake

Me nxënës diskutohet rreth njohurive paraprake që kanë për shkollën. Mësuesja parashtron pyetje:

- Çka dini diçka për bustet të vendosura anembanë vendit?
- Dini për ndonjë bust të ndonjë heroi apo të ndonjë personaliteti të kohës?

Përgjigjet e tyre shënohen në tabelë.

REALIZIMI – Lexim i drejtuar

Titulli paraqitet para nxënësve: *Shoku ynë muzikant*, faqe 59. Autori: *Tajar Hatipi*.

Teksti lexohet me ndalesa. Pas çdo ndalese, mësuesja u drejton pyetje nxënësve, lidhur me përmbajtjen që lexuam. Gjithashtu, nxënësit inkurajohen të japin mendimet e tyre. Pastaj vazhdohet edhe me paragrafin tjetër. Veprohet njëjtë. Pyetjet e mundshme:

- Çfarë moshe ishin fëmijët – personazhe në tekst?
- Çfarë e tërhiqte vëmendjen e tyre?
- Prej ku dëgjohej muzika?
- Përse kishte shkuar në shkollë i moshuari?
- Çfarë veprimi bëri ai?
- Çfarë mendoni, a kishte vepruar mirë i moshuari?Pse?

Me nxënës sqarohen fjalët e panjohura. Teksti lexohet me intonacion nga nxënësit. Më pas punohet rubrika: *Të analizojmë*, ku do të punohen katër pyetjet e para në faqen 61 të librit.

REFLEKTIM – Punë në dyshe

Në dyshe do të punohet vazhdimi i rubrikës: *Të analizojmë*, konkretisht pyetjet në faqen 62 të librit. Më pas dyshet prezantojnë punën e bërë para klasës. Kështu vazhdohet edhe me dyshet e tjera.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në klasë, si dhe për leximin, ku u respektuan shenjat e pikësimit. Gjithashtu, vlerësohet edhe puna në dyshe.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani për ndonjë hero a personalitet që ka bustin në qytetin tuaj.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Koha e pakryer

Fjalët kyçe: koha e pakryer, zgjedhim, mbaresë

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Zgjedhon foljet në kohën e pakryer;
- Dallon foljet e kohës së pakryer;
- Krijon fjali duke përdorur foljet në kohën e pakryer.

Kriteret e suksesit:

- Zgjedho foljet në kohën e pakryer;
- Dallo foljet në kohën e pakryer;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Mendo - diskuto

Me anë të videoprojektorit nxënësit vërejnë fjali me foljet në kohën e pakryer, të cilat janë të nënvizuara. Nxënësve u parashtrihen pyetje:

- Çka tregojnë foljet?
- Me çfarë mbaresash përfundojnë ato?

Përgjigjet e nxënësve shënohen në tabelë.

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapen librat në faqen 62. Lexohen shembujt e dhënë në tekst. Nxënësve u thuhet se foljet në kohën e pakryer tregojnë një veprim që ka ndodhur, por nuk është përfunduar.

Shembull:

Unë vija i pari në klasë e dilja i fundit.

Ti shihje shumë, por nuk tregoje.

Ajo shkante pa detyra.

Ne shkonim të parët në sallën e edukatës fizike.

Me nxënës punohet ushtrimi 1 dhe 2. Në ushtrimin 1 do të zgjedhohen foljet *marr*, *dal* dhe *jap* në kohën e pakryer. Ndërkaq, në ushtrimin 2, në tekstin e dhënë do të nënvizohen foljet në kohën e pakryer dhe do të gjenden mbaresat, si dhe do të tregohet veta dhe numri.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit do të ndahen në dy grupe të mëdha. Grupi i parë do të krijojë 3 fjali me foljen *marr*, kurse grupi i dytë do të krijojë 3 fjali me foljen *jap*, gjithnjë në kohën e pakryer. Mësuesja përcjell punën e grupeve. Në fund, përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e foljeve në kohën e pakryer, si dhe në angazhimin që patën gjatë punës në grupe.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 5 në faqen 63 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë – shkruajmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.6; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Eksploruesit

Fjalët kyçe: Lila, Fredi, Koni, Maksi

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Shpreh njohuritë që ka rreth tekstit në fjalë;
- Përgjigjet në pyetjet rreth tekstit;
- Flet për personazhet e tekstit.

Kriteret e suksesit:

- Shpreh njohuritë rreth fragmentit të nxjerrë;
- Përgjigju në pyetjet që janë rreth tekstit;
- Analizo tekstin në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIM –Diskutim për njohuritë paraprake

Me nxënës diskutohet rreth njohurive paraprake që kanë për termin *eksplorim*. Mësuesja parashtron pyetje:

- Çka dini diçka për termin *eksplorim*?
- Çfarë bëjnë në fakt *eksploruesit*?

Përgjigjet e tyre shënohen në tabelë.

REALIZIMI – Lexim i drejtuar

Titulli paraqitet para nxënësve: *Eksploruesit* faqe 63. Fragment i nxjerrë.

Teksti lexohet me ndalesa me dy ndalesa. Pas çdo ndalese, mësuesja u drejton pyetje nxënësve, lidhur me përmbajtjen që lexuam. Gjithashtu, nxënësit inkurajohen të japin mendimet e tyre. Pastaj vazhdohet edhe me paragrafin tjetër. Veprohet njëjtë. Pyetjet e mundshme:

- *Pse ishte i mërzitur Fredi?*
- *Sa fëmijë ishin së bashku?*
- *Çfarë vendosën të bëjnë ata?*
- *Pse Lila do të kursejë të vëllanë?*

Me nxënës sqarohen fjalët e panjohura. Teksti lexohet me intonacion nga nxënësit. Më pas punohet rubrika: *Të analizojmë*, ku do të punohen pyetjet që janë në faqet 64 dhe 65. Mësuesja së bashku nxënësit bëjnë plotësimin dhe japin përgjigjet që kërkohen. Në katër pyetjet e para do të rrethohet përgjigjja e saktë, kurse në bllokun tjetër të pyetjeve do të plotësohen vizat e zbrazëta.

REFLEKTIMI – Pesëvargëshi

Nxënësit do të përpilojnë një pesëvargësh me temën: *Eksploruesi*.

Eksploruesi
i dobët i plogësht
ngrënë pastron goditi
Fëmijët ishin së bashku.
Lëvizësi

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen në leximin e tekstit, duke i respektuar shenjat e pikësimit, si dhe në përpilimin e pesëvargëshit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruaj për një vend që kish dashur të eksplorosh dhe jep argumentet.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndajfoljet

Fjalët kyçe: ndajfolje, kohe, mënyrë, sasi

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon ndajfoljet si fjalë që plotëson kuptimin e foljes;
- Dallon ndajfoljet nga mbiemrat;
- Krijon fjali me ndajfoljet.

Kriteret e suksesit:

- Përcakto llojin e ndajfoljeve përmes pyetjeve;
- Klasifiko ndajfoljet sipas llojit të tyre;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Mendo - diskuto

Me anë të videoprojektorit nxënësit vërejnë fjalët: *këtu, lart, poshtë, shpejt, mirë, pak, nesër, herët*, të cilat janë të nënvizuara. Nxënësve u parashtrohen pyetje:

- Çka mendoni, kuptimi e cilës fjalë plotësojnë këto fjalë? (kuptimin foljeve)
- Si quhen fjalët që plotësojnë kuptimin e foljes? (ndajfolje)

Përgjigjet e nxënësve shënohen në tabelë.

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapen librat në faqen 62. Lexohen shembujt e dhënë në tekst. Nxënësve u thuhet se ndajfoljet tregojnë rrethana vendi, kohe, mënyre, sasi, ku kryhet veprimi. Ato plotësojnë kuptimet e foljeve dhe zakonisht rrinë pranë foljes. Ndajfoljet u përgjigjen pyetjeve: *Ku? (vendi); kur? (kohe); si? (mënyre); sa? (sasi)*

Pastaj së bashku me nxënës punohet ushtrimi 1 dhe 2. Tek ushtrimi 1 në tekstin e dhënë do të gjenden llojet e ndajfoljeve dhe më pas shkruhen në tabelën që është në tekst (e këtij lloji):

<i>Ndajfolje vendi</i>	<i>Ndajfolje kohe</i>	<i>Ndajfolje mënyre</i>	<i>Ndajfolje sasi</i>
1. _____	1. _____	1. _____	1. _____
2. _____	2. _____	2. _____	2. _____
3. _____	3. _____	3. _____	3. _____
4. _____	4. _____	4. _____	4. _____
5. _____	5. _____	5. _____	5. _____

Edhe në ushtrimin 2 do të gjenden ndajfoljet në tekstin e dhënë në libër dhe do të nënvizohen.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit do të ndahen në dy grupe të mëdha. Grupi i parë do të punojë ushtrimin 3 në libër në faqen 66, ku do të bëjnë dallimin në mes të ndajfoljeve dhe mbiemrave, kurse grupi i dytë do të punojë ushtrimin 4, që gjithashtu, është faqen 66. Grupi në fjalë do të krijojë fjali ndajfoljet që janë dhënë në ushtrim. Mësuesja përcjell punën e grupeve. Në fund, përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e ndajfoljeve, llojet e tyre, si dhe për punën e pavarur në grupe.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani nga 5 ndajfolje për secilin lloj të tyre.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.5; II.4; III.1; III.4; IV.3; V.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 2.7; 3.2; 7.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Parajsa e rrezikuar

Fjalët kyçe: peshkimi, eksplozivi, Toka, helmimi

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Sjell informacion për mjedisin;
- Nxjerr nga teksti të dhënat që kanë të bëjnë me dëmtimin e gjallesave;
- Lexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij.

Kriteret e suksesit:

- Shpjego domethënien ruajtjen e mjedisit;
- Lexo me kujdes tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij;
- Përgjigju saktë pyetjeve të librit.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Nxënësve ua parashtroj pyetjet si në vijim:

- *Keni dëgjuar për dëmtimin e mjedisit?*
- *Po për dëmtimin e gjallesave nënujore?*
- *Dini diçka për eksplozivët?*
- *Çka mendoni a e dëmtojnë mjedisin ato?*

Të gjitha përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë dhe më pas komentohen së bashku me mësuesen.

REALIZIMI – Rrjeti i diskutimit

Hapen libri në faqen 67 dhe për disa minuta nxënësit lexojnë në heshtje informacionin e dhënë për mjedisin dhe rrezikun që i kanoset. Së bashku me nxënës punohet rubrika: ***Të flasim***, ku do të bisedohet për *kurthet në det, për peshkimin masiv, për turizmin, për ngrohjen globale, për ndotjen e ujit*. Së bashku me nxënës diskutohet për temat në fjalë, duke inkuadruar sa më shumë nxënës në diskutim. Pastaj punojmë rubrikën: ***Të kuptojmë tekstet***, ku tekstet në fjalë janë shkencore, sepse japin të dhëna të vërtetuara. Në vazhdim plotësohen pyetjet në faqen 69 dhe 70. Mësuesja vazhdimisht përcjell punën e nxënësve, duke dhënë plotësime eventuale.

REFLEKTIMI – Punë e pavarur

Nxënësit do të punojnë të pavarur për temën: ***Çfarë pasojash sjell ndotja e ujit?*** Nxënësve do t'u jepet 10 minuta kohë për ta elaboruar me fjalët e tyre temën në fjalë. Krejt në fund, nxënësit lexojnë punimet e tyre. Hapësirë u jepet sa më shumë nxënësve për të parë se sa ishin të saktë në shkrimin e temës në fjalë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për diskutimet përmbajtjesore, si dhe për punën e pavarur.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani një ese për temën: Dita e Tokës.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3,4; II.5; III.1,2,4,5; V.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.4,9,10; 2.5,6; 3.2,7,8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Muzika ndër vite (Nexhmie Pagarusha)

Fjalët kyçe: Nexhmie Pagarusha, këngëtare, mbretëreshë, muzikë, interpretim

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Trego disa nga këngët që di;
- Shpjego rolin individual të njerëzve të mëdhenj;
- Dallon rolin që kanë njerëzit e mëdhenj në afirmimin e shtetit tonë.

Kriteret e suksesit:

- Trego për këngët e kësaj dive muzikore;
- Përgjigju pyetjeve të tekstit;
- Diskuto për këngët hite të kësaj dive muzikore.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Diskutimi

Paraqitet tema për të cilën do të diskutohet me nxënësit. Përmend ndonjë nga këngët që di dhe trego se cila të pëlqen më së shumti. Nxënësit diskutojnë me radhë brenda grupit për ndonjë këngëtar a këngëtare të njohur që di, etj. Mësuesja kërkon nga nxënësit që në pika të shkurtra të tregojnë për ndonjë këngëtare kosovarë, që ka bërë emër në botë.

REALIZIMI – Ditari dypjesësh

Prezantohet tema: *Muzika ndër vite (Nexhmie Pagarusha)* – faqe 72. Më pas tregohet paraprakisht rëndësia që ka muzika. Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe diskutohet me tërë klasën. Lexohet teksti që ka të bëjë me sukseset e *Nexhmie Pagarushës* dhe nxirren informacionet për këngët e sak dhe për sukseset e Nexhmies në skenën muzikore. Në njëërën anë tregohet lloji i muzikës, ndërsa në anën tjetër zëri fenomenal i saj. Disa nga punimet e nxënësve lexohen dhe vlerësohen.

REFLEKTIMI – Shkrim i lirë

Nxënësit shkruajnë disa fjali për muzikën, konkretisht për Nexhmie Pagarushën. Punimet e tyre lexohen para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore në fjalë, si dhe për shkrimin që ka të bëjë me këngëtares me vlera kombëtare – Nexhmie Pagarushën.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: T'u përgjigjen 7 pyetjeve në faqen 72 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lidhëzat

Fjalët kyçe: lidhëz, fjalë, fjali, bashkërenditëse

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon lidhëzat në fjali;
- Dallon lidhëzat bashkërenditëse që përdoren në fjali;
- Krijon fjali duke përdorur lidhëza bashkërenditëse..

Kriteret e suksesit:

- Dallo lidhëzat në fjali;
- Trego për funksionin që kanë lidhëzat në fjali;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Mendo - diskuto

Me anë të videoprojektorit nxënësit vërejnë fjalët: *e, edhe, ku, dhe, kur, ose, sikur, prandaj, meqë, por, posa, kurse, sepse, në qoftë se*, të cilat janë të nënvizuara. Diskutohet me nxënës për fjalët që po vërejnë. Nxënësit japin mendimet e tyre, të cilat shkruhen në tabelë.

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapen librat në faqen 73. Lexohen shembujt e dhënë në tekst. Nxënësve u thuhet se lidhëzat janë fjalë të pandryshueshme të ligjëratës. Ato shërbejnë për të lidhur fjalët kuptimplota, si: emrat, mbiemrat, përemrat, numërorët, foljet dhe ndajfoljet, fjalitë e bashkërenditura dhe të nënrenditura. Pastaj fillojmë ta punojmë ushtrimin 1 dhe 2 të librit, ku synohet që në tekstin e dhënë të gjenden lidhëzat dhe të nënvizohen. Kurse në ushtrimin 2 si synim kemi që të tregojmë se lidhëzat në shembujt që janë në libër çfarë lidhin.

Shembull:

- *Riga dhe Era vazhduan kërkimin* _____
- *Eroni ka duar të gjata dhe të mëdha* _____

REFLEKTIMI – Punë e pavarur

Nxënësit do të punojnë të pavarur ushtrimin 3 në libër, ku do të rrethojnë fjalët e dhëna, që janë lidhëza. Pastaj secili nxënës prezanton punën e bërë. Jepen sqarimet plotësuese nga mësuesja.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e lidhëzave, si dhe për punën e pavarur.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani 6 fjali, duke përdorur lidhëzat.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.6; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Gallofi dhe qypi me mjaltë (ora e parë)

Fjalët kyçe: gallofi, dhelpra, patat, lepuri, iriqi, ketri, kaprolli

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Shpreh njohuritë që ka rreth tekstit në fjalë;
- Përgjigjet në pyetjet rreth tekstit;
- Flet për personazhet e tekstit.

Kriteret e suksesit:

- Përgjigju në pyetjet e tekstit;
- Shpreh njohuritë që ka për tekstin në fjalë;
- Analizo tekstin në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Parashikimi me terma paraprakë

Kontrollohen detyrat e shtëpisë, si dhe bëjmë përsëritjen e njësisë së fundit mësimore. Pastaj mësuesja shënon në tabelë fjalët kyçe: **gallofi, dhelpira, patat, lepuri, iriqi, ketri, kaprolli**. Nxënësit do të shkruajnë individualisht nga një tregim të shkurtër, duke i marrë për bazë këto fjalë kyçe. Pastaj tregimet e punuara do t'i lexojnë para të tjerëve.

REALIZIMI – Lexim në dyshe, lexim i drejtuar

Pasi ndahen në grupe, nxënësit udhëzohen që të hapen librat e gjuhës shqipe në faqen 73, te teksti: **Gallofi dhe qypi me mjaltë** dhe lexojnë pjesën e parë. Dhe, sipas ndarjes do të punojnë në grupe për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

- *Kush e thërret gallofin rrugës për festë?*
- *Çfarë i ofron dhelpira dhe përse?*
- *Çfarë kishte në mjaltë?*
- *Si e kuptojnë patat?*
- *Kush e mund dhelpren?*

Nxënësit pos në grupe, diskutojnë edhe në dyshe për mendimet dhe idetë e tyre rreth pyetjeve dhe pastaj ato diskutohen me tërë klasën. Vlerësohen porositi më të bukura, ku ato shkruhen në një kënd të klasës. Pastaj angazhohen disa nxënës që ta lexojnë tekstin. Gjatë leximit nxënësit këshillohen që të respektohen shenjat e pikësimit. Në lexim angazhohen sa më shumë nxënës, në mënyrë që pjesa e leximit në fjalë të kuptohet sa më mirë. Kështu vazhdohet edhe me pjesën e dytë, ku mësuesja paraqet pyetjet e nxënësit e përgjigjen. Njëjtë veprohet edhe me leximin e pjesës së tretë.

REFLEKTIMI – Punë në dyshe

Në dyshe do të punohet vazhdimi i rubrikës: **Të analizojmë**, konkretisht pyetjet në faqen 76 dhe 77 të librit. Pastaj analizohen edhe shprehjet, si dhe motivi i pjesës. Më pas dyshet prezantojnë punën e bërë para klasës. Kështu vazhdohet edhe me dyshet e tjera.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në klasë, si dhe për leximin, ku u respektohen shenjat e pikësimit. Gjithashtu, vlerësohet edhe puna në dyshe.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani për personazhin e gallofit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Komptenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.5; I.6; I.8; IV.3

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.8; 2.1; 2.2; 3.5

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Gallofi dhe qypi me mjaltë (ora e dytë)

Fjalët kyçe: gallofi, dhelpra, patat, lepuri, iriqi, ketri, kaprolli

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përmbledh përmbajtjen e tekstit;
- Plotëson detyrat sipas kërkesave të dhëna;
- Përshkruan personazhin me disa fjali.

Kriteret e suksesit:

- Plotëso detyrat e dhëna;
- Shkruaj përmbajtjen e tekstit;
- Përshkruaj personazhin kryesor me disa fjali të shkurtra.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Shqyrtimi i përbashkët

Me nxënës diskutohet rreth pyetjeve të mëposhtme:

- *Cili ishte dallimi në mes të tri pjesëve të tekstit?*
- *Në cilat shkrime përdoren kafshët si personazhe për të treguar vetitë e njerëzve?*
- *Cili ishte personazhi i gallofit?*

REALIZIMI – Leximi në dyshe

Nxënësit lexojnë në dyshe.

Nxënësi i parë lexon pjesën e parë dhe e përmbledh me disa fjali të shkurtra. Nxënësi i dytë parashtron pyetje rreth asaj që lexoi nxënësi i parë. Gjatë leximit, ndërrohen rolet. Kështu vazhdohet, ku krejt në fund disa dyshe e përmbledhin tekstin në përgjithësi. Pastaj, përmes bisedave me nxënës paraqiten cilësitë e secilit personazh.

REFLEKTIMI – Shkrimi i lirë

Nga nxënësit kërkohet që të shkruajnë me disa fjali për të tria pjesët e tekstit. Me një fjalë të bëhet një analizë e shkurtër për pjesët në fjalë. Disa punime të nxënësve lexohen para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore në fjalë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruajeni me fjalët tuaja kuptimin e të tria pjesëve!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.8; II.5; III.1; III.3; III.4; III.8; V.5; V.8; VI.2; VI.3; VI.3

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. 1; 1. 2; 1.4; 1. 8; 2. 1; 2. 5; 2. 6; 2. 7; 3. 2; 3. 3; 3.4; 3.5; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Fjalja e thjeshtë dhe gjymtyrët e saj

Fjalët kyçe: fjali e thjeshtë, fjali më e vogël, gjymtyrë kryesore, plotësuese

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon fjalitë e thjeshta dhe gjymtyrët e saj;
- Dallon fjalinë e thjeshtë më të vogël nga fjalja e thjeshtë e zgjeruar;
- Analizon shembujt e dhënë në libër.

Kriteret e suksesit:

- Dallo fjali të thjeshta;
- Krahaso fjalinë e thjeshtë më të vogël nga ajo më e zgjeruar;
- Analizo shembujt e librit.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Vëzhgo - analizo

Me anë të videoprojektorit paraqiten fjali të thjeshta:

Arsimtarët shkuan.

Arsimtarët shkuan shpejt në shkollë.

Fjalja e parë është fjali e thjeshtë, që përbëhet nga kryefjala dhe kallëzuesi. Kurse fjalia e dytë është fjali e zgjeruar, ku përveç kryefjalës dhe kallëzuesit ka edhe pjesë të tjera plotësuese.

REALIZIMI – Të nxënësve në bashkëpunim

Hapen librat në faqen 78. Lexohen shembujt e dhënë dhe rregullat gjuhësore. Arrihet në përfundim se kryefjala dhe kallëzuesi janë *gjymtyrë kryesore* të fjalisë, pasi luajnë rolin kryesor në fjali. Pjesët plotësuese janë *gjymtyrë të dyta* të fjalisë, pasi luajnë rol plotësues në fjali. Pastaj nxënësve u thuhet se fjalia e thjeshtë ka një ose dy e më shumë fjalë, që lidhen sipas kuptimit dhe rregullave gramatikore. Gjithashtu, nxënësve iu bëhet me dije se kryefjalën në fjali e gjejmë me pyetjen:

Kush? Cili? Kurse kallëzuesi gjendet me fjalën: *Ç'bën? Ç'gjendje*. Më pas vazhdohet me rubrikën:

Ushtrime, ku punohen ushtrimet 1, 2 dhe 3. Në ushtrimin 1 me fjalët që janë tekst (faqe 78)

nxënësit do të krijojnë fjali të thjeshta të pazgjeruara dhe fjali të thjeshta të zgjeruara. Në ushtrimin 2, në tekstin e dhënë do të gjenden fjalitë e thjeshta të pazgjeruara. Ndërkaq, në ushtrimin 3, po nga i njëjti tekst do të gjenden: kryefjala dhe kallëzuesi, si dhe gjymtyrët e dyta të fjalisë.

REFLEKTIMI – Punë e pavarur

Kërkohet nga nxënësi që të punohet ushtrimi 5, ku do të dallojnë gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Nënvizohen me ngjyra të ndryshme për t'u dalluar. Natyrisht, do të kenë ndihmën eventuale edhe të mësueses. Në fund, nxënësit prezantojnë punën e tyre. Jepen sqarime të nevojshme plotësuese.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e fjalive të thjeshta dhe zgjeruara, dallimin e gjymtyrëve kryesore nga gjymtyrët e dyta.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 4 në faqen 79 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.6; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mësuesi i sëmurë

Fjalët kyçe: mësuesi i sëmurë, Enriku, nëna

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Shpreh njohuritë që ka rreth tekstit në fjalë;
- Përgjigjet në pyetjet rreth tekstit;
- Flet për personazhet e tekstit.

Kriteret e suksesit:

- Përgjigju në pyetjet e tekstit;
- Shpreh njohuritë që ka për tekstin në fjalë;
- Analizo tekstin në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Parashikimi me terma paraprakë

Kontrollohen detyrat e shtëpisë, si dhe bëjmë përsëritjen e njësisë së fundit mësimore. Pastaj mësuesja shënon në tabelë fjalët kyçe: mësuesi i sëmurë, Enriku, nëna. Nxënësit do të shkruajnë individualisht nga një tregim të shkurtër, duke i marrë për bazë këto fjalë kyçe. Pastaj tregimet e punuara do t'i lexojnë para të tjerëve.

REALIZIMI – Lexim në dyshe, lexim i drejtuar

Pasi ndahen në grupe, nxënësit udhëzohen që të hapen librat e gjuhës shqipe në faqen 79, te teksti: *Mësuesi i sëmurë* dhe lexojnë pjesën e parë. Dhe, sipas ndarjes do të punojnë në grupe për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

- *Ku shkoi Enriku pasdite ?*
- *Pse ishte shkatërruar shëndeti i mësuesit?*
- *Tregoni arsyet?*
- *Çka i tha mësuesi Enrikut kur e pa?*
- *Çka vërejti Enriku në mur?*
- *Cila ishte këshilla që mësuesi ia dha Enrikut?*
- *Pse mësuesi kur e puthi Enrikun e ktheu fytyrën nga muri?*

Nxënësit pos në grupe, diskutojnë edhe në dyshe për mendimet dhe idetë e tyre rreth pyetjeve dhe pastaj ato diskutohen me tërë klasën. Vlerësohen porositë më të bukura, ku ato shkruhen në një kënd të klasës. Pastaj angazhohen disa nxënës që ta lexojnë tekstin. Gjatë leximit nxënësit këshillohen që të respektohen shenjat e pikësimit. Në lexim angazhohen sa më shumë nxënës, në mënyrë që pjesa e leximit në fjalë të kuptohet sa më mirë. Kështu vazhdohet edhe me pjesën e dytë, ku mësuesja paraqet pyetjet e nxënësit e përgjigjen.

REFLEKTIMI – Pesëvargëshi

Nxënësit do të përpilojnë një pesëvargësh me temën: *Mësuesi*.

Mësuesi
i ngratë i dashur
shkova shoh shërohem
Ai dridhej nga temperatura
Prindi i dytë

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në klasë, si dhe për leximin, ku u respektohen shenjat e pikësimit. Gjithashtu, vlerësohet edhe puna në përpilimin e pesëvargëshit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruajeni një ese me temën: Mësuesi im.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.8; II.5; III.1; III.3; III.4; III.8; V.5; V.8; VI.2; VI.3; VI.3

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. 1; 1. 2; 1.4; 1. 8; 2. 1; 2. 5; 2. 6; 2. 7; 3. 2; 3. 3; 3.4; 3.5; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Grupi i kryefjalës dhe grupi i kallëzuesit (grupi emëror dhe grupi foljor)

Fjalët kyçe: grup emëror, grup foljor, emri, mbiemri, folja, ndajfolja

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon grupet emërore dhe grupet foljore;
- Dallon kryefjalën dhe kallëzuesin;
- Analizon shembujt e dhënë në libër.

Kriteret e suksesit:

- Dallo grupe emërore dhe grupe foljore;
- Dallo kryefjalën dhe kallëzuesin;
- Analizo shembujt e librit.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Vëzhgo - analizo

Me anë të videoprojektorit paraqiten fjali të ndryshme që kanë grupet emërore dhe foljore:

- *Zogu i malit fluturon shpejt.*
- *Dritaret e klasës ishin hapur herët.*
- *Djali i madh mori shumë para.*

Në shembujt e lartshënuar kemi edhe grupe të kryefjalës dhe grupe foljore. Së bashku me nxënës i gjejmë ato dhe i nënvizojnë.

REALIZIMI – Të nxënit në bashkëpunim

Hapen librat në faqen 81. Lexohen shembujt e dhënë dhe rregullat gjuhësore. Arrihet në përfundim se kryefjala dhe kallëzuesi janë *gjymtyrë kryesore* të fjalisë, pasi luajnë rolin kryesor në fjali. Pastaj nxënësve u thuhet se grupin emëror e përbëjnë: *emri, mbiemri, përemri dhe numërori*, kurse grupin foljor e përbëjnë: *folja dhe ndajfolja*. Më pas vazhdohet me ushtrimin 1, ku në tekstin e dhënë, nxënësit e ndarë në grupe do të gjejnë grupin emëror dhe grupin foljor. Grupi A do të gjejë grupin emëror dhe grupi B – grupin foljor.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit e ndarë në dy grupe, në tekstin tjetër të dhënë në libër do të gjejnë kryefjalën dhe kallëzuesin. Pastaj prezantojnë punën e bërë në grupe. Bëhen plotësimet e nevojshme nga mësuesja.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e grupeve emërore dhe grupeve foljore, si dhe gjetjen e kryefjalës dhe të kallëzuesit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ushtrimi i fundit i mësimit në fjalë, ku nxënësit në tekstin e dhënë do të gjejnë grupin e kryefjalës dhe të kallëzuesit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kryefjala

Fjalët kyçe: kryefjala, gjymtyrë kryesore, emri, rasa, trajta e shkurtër

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon kryefjalën në fjali;
- Tregon se kryefjala shprehet me emër në trajtën e shquar të rasës emërore;
- Tregon se rasa emërore është rasa tipike e kryefjalës.

Kriteret e suksesit:

- Dallo kryefjalën në fjali;
- Trego se kryefjala shprehet me emër në trajtën e shquar të emërores;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Mendo - diskuto

Me anë të videoprojektorit nxënësit vërejnë disa fjali, si:

- **Bardha recitoi për mrekulli.**
- **Bardhi shkroi një vepër letrare.**

Nxënësit japin përgjigjet e tyre rreth emrave të nënvizuar, ku vihet në përfundim se kemi të bëjmë me kryefjalën.

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapen librat në faqen 81. Lexohen shembujt e dhënë në tekst. Nxënësve u thuhet se kryefjala është fjala për të cilën flitet në fjali. Ajo është gjymtyrë kryesore e fjalisë. Kryefjala shprehet me emër në trajtën e shquar të rasës emërore. Rasa emërore është rasa tipike e kryefjalës. Nxënësve u thuhet se kryefjala shprehet me një përemër vetor, dëftor apo pronor. Merren shembujt e librit, që janë në faqen 81. Në ushtrimin 1, në tekstin e dhënë në libër, nxënësit do të gjejnë dhe do të nënvizojnë kryefjalën.

REFLEKTIMI – Punë e pavarur

Nxënësit do të punojnë të pavarur ushtrimin e radhës në libër, ku do të nënvizojnë kryefjalën dhe do të tregojnë se me se është shprehur. Pastaj secili nxënës prezanton punën e bërë. Jepen sqarimet plotësuese nga mësuesja.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e kryefjalës në fjali, si dhe për punën e pavarur.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ushtrimi i fundit i mësimin në fjalë, ku nxënësit do të krijojnë fjali me fjalët e dhëna në libër.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë – shkruajmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.4; II.2; III.1; III. 2; III.5; V.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.4; 1.9; 1.10; 2.1; 2. 3; 2.4; 2.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Biografia dhe autobiografia

Fjalët kyçe: biografia, veta III, autobiografia, veta I

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon shkrimin biografik nga ai autobiografik;
- Shkruan një shkrim të shkurtër biografik për një figurë të respektuar;
- Kthen një tekst nga veta e parë në të tretën dhe anasjelltas .

Kriteret e suksesit:

- Dallo shkrimin biografik nga ai autobiografik;
- Kthe një tekst nga veta e parë në të tretën dhe anasjelltas;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Lexim i heshtur

Me anë të videoprojektorit mësuesja shfaq dy tekstet e dhëna në libër, njërin për Ali Podrimen e tjetrin për Haki Stërmillin, ndërkohë që librat e nxënësve janë të mbyllura. Nxënësit lexojnë në heshtje të dyja tekstet me qëllim që t'u përgjigjen pyetjeve që i parashtron mësuesja. Pas leximit mësuesja iu drejtohet nxënësve:

- *Cili tekst është shkruar e parë e cili në të tretën?*
- *Në cilin tekst flitet për një person tjetër?*
- *Në cilin tekst autori shkruan për veten e tij?*

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapen librat në faqen 82 të librit. Udhëzohen nxënësit që në fletoret e tyre ta kthejnë tekstin e parë në veten e parë dhe tekstin e dytë në veten e tretë. Më pas lexohen disa prej tyre. Punimet më të mira vendosen në mur.

REFLEKTIMI – Punë individuale

Nxënësit do të punojnë të pavarur, ku do të shkruajnë secili biografinë (autobiografinë) e tyre, duke u bazuar në atë që mësuan. Pastaj prezantojnë punën e bërë, duke bërë krahasimin e tyre dhe duke vërejtur ndryshimet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për punën e bërë. Disa punime vlerësohen me notë nga mësuesja.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: T'u përgjigjen pesë pyetjeve në faqen 84 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Me se shprehet kallëzuesi

Fjalët kyçe: kallëzues, kallëzues foljor, emëror

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon kallëzuesin në fjali me anë të pyetjes;
- Dallon me se është shprehur kallëzuesi;
- Krijon fjali, ku kallëzuesi shprehet me kategori gramatikore të ndryshme.

Kriteret e suksesit:

- Dallo kallëzuesin në fjali;
- Dallo me se është shprehur kallëzuesi;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Mendo - diskuto

Me anë të videoprojektorit mësuesja paraqet para nxënësve disa fjali:

- *Pjesëtarët e stafit u paraqitën në punë.*
- *Ata shikuan çdo gjë përreth.*
- *Ai zuri të fliste.*
- *Erdhi edhe një burrë tjetër.*

Me nxënës diskutohet se çka janë fjalët me ngjyrë të zezë. Nxënësit japin përgjigjet e tyre. Nëse nuk kemi përgjigje të saktë, atëherë mësuesja tregon se këto fjalë janë **kallëzues**.

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapen librat në faqen 85. Lexohen shembujt e dhënë në tekst. Nxënësve u thuhet se kallëzuesi është gjymtyrë kryesore e fjalisë, që tregon gjendjen ose veprimin që kryen kryefjala. Pra, kallëzuesi shprehet me folje të cilës kohë. Merren shembujt e librit, që janë në faqen 85. Në ushtrimin 1, në tekstin e dhënë në libër, nxënësit do të gjejnë dhe do të nënvizojnë kallëzuesin. Vazhdohet edhe me ushtrimin 2, ku në tekstin e dhënë do të gjendet kallëzuesi dhe do të tregohet me se është shprehur. Nxënësve, gjithashtu u thuhet se kryesisht kur flasim dominon kallëzuesi foljor, por kemi edhe kallëzuesin emëror folja **jam+emër** dhe folja **jam+mbiemër**.

REFLEKTIMI – Punë e pavarur

Nxënësit do të punojnë të pavarur, ku do të shkruajnë nga 2 fjali, të cilat do ta kenë kallëzuesin foljor dhe kallëzuesin emëror.

Shembull:

- *Punëtorët ndërtuan një pallat të ri.* (Kallëzues foljor)
- *Koha është e bukur.* (Kallëzues emëror)

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e kallëzuesit në fjali, dallimin e kallëzuesit foljor nga kallëzuesi emëror, si dhe krijimin e fjalive me llojet e kallëzuesve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 3 në faqen 85 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë – dëgjojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.6; II.2; II.3; II.5; III.1; III. 3; III.4; III.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 2.1; 2.2; 2.7; 3.1; 3.2; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pse jemi vallë kështu?

Fjalët kyçe: dashuria, respekti, urrejtja, njerëzit

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Lexon pastër dhe pa gabime poezinë në fjalë;
- Thotë kuptimin e poezisë më fjalët e veta;
- Gjykojnë për tematikën dhe idetë e autorit.

Kriteret e suksesit:

- Lexo pastër dhe pa gabime poezinë;
- Veço elementet që ka poezia;
- Mëso përmendësh poezinë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Mësuesja u parashtron nxënësve disa pyetje:

- Çka mendoni a kemi nevojë për ndihmën e njëri-tjetrit?
- A duhet ta respektojmë më të vjetrin?
- Po shokun apo shoqen a duhet respektuar?

Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë dhe diskutohen së bashku, për ta nxjerrë qëllimin e orës mësimore.

REALIZIMI – Ruaje fjalën e fundit për mua - 25 minuta

Nxënësit do të punojnë në bazë të udhëzimeve që do t'u jepen në vazhdim. Në fillim, hapen librat në faqen 87 dhe udhëzohen që ta lexojnë poezinë. Gjatë leximit kërkohet që të zgjedhin një pjesë që u pëlqen më shumë dhe të njëjtën ta shkruajnë në fletoret e tyre. Në anën tjetër të fletës, do të shkruajnë komentin e zgjedhur. Mund të shkruajnë edhe ndonjë gjë, që është në kundërshtim me pjesën e zgjedhur. Pas përfundimit të leximit dhe mbajtjes së shënimeve, një nxënës lexon pjesën e zgjedhur, ndërkaq nxënësit, të cilët kanë zgjedhur po atë pjesë japin mendimet e tyre. Kështu vazhdon edhe me nxënësit e tjerë.

REFLEKTIMI – Pesëvargëshi – 10 minuta

Nxënësit do të përpilojnë një pesëvargësh me temën: *Dashuria*.

Dashuria
e fortë e sinqertë
gjykojmë bisedojmë qëndrojmë
Kemi nevojë për njëri-tjetrin

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore, si dhe për përpilimin e pesëvargëshit.

Detyrë shtëpie: T'u përgjigjen 8 pyetjeve të rubrikës: *Të analizojmë*, në faqen 87 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përcaktori

Fjalët kyçe: përcaktor, rasa gjinore, saktëson, mbiemër, rasa rrjedhore, përemër

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon grupet e fjalëve të përbëra nga emri+mbiemri ose emër+emër në fjalitë e dhëna;
- Krijon grupe fjalësh me përcaktor, duke treguar çfarë saktëson ose cilëson përcaktori;
- Analizon shembujt e dhënë në libër.

Kriteret e suksesit:

- Dallo përcaktorët në fjali;
- Ndërto fjali, duke përdorur përcaktorë;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Mendo - diskuto

Me anë të videoprojektorit nxënësit vërejnë disa fjali, si:

- Kryetari i **Komunës** propozoi të ndërtojë një shkollë të re.
- Ajo do të ndërtohet te shkolla e **vjetër** me madhësi **dyfishë**.

Çfarë roli luajnë fjalët e nënvizuara. Nxënësit japin përgjigjet e tyre. Nëse nxënësit nuk e thonë atë që kërkohet, këtë e thotë mësuesja. Pra, fjalët e nënvizuara janë **përcaktorë**.

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapen librat në faqen 88. Lexohen shembujt e dhënë në tekst. Nxënësve u thuhet se përcaktori është gjymtyrë e dytë e fjalisë, e cila plotëson kuptimin gjymtyrëve kryesore (kryefjalës dhe kallëzuesit). Përcaktorët janë fjalië, të cilat përcaktojnë ose cilësojnë një gjymtyrë emërore. Përcaktorët mund të jenë mbiemra që tregojnë cilësinë e emrit: *djalë i mirë, vajzë e vogël, fushë e madhe, vend i huaj*, etj. Përcaktorët mund të jenë emra në rasën gjinore: *Plani i ndërtimit, punët e shtëpisë, oborri i shkollës*. Përcaktori mund të jetë edhe emër në rasën rrjedhore: *çorape prej leshi, kumbulla fshati, qumësht lope*. Përcaktori mund të jetë përemër: *Kjo gotë, ky djalë, libri im*.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit do të ndahen në dy grupe. Grupi i parë do të krijojë 5 fjali me përcaktorë, që tregojnë cilësi, ndërkaq grupi i dytë do të krijojë 5 fjali me përcaktorë, që tregojnë saktësi. Mësuesja përcjell punën e grupve, duke dhënë sqarime eventuale. Në fund, përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e dallimin e grupeve emërore në fjali; dallimin e përcaktorëve në grupet emërore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Me fjalët: *e shtëpisë, e qytetit, e fshatit, e Shpresës* krijoni fjali, ku këto fjali të jenë përcaktorë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.6; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Nektar nga hojet krijuese (ora e parë)

Fjalët kyçe: emra shqiptarë, monizmi, Astriti, Qemali, Elbasani, Stavri

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Shpreh njohuritë që ka rreth tekstit në fjalë;
- Përgjigjet në pyetjet rreth tekstit;
- Flet për personazhet e tekstit.

Kriteret e suksesit:

- Përgjigju në pyetjet e tekstit;
- Shpreh njohuritë që ka për tekstin në fjalë;
- Analizo tekstin në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Parashikimi me terma paraprakë

Kontrollohen detyrat e shtëpisë, si dhe bëjmë përsëritjen e njësisë së fundit mësimore. Pastaj mësuesja shënon në tabelë fjalët kyçe: *emra shqiptarë, monizmi, Astriti, Qemali, Elbasani, Stavri*. Nxënësit do të shkruajnë individualisht nga një tregim të shkurtër, duke i marrë për bazë këto fjalë kyçe. Pastaj tregimet e punuara do t'i lexojnë para të tjerëve.

REALIZIMI – Lexim në dyshe, lexim i drejtuar

Pasi ndahen në grupe, nxënësit udhëzohen që të hapen librat e gjuhës shqipe në faqen 88, te teksti: *Nektar nga hojet krijuese* dhe lexojnë pjesën e parë. Dhe, sipas ndarjes do të punojnë në grupe për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

Pse shkrimi titullohet: Nektar nga hojet krijuese?

Çfarë sqaron autori në tekstin e lexuar?

Shkrimet e kujt janë analizuar?

Për sa kallëzime shkruan shkrimtari?

Cila iu la përshtypje?

Nxënësit pos në grupe, diskutojnë edhe në dyshe për mendimet dhe idetë e tyre rreth pyetjeve dhe pastaj ato diskutohen me tërë klasën. Vlerësohen porosinë më të bukura, ku ato shkruhen në një kënd të klasës. Pastaj angazhohen disa nxënës që ta lexojnë tekstin. Gjatë leximit nxënësit këshillohen që të respektohen shenjat e pikësimit. Në lexim angazhohen sa më shumë nxënës, në mënyrë që pjesa e leximit në fjalë të kuptohet sa më mirë. Kështu vazhdohet edhe me pjesën e dytë, ku mësuesja paraqet pyetjet e nxënësit e përgjigjen.

REFLEKTIMI – Punë në dyshe

Nxënësit punojnë në dyshe, ku do përpiqen që t'i përmbledhin me fjalët e tyre kallëzimet e përfshira në tekst. Do të diskutojnë për:

Betejën për një emër

Qytetin e kumrive

Një kumri në stuhi

Në ballkon

Shkencëtari i madh

Konkursi

Në fund, dyshet prezantojnë punën e tyre para klasës. Jepen komente e sqarime plotësuese.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në klasë, si dhe për leximin, ku u respektohen shenjat e pikësimit. Gjithashtu, vlerësohet edhe puna e bërë në dyshe.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Plotësojini pyetjet 2, 3, 4 në faqen 90 dhe 91 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.6; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Nektar nga hojet krijuese (ora e dytë)

Fjalët kyçe: emra shqiptarë, monizmi, Astriti, Qemali, Elbasani, Stavri

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përmbledh përmbajtjen e tekstit;
- Plotëson rubrikat sipas kërkesave të dhëna;
- Përshkruan personazhet me disa fjali.

Kriteret e suksesit:

- Përmbledh përmbajtjen e tekstit;
- Plotëso rubrikat e dhëna në tekst;
- Analizo tekstin në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Shqyrtimi i përbashkët

Me nxënës diskutohet rreth pyetjeve, për të cilat ata janë përgjigjur:

- *Cili është mesazhi i pjesës?*
- *A e kuptoni titullin e tekstit: Nektar nga hojet krijuese?*
- *Si e kuptoni paragrafin e parë të tekstit rreth pagëzimeve të fëmijëve me emra shqiptarë?*
- *Cili emër përsëritet në titujt e dy kallëzimeve?*

REALIZIMI – Lexim në dyshe

Nxënësit lexojnë në dyshe. Nxënësi i parë lexon pjesën e parë dhe e përmbledh me disa fjali të shkurtra. Nxënësi i dytë parashtron pyetje rreth asaj që lexoi nxënësi i parë. Gjatë leximit, ndërrohen rolet. Kështu vazhdohet, ku krejt në fund disa dyshe e përmbledhin tekstin në përgjithësi. Pastaj, përmes bisedave me nxënës paraqiten cilësitë e secilit personazh.

REFLEKTIMI – Shkrimi i lirë

Nga nxënësit kërkohet që të shkruajnë disa fjali për përrallën: *Hansel dhe Gretel*. Shkrimin do ta bëjnë, duke u bazuar në tekstin: Nektar nga hojet krijuese. Pastaj, nxënësit do të prezantojnë punën e tyre. Mësuesja jep sqarimet dhe komentet e nevojshme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në lexim, si dhe për shkrimin e lirë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ta shkruajnë kuptimin e tekstit: Nektar nga hojet krijuese.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kundrinori i drejtë

Fjalët kyçe: kundrinor i drejtë, emra në rasën kallëzore, përemër, grup emëror

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon grupet foljore të kallëzuesit në fjali;
- Dallon gjymtyrët plotësuese në grupet e kallëzuesit;
- Dallon kundrinorin e drejtë me anë të pyetjeve: Kë? Cilin?

Kriteret e suksesit:

- Dallo grupet foljore të kallëzuesit në fjali;
- Dallo gjymtyrët plotësuese në grupet e kallëzuesit;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIM – Diskutim idesh

Me anë të videoprojektorit paraqiten disa fjali, ku mësuesja bën pyetje:

- *Mua më dhanë lapsin.*
- *Ata e thirrën mësuesin.*
- *E mësuat vjershën?*
- *I morët librat?*

Nxënësit japin përgjigjet e tyre rreth asaj se çfarë janë fjalët e nënvizuara. Pra, fjalët e nënvizuara janë kundrinor të drejtë me trajtë të shkurtër të përemrit vetor. Pastaj paraqitet një kllaster para nxënësve:



REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapen librat në faqen 92. Lexohen shembujt e dhënë në tekst. Nxënësve u thuhet se kundrinori i drejtë është një emër, përemër në rasën kallëzore pa parafjalë. Këto fjalë u përgjigjen pyetjeve: **Kë? Cilin? Cilën? Cilët? Cilat? Çfarë?** Kundrinori i drejtë mund të jetë i përsëritur me trajtë të shkurtër të përemrit vetor në rasën kallëzore, si: *(mua) më; (ne) na; (ty) të; (ju) ju; (atë) e; (ata, ato) i*. Pastaj vazhdohet me ushtrimin 1, ku në tekstin e mëposhtëm do të gjenden e do të nënvizohen kundrinorët e drejtë.

REFLEKTIMI – Punë individuale

Nxënësit do të punojnë individualisht ushtrimin 2 të librit. Do të shkruajnë 10 fjali me kundrinorë të drejtë dhe më pas do të gjejnë pyetjet, të cilave u përgjigjen. Mësuesja përcjell punën e nxënësve. Në fund, nxënësit prezantojnë punën individuale të tyre. Mësuesja jep sqarimet e nevojshme plotësuese.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e grupit foljor në fjali, dallimin e kundrinorit të drejtë përmes pyetjeve të parashtruara. Gjithashtu, vlerësohet edhe puna individuale e nxënësve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 3 në faqen 92 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.6; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Largimi nga një turmë e inatosur (ora e parë)

Fjalët kyçe: zoti Holl, polici Xhefërs, zonja Holl, njeriu u padukshëm

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Shpreh njohuritë që ka rreth tekstit në fjalë;
- Përgjigjet në pyetjet rreth tekstit;
- Flet për personazhet e tekstit.

Kriteret e suksesit:

- Përgjigju në pyetjet e tekstit;
- Shpreh njohuritë që ka për tekstin në fjalë;
- Analizo tekstin në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Parashikimi me terma paraprakë

Kontrollohen detyrat e shtëpisë, si dhe bëjmë përsëritjen e njësisë së fundit mësimore. Pastaj mësuesja shënon në tabelë fjalët kyçe: **zoti Holl, zonja Holl, polici Xhefërs, njeriu i padukshëm**. Nxënësit do të shkruajnë individualisht nga një tregim të shkurtër, duke i marrë për bazë këto fjalë kyçe. Pastaj tregimet e punuara do t'i lexojnë para të tjerëve.

REALIZIMI – Lexim në dyshe, lexim i drejtuar

Pasi ndahen në grupe, nxënësit udhëzohen që të hapen librat e gjuhës shqipe në faqen 93, te teksti: **Largimi nga një turmë e inatosur** dhe lexojnë pjesën e parë. Dhe, sipas ndarjes do të punojnë në grupe për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

- *Për çka bëhet fjalë në tekst?*
- *Pse njerëzit janë të tmerruar?*
- *Çfarë mendonin ata për njeriun që e kishin parë?*
- *Kush merret me njeriun pa kokë?*
- *A ishte pa kokë njeriu tek i cili shkoi polici Xhefërs ta arrestojë?*
- *Ç'bëri zoti Holl?*
- *Si shpëtoi njeriu i padukshëm?*

Nxënësit pos në grupe, diskutojnë edhe në dyshe për mendimet dhe idetë e tyre rreth pyetjeve dhe pastaj ato diskutohen me tërë klasën. Vlerësohen porositë më të bukura, ku ato shkruhen në një kënd të klasës. Pastaj angazhohen disa nxënës që ta lexojnë tekstin. Gjatë leximit nxënësit këshillohen që të respektohen shenjat e pikësimit. Në lexim angazhohen sa më shumë nxënës, në mënyrë që pjesa e leximit në fjalë të kuptohet sa më mirë. Kështu vazhdohet edhe me pjesën e dytë, ku mësuesja paraqet pyetjet e nxënësit e përgjigjen.

REFLEKTIMI – Punë individuale

Nxënësit punojnë individualisht. Do t'u përgjigjen 4 pyetjeve të para në faqen 95 të librit. Mësuesja përcjell punën e nxënësve, duke dhënë sqarime e këshilla të nevojshme. Në fund, nxënësit paraqesin e punën e bërë para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në klasë, si dhe për leximin, ku u respektohen shenjat e pikësimit. Gjithashtu, vlerësohet edhe puna individuale.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Do të vazhdohet me plotësimin e tri pyetjeve të mbetura në faqen 95 të librit të gjuhës shqipe.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.6; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Largimi nga një turmë e inatosur (ora e dytë)

Fjalët kyçe: zoti Holl, polici Xhefërs, zonja Holl, njeriu u padukshëm

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përmbledh përmbajtjen e tekstit;
- Plotëson rubrikat sipas kërkesave të dhëna;
- Përshkruan personazhet me disa fjali.

Kriteret e suksesit:

- Përmbledh përmbajtjen e tekstit;
- Plotëso rubrikat e dhëna në tekst;
- Analizo tekstin në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Shqyrtimi i përbashkët

Me nxënës diskutohet rreth pyetjeve, për të cilat ata janë përgjigjur:

- *Cili është mesazhi i pjesës?*
- *Si e kuptoni që teksti me elemente fantastike?*
- *Si quhet pjesa e shkëputur nga një roman?*

REALIZIMI – Lexim në dyshe

Nxënësit lexojnë në dyshe. Nxënësi i parë lexon pjesën e parë dhe e përmbledh me disa fjali të shkurtra. Nxënësi i dytë parashtron pyetje rreth asaj që lexoi nxënësi i parë. Gjatë leximit, ndërrohen rolet. Kështu vazhdohet, ku krejt në fund disa dyshe e përmbledhin tekstin në përgjithësi. Pastaj, përmes bisedave me nxënës paraqiten cilësitë e secilit personazh.

REFLEKTIMI – Shkrimi i lirë

Nxënësit do të shkruajnë me fjalët e tyre për personazhin e policit Xhefërs. Pastaj do të prezantojnë para klasës atë që kanë shkruar. Në fund, mësuesja jep sqarimet plotësuese.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në lexim, si dhe për shkrimin e lirë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ta shkruajnë kuptimin e tekstit në fjalë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë

Fjalët kyçe: kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë, rasa dhanore

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon kundrinorët e zhdrejtë pa parafjalë me ndihmën e pyetjeve;
- Tregon me se shprehen kundrinorët e zhdrejtë pa parafjalë;
- Dallon kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë nga kundrinori i zhdrejtë me parafjalë.

Kriteret e suksesit:

- Dallo kundrinorët e zhdrejtë pa parafjalë;
- Trego me se shprehen kundrinorët e zhdrejtë pa parafjalë;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Diskutim idesh

Me anë të videoprojektorit paraqiten disa fjali, ku mësuesja bën pyetje:

- *Më takon mua ta them. (kujt)*
- *U çoi bukë e djathë djemve. (kujt)*
- *Gripi ia shkurtoi jetën plakut. (kujt)*

Nxënësit pyeten nëse e kanë idenë se fjalët me ngjyrë të zezë çfarë janë. Nëse nxënësit nuk japin përgjigjen që kërkohet, këtë e bënë mësuesja, duke iu thënë nxënësve se kemi të bëjmë me kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë.

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapen librat në faqen 96. Lexohen shembujt e dhënë në tekst. Nxënësve u thuhet se kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë gjithmonë është në rasën dhanore. U përgjigjet pyetjeve: *Kujt? Cilit? Cilës? Cilëve? Cilave?* Shoqërohet gjithmonë me trajtë të shkurtër të përemrit vetor në rasën dhanore.

Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë shprehet me:

- Emër në rasën dhanore – *i dërgoi motrës.*
- Përemër në rasën dhanore (vetor, pyetës) – *i kërkoi atij; Kujt i shkoi mendja për të?*
- Grup emëror – *A i jep asaj makine?*

Së bashku me nxënës punohet ushtrimi 1, ku në shembujt e dhënë në libër do të gjenden kundrinorët e zhdrejtë pa parafjalë. Do të nënvizohen dhe do të sqarohen para nxënësve

REFLEKTIMI – Punë individuale

Nxënësit do të punojnë individualisht. Do të punojnë ushtrimin 2, ku do të krijojnë 10 fjali ku do të përdoret kundrina e zhdrejtë pa parafjalë. Përcillet puna e nxënësve. Jepen sqarimet e nevojshme eventuale.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e kundrinorit të zhdrejtë pa parafjalë, si dhe gjetjen se me se shprehet ai.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani 6 fjali, ku do të përdoret kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II. **Klasa:** V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë

Fjalët kyçe: kundrinor i zhdrejtë me parafjalë, rasa dhanore

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon kundrinorët e zhdrejtë me parafjalë me ndihmën e pyetjeve;
- Dallon me se shprehet kundrinori i zhdrejtë me parafjalë;
- Ndërton fjali, duke përdorur kundrinorë të zhdrejtë me parafjalë.

Kriteret e suksesit:

- Dallo kundrinorët e zhdrejtë me parafjalë;
- Dallo me se shprehen kundrinorët e zhdrejtë me parafjalë;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Stuhi mendimesh

Mësuesja pyet nxënësit:

- *Sa lloje kundrinorësh kemi mësuar?*
- *Me se shprehen këta kundrinorë?*
- *Si i gjejmë çfarë lloj kundrinorësh janë?*
- *Çfarë pyetjesh bëjmë?*

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapen librat në faqen 96. Lexohen shembujt e dhënë në tekst. Nxënësit u thuhet se kundrinori i zhdrejtë me parafjalë shprehet me:

- **Emër** – *Ata shkuan me mësuesen në kinema. (me kë?)*
- **Përemër** – *Ata treguan për të. (për kë? – për të)*
- **Grup emëror** – *Ata do të shkojnë në vend të atyre aktorëve. (në vend të kujt? – në vend të atyre aktorëve)*

Me nxënës punohet ushtrimi në faqen 96 të librit. Në tekstin e dhënë në libër do të nënvizohen kundrinorët e zhdrejtë me parafjalë.

REFLEKTIMI – Punë individuale

Nxënësit do të punojnë individualisht. Do të shkruajnë 5 fjali, duke përdorur kundrinorin zhdrejtë me parafjalë. Në fund, ata paraqesin punën e bërë para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e kundrinorit të zhdrejtë me parafjalë, si dhe gjetjen se me se shprehet ai.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani 6 fjali, ku do të përdoret kundrinori i zhdrejtë me parafjalë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë – dëgjojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.3; I.6; II.2; II.3; II.5; III.1; III. 3; III.4; III.8

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.2; 1.3; 2.1; 2.2; 2.7; 3.1; 3.2; 3.7; 3.8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ne fëmijëve

Fjalët kyçe: droga, dhuna, shëndeti, buzëqeshja, lojëra të vërteta

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Lexon pastër dhe pa gabime poezinë në fjalë;
- Thotë kuptimin e poezisë më fjalët e veta;
- Gjykojnë për tematikën dhe idetë e autorit.

Kriteret e suksesit:

- Lexo pastër dhe pa gabime poezinë;
- Veço elementet që ka poezia;
- Mëso përmendësh poezinë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIM – Stuhi mendimesh

Mësuesja u parashtron nxënësve disa pyetje:

- Çka mendoni fëmijëve çka u duhet më tepër?
- Droga a i duhet fëmijës?
- Çka keni dëgjuar për drogën?
- Lojëra dhe buzëqeshjet a janë të nevojshme për fëmijët?

Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë dhe diskutohen së bashku, për ta nxjerrë qëllimin e orës mësimore.

REALIZIMI – Ruaje fjalën e fundit për mua

Nxënësit do të punojnë në bazë të udhëzimeve që do t'u jepen në vazhdim. Në fillim, hapen librat në faqen 97 dhe udhëzohen që ta lexojnë poezinë. Gjatë leximit kërkohet që të zgjedhin një pjesë që u pëlqen më shumë dhe të njëjtën ta shkruajnë në fletoret e tyre. Në anën tjetër të fletës, do të shkruajnë komentin e zgjedhur. Mund të shkruajnë edhe ndonjë gjë, që është në kundërshtim me pjesën e zgjedhur. Pas përfundimit të leximit dhe mbajtjes së shënimeve, një nxënës lexon pjesën e zgjedhur, ndërkaq nxënësit, të cilët kanë zgjedhur po atë pjesë japin mendimet e tyre. Kështu vazhdon edhe me nxënësit e tjerë.

REFLEKTIMI – Punë në dyshe

Nxënësit do të punojnë në dyshe. Ata do të plotësojnë rubrikën: *Të mendojmë e të përgjigjemi*, ku në kuadër të kësaj rubrike janë gjithsej 7 pyetje. Mësuesja përcjell punën e nxënësve dhe jep sqarime plotësuese eventuale.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimet e tyre gjatë orës mësimore, si dhe për punën në dyshe.

Detyrë shtëpie: Të povojnë të krijojnë një poezi me këtë temë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme

Fjalët kyçe: alfabeti i gjuhës shqipe, zanoret, bashkëtingëllore të zëshme

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon zanoret e alfabetit të gjuhës shqipe;
- Dallon bashkëtingëlloret e zëshme nga ato të pazëshme ;
- Klasifikon bashkëtingëlloret sipas llojit të tyre.

Kriteret e suksesit:

- Dallo zanoret e alfabetit të gjuhës shqipe;
- Shkruaj fjalë duke përdorur saktë bashkëtingëlloren e duhur;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Vëzhgo - diskuto

Me anë të videoprojektorit mësuesja paraqet alfabetin e gjuhës shqipe. Nxënësve u bëhen pyetjet:

- *Sa shkronja ka alfabeti i gjuhës shqipe?*
- *Si grupohen shkronjat e alfabetit?*
- *Cilat janë zanoret e gjuhës shqipe?*
- *Sa bashkëtingëllore ka alfabeti i gjuhës shqipe?*

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapen librat në faqen 96. Lexohen shembujt e dhënë në tekst. Nxënësve u thuhet se gjuha shqipe ka 7 zanore dhe 29 bashkëtingëllore. Bashkëtingëlloret me zanoret krijojnë zë. Disa bashkëtingëllore krijojnë më shumë, prandaj i quajmë të zëshme, kurse disa më pak e i quajmë të pazëshme. Në vazhdim nxënësve u paraqitet tabela me bashkëtingëlloret e zëshme e të pazëshme:

Të zëshme	b	v	dh	d	z	zh	xh	gj	g	m	n	nj	j	r	rr	l	ll
Të pazëshme	p	f	th	t	s	sh	c	q	k	h							

Më pastaj, së bashku me nxënësve do të punohet ushtrimi 1, ku nxënësit do t'i nënvizojnë bashkëtingëlloret e zëshme të fjalët e dhëna: *dera, dora, dhëmbi, skena, kamja, brumi, burri, vera, fuqia, forca, fundi, gjama, çanta, xham*. Mësuesja shikon se nxënësit a e kanë punuar mirë ushtrimin në fjalë.

REFLEKTIMI – Punë në dyshe

Nxënësit do të punojnë në dyshe. Në vazhdim ata do të punojnë ushtrimin 2, ku do të formojnë tabelën me bashkëtingëllore të zëshme dhe të pazëshme. Pastaj dyshet prezantojnë punën e bërë para klasës. Kjo vazhdon me sa më shumë dyshe, në mënyrë që të bëhet rumbullakimi i njësisë mësimore në fjalë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e bashkëtingëlloreve të zëshme dhe të pazëshme. Gjithashtu, vlerësohet edhe puna në dyshe.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruani 20 fjalë të ndryshme, ku pastaj do t'i rrethoni bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.6; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Planet e fëmijërisë (ora e parë)

Fjalët kyçe: princesha, babai, Gojëlulja

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Lexon duke respektuar shenjat e pikësimit;
- Analizon personazhin kryesor të tekstit ;
- Nxjerr mesazhin e tekstit në fjalë.

Kriteret e suksesit:

- Lexo tekstin duke i respektuar shenjat e pikësimit;
- Analizo personazhin kryesor të tekstit;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Bisedë paraprake

Kontrollohen detyrat e shtëpisë. Pastaj mësuesja parashtron pyetje për nxënësit:

- *Çka mendoni për fëmijërinë tuaj?*
- *Si ka qenë fëmijëria juaj deri më tash?*

Nxënësit japin përgjigjet e tyre, të cilat përgjigje mësuesja i shkruan në tabelë.

REALIZIMI – Lexim DRTA, pyetje – përgjigje

Hapen librat në faqen 99, te teksti: *Planet e fëmijërisë*. Autor: *Qamil Batalli*. Pjesa në fjalë ndahet në dy paragrafë. Fillohet me leximin e paragrafit të parë. Pas përfundimit të leximit, mësuesja shtron pyetjet për nxënës:

- *Çfarë mendime kishte princesha?*
- *Pse nuk mund të realizonte ajo qëllimet e veta?*

Kalohet në diskutim. Nxënësit japin përgjigjet e tyre. Pas kësaj vazhdohet vazhdohet së lexuari me paragrafin e dytë. Veprohet njëjtë. Kalohet në pyetje:

- *Çfarë vendosi të bënte ajo?*
- *A i arrin qëllimet njeriu, i cili ka durim?*

Jepen përgjigje edhe për këtë paragraf. Pastaj lexohet pjesa në tërësi. Sqarohen fjalët e panjohura.

REFLEKTIMI – Punë në grupe

Nxënësit ndahen në dy grupe të mëdha, ku do të diskutojnë dhe do të shkruajnë rreth asaj se çfarë mësimi do të nxjerrin nga fjalitë:

- *Çdo gjë mund të ndryshojë në këtë botë. (grupi i parë)*
- *Çfarë të drejtash duhet të shijojë çdo njeri? (grupi i dytë)*

Në fund, grupet prezantojnë punën e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në klasë, si dhe për leximin, ku u respektuan shenjat e pikësimit. Gjithashtu, vlerësohet edhe puna në grupe.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Do të punohet rubrika: *Punë individuale*, në faqen 102 të librit të gjuhës shqipe, si dhe do të shënojnë në fletoret e tyre fjalitë kryesore të çdo paragrafi.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Lexojmë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.6; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.7; 2.4; 2.6; 3.5; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Planet e fëmijërisë (ora e dytë)

Fjalët kyçe: princesha, babai, Gojëlulja

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Përmbledh përmbajtjen e tekstit;
- Plotëson rubrikat sipas kërkesave të dhëna;
- Përshkruan personazhet me disa fjali.

Kriteret e suksesit:

- Përmbledh përmbajtjen e tekstit;
- Plotëso rubrikat e dhëna në tekst;
- Analizo tekstin në fjalë.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE**

EVOKIMI – Shqyrtimi i përbashkët

Me nxënës diskutohet rreth pyetjeve, për të cilat ata janë përgjigjur:

- *Cili është mesazhi i pjesës?*
- *Ju si fëmijë, çfarë mund të ndryshoni në rrethin tuaj?*
- *Çfarë ishte princesha sipas jush?*

REALIZIMI – Lexim në dyshe

Nxënësit lexojnë në dyshe. Nxënësi i parë lexon pjesën e parë dhe e përmbledh me disa fjali të shkurtra. Nxënësi i dytë parashtron pyetje rreth asaj që lexoi nxënësi i parë. Gjatë leximit, ndërrohen rolet. Kështu vazhdohet, ku krejt në fund disa dyshe e përmbledhin tekstin në përgjithësi. Pastaj, përmes bisedave me nxënës paraqiten cilësitë e secilit personazh.

REFLEKTIMI – Shkrimi i lirë

Nxënësit do të shkruajnë me fjalët e tyre për personazhin e princeshës. Pastaj do të prezantojnë para klasës atë që kanë shkruar. Në fund, mësuesja jep sqarimet plotësuese.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në lexim, si dhe për shkrimin e lirë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Ta shkruajnë kuptimin e tekstit në fjalë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit

Fjalët kyçe: rrokje, rregulla, viza

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon rastet kur ndahen ose nuk ndahen fjalët në fund të rreshtit;
- Zbaton rregullat drejtshkrimore për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit;
- Dallon fjalët e ndara saktë dhe fjalët e ndara gabim.

Kriteret e suksesit:

- Dallo fjalët e ndara saktë dhe ato të ndara gabim;
- Zbato rregullat drejtshkrimore për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Vëzhgo - diskuto

Me anë të videoprojektorit mësuesja paraqet shembuj me ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit.

Nxënësve u bëhen pyetjet:

- *Sa rrokje ka secila fjalë?*
- *Si mund të ndahen ato në fund të rreshtit?*

Nxënësit japin përgjigjet e tyre. Analizohen shembujt nga videoprojektori. Mësuesja jep sqarimet e nevojshme.

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapen librat në faqen 103. Lexohen shembujt e dhënë në tekst. Nxënësve u thuhet se gjithmonë nuk mund të përfundojmë rreshtin pa e ndarë ndonjë fjalë në fund të tij, prandaj ekzistojnë rregulla për të.

Shembull:

De –ra, kod –ra (ko –dra), këm- ba. Gjithashtu, nxënësve u thuhet se nuk ndahen në fund të rreshtit dyshkronjëshet: **zh, sh, th, dh,** etj. Po ashtu, grupet e zanoreve nuk ndahen, por ruhen: **qie – lli, die – lli,** etj. Pastaj fjalët e përbëra (kompozitat) e tipit: copë – copë, njëri – tjetri, fjolla – fjolla etj. duhet të ndahen te pjesa e parë, si: **pjesë – pjesë e jo pjesë – pje – së.** Pastaj punohet ushtrimi 1 me nxënësit së bashku. Ata do të ndajnë në fund të rreshtit fjalët e dhëna: *Lule, hekur, shtigje, përreth, palë – palë, ekonomiko – shoqëror, shndërroj, shkruaj, diskutoj, analizoj.*

REFLEKTIMI – Punë individuale

Nxënësit do të punojnë individualisht. Do të punojnë ushtrimin 2 në faqen 103 të librit. Ata do të ndajnë në fund të rreshtit fjalët, që shkruhen me viza në mes: *copë – copë, vija – vija, politiko – shoqëror, veri – lindje, jug – lindje.* Përcillet puna e nxënësve dhe në fund ata paraqesin punën e bërë para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit. Gjithashtu, vlerësohet edhe puna individuale.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Hulumto dhe gjej fjalë, të cilat janë ndarë gabimisht në fund të rreshtit (10 fjalë).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim. **Lënda:** Gjuhë amtare. **Shkalla e kurrikulës:** II.
Klasa: V

Kompetenca: Njohuri gjuhësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.3; II.1; III.1; III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1; 1.8; 2.7; 3.2; 3.6; 3.7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Rrethanorët

Fjalët kyçe: rrethanor, kohe, vendi, mënyre, sasi, shkaku, qëllimi, gjymtyrë të dyta

Rezultatet e të nxënit në fund të orës mësimore:

- Dallon rrethanorët në fjali, duke përdorur pyetjet përkatëse;
- Dallon llojin e rrethanorëve sipas pyetjeve të bëra;
- Kirjon fjali me rrethanorë të llojeve të ndryshme.

Kriteret e suksesit:

- Dallo rrethanorët në fjali;
- Trego se rrethanorët janë pjesë e grupit të kallëzuesit dhe se lëvizin në një fjali;
- Plotëso shembujt e dhënë në libër.

Burimet:

Gjuha shqipe – 5, platforma schoolme, burime nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri i gjuhës shqipe, laptopi, video-projektori, fletoret, lapsi dhe ilustrime të tjera të nevojshme


Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo edhe me çështjet ndërkurrikulare:

Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

EVOKIMI – Kllaster

Nxënësve u paraqitet një kllaster për rrethanorin:



Shikohet kllasteri dhe analizohet së bashku me nxënësit.

REALIZIMI – Punë e drejtuar

Hapen librat në faqen 104. Vëzhgohen shembujt e dhënë dhe rregullat gjuhësore për rrethanorët. Nxënësve u thuhet se rrethanorët janë gjymtyrë të dyta, që plotësojnë kuptimin e kallëzuesit dhe tregojnë rrethanat, ku është kryer veprimi. Në gjuhën shqipe dallojmë rrethanorin: **e vendit, e kohës, e mënyrës, e sasisë, e shkaktit, e sasisë, e qëllimit**. Merren disa shembuj në libër dhe analizohen. Nxënësit me anë të pyetjeve përkatëse do t'i rrethanorët. Pastaj punohet **ushtrimi**, ku në tekstin e dhënë në libër, në faqen 104 do të gjenden dhe do të nënvizohen rrethanorët dhe do të tregohet lloji i tyre.

REFLEKTIMI – Punë individuale

Nxënësit do të punojnë individualisht. Do të punojnë ushtrimin e radhës, ku me fjalët e dhëna do të krijojnë fjali: **kujdesshëm, rrjedhshëm, sot, nesër, tepër, fort, dje**. Mësuesja përcjell punën e nxënësve. Në fund, nxënësit prezantojnë punën e bërë individualisht. Bëhen plotësimet e nevojshme nga mësuesja.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për dallimin e rrethanorëve dhe llojin e tyre me ndihmën e pyetjeve. Po ashtu, vlerësohen edhe për punën individuale.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Shkruajeni një tekst, ku do të përdoren të gjitha llojet e rrethanorëve.